

Mendimi ynë për karakterin kombtar në ARKITEKTURË

Me shkrimin «Probleme të karakterit kombëtar socialist në arkitekturë» redaksia e gazetës sonë çel diskutimin «Mendimi ynë për karakterin kombëtar në arkitekturë». Ftojme arkitektët e inxhinierët, punëtorë e specialistë të ndërtimit, shkrimtarë e artistë, studiues e punonjës të ndryshëm, që të kontribuojnë në këtë diskutim në faqet e gazetës. Mendimet e shumta të punonjësve të ndryshëm do të ndihmojnë të sqarohen problemet që kanë të bëjnë me

mbështetjen në traditat tona të së kaluarës dhe rezultatet më të mira të deritanishme, në probleme të përmbajtjes dhe formës, në zbatim të porosive të Partisë për të ndërtuar ndërtesa të përshtatshme, të forta, të bukura dhe të lira, në luftë kundër ndikimeve dhe shfaqjeve të huaja borgjezo-revizioniste, për forcimin e karakterit kombëtar të arkitekturës sonë socialiste.

Probleme të karakterit kombtar socialist në arkitekturë

Kutim Buza

Partia dhe shoku Enver kanë theksuar vazhdimisht që edhe arkitektura jonë, si gjithë kultura dhe arti ynë socialist, të rritet dhe të zhvillohet sipas parimeve marksiste-leniniste të mbështetjes në traditat e shquara popullore të së kaluarës dhe traditave sot në realitetin tonë socialist, për të formuar një fytyrë sa më të qartë kombëtare socialiste. Që në fjalën e mbajtur në komisionin e ngritur për çështjen e urbanizmit të qytetit të Tiranës dhe të qyteteve të tjera të vendit më 19 shkurt 1948, shoku Enver Hoxha ka thënë: «...arkitektët duhet të kenë parasysh stilin popullor. Të përpiqen që të krijojnë një stil në përshatje me karakteristikat e vendit tonë». Mbështetur në porositë e vazhdueshme të Partisë dhe të shokut Enver arkitektët, inxhinierët dhe punonjësit e tjerë të projektimit, bashkë me specialistë dhe punëtorë të zbatimit, kanë bërë përpjekje dhe kanë arritur rezultate të mira duke ja tur ndryshuar pamjen Atdehut tonë socialist, duke ndërtuar qytete dhe fshatra, komplekse industriale bujqësore dhe blegtorale, shtëpi të bukura banimi, institucione social-kulturore, ndërtime që janë, në përgjithësi, vepra të mira dhe të bukura në përshatje me realitetin tonë socialist, duke krijuar kështu një traditë të re në lëmin e arkitekturës dhe urbanistikës.

kushte për ne bëhet edhe më imperative lufta për të ruajtur fizionominë kombëtare të artit, pasurinë kulturele të popullit...».

Në lëmin e arkitekturës populli ynë trashëgon sot një pasuri të madhe dhe shumë të çmuar me trajta origjinale kombëtare. Gjirokastra, Berati, Kruja, Lezha, Shkodra, arkitektura e fshatit etj. janë dëshmi e arrijtjeve në lëmin e arkitekturës me fizionomi kombëtare, një burim i përhershëm frymëzimi që flet për historinë e popullit tonë, për mendimet dhe dëshirat e tij, për mënyrën e tij të jetesës, luftat dhe përpjekjet e vazhdueshme të shqiptarit kundër armiqve barbarë e të panumërt, flet për dashurinë e tij për jetën, punën, natyrën e bukur dhe madhështore; është kjo jeta e shqiptarit në kushte të caktuara historike.

Ndërtimi i fshatrave dhe qyteteve tona, karakteri i ndërtesës së banimit, mënyra e vendosjes dhe shpërndarjes së tyre në përpunim me veçoritë e terrenit, uniteti i arritur në mes përmbajtjes dhe formës mbështetur në kushtet e caktuara historike e shoqërore, shfrytëzimi me shije i materialeve rrethorore në harmoni me karakterin e ndërtimit dhe kushtet klimatike, përdorimi i materialeve të forta, mjeshtëria e lartë e artit të gurit dhe gdhendja e drurit, kryerja dhe organizimi i ambienteve jashtë, të gjitha këto flasin për një vlerë të pallogaritshme që kemi dhe ruajmë në fushën e arkitekturës. Bile, në qoftë se populli ynë u ka bërë ballë armiqve barbarë, ka ruajtur cilësitë dhe dinjitetin kombëtar, qënie e tij si komb, kjo ka ardhur ju vetëm se ai ka luftuar me armë në dorë, por edhe sepse ai ka krijuar një pasuri të madhe kulturore dhe artistike, të cilën ka ditur ta shfrytëzojë dhe ta verë në dobi të çështjes nacionale. Një qëllim i tillë i ka shërbyer edhe arkitektura jonë e lashtë. Kulla e shqiptarit ka qenë jo vetëm shtëpi e besës, në kuptimin e drejtë të saj, dasmës dhe e fatqesive, gëzimit dhe hidhërimit, por edhe një fortesë, kala e pamposhtur luftash dhe betejash. Prandaj, Partia dhe shoku Enver, menjëherë pas Çlirimit këshillonin edhe arkitektët që të mësojnë nga krijimtaria popullore, të mbështeten në stilin popullor, të zberthejnë vlerat e saj për ta shfrytëzuar atë në më-

nyrë krijuese, në kushtet konkrete në mënyrë që, siç na mëson shoku Enver: «Çdo gjë që do të ngrihet, të përshatet me regjimin tonë popullor». (19 shkurt 1948).

Arkitektura jonë popullore, e ngritur dhe e ndërtuar mbi principet e një përmbajtjeje demokratike e patriotike, e cveshur dhe e pastruar prej ndikimeve të huaja të klasave shfrytëzuese, realizuar në një formë kombëtare është një thesar i madh për arkitektët tanë, një shembull i shkëlqyer për t'i dhënë arkitekturës së sotme një karakter kombëtar socialist.

Dhe ne në këtë rrugë kemi ecur e kemi suksese.

Por në raste të veçanta ka pasur edhe arkitektë, të cilët të ndodhur nën presionin e ndikimeve të ideologjisë borgjeze e revizioniste, predispozicionit liberal të tyre, kanë arritur deri në mohim të traditave tona të së kaluarës në arkitekturë, kur shprehën se: «Krejt të pashpresa janë orvatjet për të shfrytëzuar në ndërtimet e sotme forma të marra nga arkitektura e së kaluarës. Bile edhe talenti më i madh është i destinuar të dështojë. Gjithmonë e gjithmonë bëhemi dëshmitarë të asaj që arkitektë të talentuar dështojnë kur vepra e tyre nuk shkon në një hap me kohën» (S. Mosko, P. Kolevica, K. Çomi). Ky është një qëndrim intelektualist prej ksenomani që synon të nënvlefësojë vlerën e madhe dhe të rëndësishme të kulturës popullore, të traditave tona në këtë fushë, pikëmbështetje për zhvillimin më të arkitekturës sonë kombëtare socialiste. Teorizime të tilla para Plenumit IV të KQ të Partisë kanë çuar në largimin nga tabani i shëndoshë kombëtar, bile ato kanë shërbyer për të argumentuar pikërisht këto devijime.

Por, ashtu sikundër nuk duhet mohuar tradita edhe në fushën e arkitekturës, po ashtu ndaj saj duhet mbajtur një qëndrim kritik shkencor, duke e parë atë në mënyrë dialektike, duke bërë seleksionimin e duhur në vlerësimin e gjithçkaje të mirë, të bukur e të vlefshme për epokën tonë, në mbështetje të parimit të njohur marksist-leninist «e vjetra duhet t'i shërbejë të resë» dhe duke lënë mënjane ato gjëra të cilave u ka kaluar koha, ndikime të ideologjisë dhe të moralit të klasave shfrytëzuese që kanë gjetur vend

në atë kohë për arsye të vetë kushteve historike në të cilat është zhvilluar edhe arkitektura jonë.

Problemi nuk është që për të qenë kombëtar në projektet tona të mbështetimi thjeshtë në ndonjë motiv, detal arkitektonik që montohet në mënyrë shabllone marrë nga arkitektura popullore. siç ndodhi me rastet e ndërtimeve në një nga shëtitoret e Tiranës.

Çështja është që të kuptohet në esencë karakteri kombëtar e popullor i kësaj trashëgimie. Problemi nuk zgjidhet me kopjimin e detajeve një për një nga arkitektura popullore, por në frymën e përgjithshme. Jo përgjasim i jashtëm e vulgar i arkitekturës popullore, por përpunim krijues i kësaj trashëgimie në funksion të evidentimit të vlerave të shquara aktuale të arkitekturës në kushtet konkrete të ndërtimit të socializmit. Është njëlojtë si në poezi: po të kopjosh thjeshtë vargjet popullore, mund të thuhet se këtu qëndron karakteri kombëtar? Ose piktori po të merrej me kopstat apo qëndisimat e kostumit popullor dhe të harronte botën e brendshme të heroit që mban këtë veshje, nuk do të binte ai në etnografizëm? Për të arritur rezultate në këtë drejtim duhet shpirt krijuar, mbështetur kjo në një njohje të gjithanshme të jetës, jo vetëm i ndërtimeve, si të tilla, por edhe i folklorit, i etnografisë i koreografisë, i muzikës dhe historisë së popullit tënd. Duhet të njohësh mirë shkencërisht shumë probleme komplekse që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik dhe demografik të vendit, nevojat e zhvillimit dhe të shtimit të popullatës etj. Arkitekti duhet të jetë njeri me kulturë të gjerë kombëtare që të arrijë të futë frymën kombëtare në arkitekturë.

Pastaj duhet të dijë si e punon dhe e përdor gurin Gjirokastra e si e punon dhe e përdor Kukësin, pasi nuk është frymë kombëtare ajo që ta marrësh gurin nga qyteti muze i Beratit dhe ta shpiesh në Kukës, duke kujtuar se kështu e zgjidhe çështjen e kombëtares. Në çështjen e dhënies së frymës kombëtare doemos kanë rëndësi edhe ato detajet e vogla. Veshjet me gurë apo diçka tjetër, ashtu siç kanë rëndësi për piktorin qelesha, mustaonet dhe tirqet. Puna është që të mos e reduktojmë frymën kombëtare vetëm në disa gjëra, me vendosjen në ambiente të ndonjë pikturë apo skulpturë (sipas ndonjëri kështu mund t'i japim frymë kombëtare arkitekturës), qoftë edhe duke vënë pa menduar mirë ndonjë brez guri, thjeshtë si veshje, montim në sipërfaqe. Gurin ne duhet domosdo ta oërdorim dhe ta vlerësojmë shumë si material. vetëm se duhet ta vëmë atë në funksion të përmbajtjes, idesë. Sigurisht pa nënvlefësuar punën e këtyre gjërave çështja qëndron në kuptimin në tërësi të problemit të karakterit kombëtar në oërmbytje dhe në formë. Fryma kombëtare duhet ta përshkoië vepërën arkitektonike që nga struktura e jashtme e deri te struktura e brendshme. Por për strukturën e brendshme arkitekti duhet të dijë edhe zakonet e shqiptarit, edhe ecjen e tij, edhe shlodhien. prehjen e tij, edhe dasmën e tij, edhe vdekjen, edhe muhabetin dhe këngën e vallen.

Si rezultat i presionit të ideologjisë borgjeze - revizioniste, punës armiqsore të F. Paçramit

(vijon në l. 11)

Por, me gjithë sukseset e pamohueshme, përpara urbanistikës dhe arkitekturës sonë dalin disa probleme të rëndësishme që kanë të bëjnë edhe me thellimin e karakterit kombëtar në arkitekturë, që ajo të përfaqësojë sa më mirë realitetin tonë socialist, brendin e përgjithshme shoqërore. Veçanërisht ky problem bëhet akoma më i rëndësishëm në kushtet dhe rrethanat aktuale të rrethimit dhe bllokadës imperialisto-revizioniste, prandaj, siç thotë shoku Enver në Plenumin e 4-t të KQ të PPSH: «Në këto

Probleme të karakterit kombtar socialist në arkitekturë

(vijon nga f. 7)

dhe T. Lubonjës edhe në fushën e arkitekturës, nga disa arkitektë ka patur konfuzion dhe paqartësi në kuptimin e modernes në arkitekturë, duke e ngatërruar atë me modernizmin. Modernen, arkitekturën e kohës ka pasur rastë që ata e kanë parë jashtë trullit konkret kombëtar, jashtë traditave në këtë lëmë, jashtë kërkesave aktuale të epokës sonë, duke e ngatërruar atë me modën borgjezo-revizioniste të izmave, shfaqjeve formaliste, me modernizmin. Për këtë flasin qartë disa ndërtime siç janë Kino-teatri i Fierit, shtesa e Institutit të Lartë të Arteve, biblioteka e Korçës, ATSH, stacioni i foragjerëve në Fushë - Krujë etj. Për një gjë të tillë dëshmojnë gjithashtu edhe teorizimet në këtë fushë.

Modernen në arkitekturë nuk mund ta kuptosh jashtë lidhjeve që duhet të ketë ajo me traditat e kulturës dhe të artit përparimtar të së kaluarës. Traditat, të kuptuara në mënyrë krijuese marksiste-leniniste, nuk i vënë kufi novatores, përkundrazi, ato kthehen në një pikë mbështetjeje për më tutje.

Të renë, modernen, novacionin duhet ta shohim, edhe në arkitekturë, para të gjithash në përmbajtje, në brendinë e saj që lidhet ngushtë me aspiratat e popullit tonë punonjës, epokën tonë socialiste, me qëllimet dhe interesat e klasës sonë punëtore, me vetë kushtet ekonomike dhe

politike të vendit tonë. «Arkitektura jonë duhet të frymëzohet nga parimet socialiste, të rrisë nivelin e saj estetik e shkencor, të ruhet nga shabllonizmi e uniformizmi dhe të formojë shijen arkitekturale popullore e socialiste, të krijojë vepra që të plotësojnë në mënyrë të qëllimshme funksional për të cilin ngrihen, të arritur e të shprehur me mjete të thjeshta e të bukura, që të plotësojnë kushtet e shijes artistike socialiste dhe të leverdisë ekonomike, në raport të drejtë edhe me kërkesat e perspektivës. Neve na duhen vepra arkitektonike të mira, dmth që ato të jenë të përshatshme, të forta, të lehta, të bukura dhe të lira» ka thënë shoku Mehmet Shehu në Kongresin e 6-të të PPSH.

Kjo brendë e re e arkitekturës sonë sjell si pasojë edhe një formë të re artistike në unitet të plotë me njëra-tjetrën.

Në kundërshtim të hapur me karakterin kombëtar kanë qenë gjykimet për formën e shpërndarjes nga përmbajtja e vetë ndërtimit, karakterit funksional të saj, preokupimet për të «bukurën», për «kënaqësinë estetike», për «shijen estetike» si qëllim në vetvete.

Arkitektura jonë, në të kundërtën, duke u vënë në shërbim të shoqërisë sonë socialiste, mban parasysh karakterin utilitar për t'i shërbyer sa më mirë njeriut tonë në rrethanat konkrete të ndërtimit të shoqërisë socialiste.

Arkitektura dhe urbanistika jonë moderne duhet të mbështetet në mënyrën tonë të jetesës,


në kushtet tona klimaterike, në shfrytëzimin sa më mirë të diellit, blerimit dhe ajrit të pastër. Edhe në ballkonet ne kemi mënyrën tonë. Ne jemi një vend i ngrohtë dhe nuk i fshihemi ajrit, se s'kemi frikë se ftohemi si nordikët. Pastaj mënyra e jetesës na i do ballkonet, jo një plaçkë, jo nxjerrim karrigen dhe rrimë, pa kemi qejf të kuvendojmë. Në Elbasan kanë bërë shumë ndërtesa pa asnjë ballkon. Apo në kundërshtim me këtë, si koncept formalist i përpunimit të fasadave, duke parë anën estetike si estetë të sëmure, ka patur shfaqje të «ballkonomanisë», ndërtimin e ballkoneve jashtë kriterëve tonë ideestetike.

Koncepte në kundërshtim me karakterin kombëtar janë edhe tendencat e gjigandomanisë, të lluksit etj. Këto janë shfaqje të mëndjemadhësisë dhe të vënies së lavdisë personale mbi interesat e shtetit dhe të shoqërisë sonë, që kanë ardhur si rezultat i përluljes përpara presionit të ideologjisë së huaj borgjezo - revizioniste, duke harruar shumë faktorë thelbësorë, ndërmjet tyre edhe ato ekonomike. Të renë, modernen nuk e kupton dot si përpjekje të një arkitekti për të kërkuar dhe gjetur forma të reja jashtë realitetit, pjellë e fantazisë, apo kopjime të modeleve perëndimore, ajo është shprehje e vetë botëkuptimit tonë materialist, shprehje e zhvillimit tonë shoqëror në kushtet aktuale të ndërtimit të shoqërisë socialiste. Këta shokë, duke vepruar kështu nën pretekstin e luftës kundër konservatorizmit, uniformitetit dhe monotonisë, ranë në pozita liberale e moderniste, në kundërshtim me parimet e artit tonë të ndërtuarit që mbështetet në principet socialiste të zhvillimit

shoqëror. Sigurisht, ne duhet të bëjmë përpjekje e të luftojmë për ta ngritur arkitekturën tonë në një shkallë sa më të lartë, të luftojmë edhe dobësi e të meta që kemi, për të ndërtuar godina sa më funksionale, të rezistueshme estetiksht, në harmoni dhe me sa më pak kosto, të luftojmë pa mëshirë çdo shfaqje dhe ndikim të huaj borgjezo - revizionist për të kristalizuar një arkitekturë sa më të qartë kombëtare socialiste. Ne do të shfrytëzojmë edhe arritjet dhe eksperiencën e kulturës botërore, ne s'jemi as ksenomanë e as ksenofobë. Partia na mëson që «Punonjësit e frontit ideologjik shkrimtarët, kompozitorët, arkitektët e të tjerë duhet të përfitojnë... nga gjithçka është e mirë dhe përparimtare në jetën dhe kulturën e vendeve të tjera, por duhet të hiqet dorë nga shabllonizmi dhe mënyra mekanike në zbatimin e eksperiencës së huaj» (PPSH mbi kulturën, letërsinë dhe artin, f. 17).

Problemi i karakterit kombëtar socialist në fushën e arkitekturës është një detyrë e përhershme e artit tonë të ndërtuarit, për të cilin të gjithë ne, arkitektët e inxhinierët, punëtorët e specialistët, piktorët, skulptorët, shkrimtarët e artistët, duke marrë vazhdimisht mendimin e masave tona punonjëse, duhet të kontribuojmë në mënyrë që, të mbështetur në traditën e lashtë dhe të re, në arritjet e suksesshme në fushën e arkitekturës gjatë këtyre viteve të pushtetit popullor, në mësimet e vazhdueshme të Partisë dhe të shokut Enver, të ngrejme në një nivel më të lartë arritjet në fushën e arkitekturës, për të kristalizuar stilin e epokës sonë, karakterin kombëtar socialist të saj.

KUJTIM BUZA



Qytetet tona.

(Foto: S. Kaba)

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË



Shtëpia e pushimit të punëtorëve në Korçë.

Për një vepër të re të arkitekturës

Niko Progni - piktor

Në vendin tonë mjeshtrit e vjetër, në ndërtimin e shtëpive të banimit, elementët artistikë dekorativë i kanë përdorur me shije të lartë artistike. Kjo është vërejtur sidomos në përdorimin e gdhendjeve në gur e në dru, të rrahjeve në hekur si dhe në pikturimin e tavaneve. Elementët dekorativë janë përdorur

në vendet e ndryshme të ndërtesave. Më shpesh i gjejmë nëpër qoshet e mureve, në fasadat e shtëpive, në kornizat e ndryshme si dhe në oxhaqet (ku përdoret më tepër guri), në tavanet e në dollapët në mur, në ndarjet e dhomave si dhe në mobiljet e ndryshme (punuar me dru) nëpër kangjellat, nëpër dri-

taret e shtëpive apo objekte të tjera të brendshme ku përdoret metali.

Gjatë ndërtimeve të reja, herë pas here janë bërë përpjekje nga arkitektët për shfrytëzimin e kësaj tradite, sigurisht duke iu përshtatur dhe kërkesave të reja estetike dhe kushteve të sotme teknologjike. Megjithatë, lidhja e veprave të artit monumental dhe atij të aplikuar me arkitekturën nuk ka gjetur akoma një zbatim të plotë. Në ato ndërtime ku ekziston kjo lidhje, edhe vetë ndërtesa merr një pamje të re e më të bukur. Përpjekjet e bëra nga disa arkitektë për shfrytëzimin e elementëve dekorativë tradicionalë si p.sh. në hotelin e Gjirokastrës, të Përmetit apo dhe në ndonjë rast tjetër ka ndihmuar edhe për t'i dhënë një fytyrë më kombëtare këtyre ndërtesave.

Kjo ka qenë një përpjekje e mirë, por e pamjaftueshme, sepse është shfrytëzuar veçëm guri, ndërsa materialet e tjera si druri, hekuri dhe bakri, që ndihmojnë për krijimin e ambienteve të brendshme dhe ndërtimin e objekteve funksionale si tavolina, karrige, ndarje në mure e të tjera janë përdorur shumë pak. Një përdorim të gjerë të këtyre elementëve në materiale të ndryshme e gjejmë në kampin e ri të punëtorëve, ndërtuar kohët e fundit në Korçë. Në këtë ndërtesë, është bërë një sintezë e bukur e arteve të aplikuara me


tërësinë arkitektonale të brendshme dhe të jashtme. Kjo sintezë vihet re edhe në objektet artistike, të cilat nuk kanë vetëm karakter artistik, por kryesisht funksional, siç janë karriget, tavolinat e mjaft objekte të tjera.

Në përgatitjen e orendive të brendshme është punuar me një ndjenjë të hollë dhe me shije artistike, duke krijuar një ambient shumë të ngrohtë e të pastër. Krijuesit dhe mjeshtrit, që kanë zbatuar projektet, duke i njohur mirë traditat tona në këtë fushë, kanë marrë prej saj anë të mira dhe ia kanë përshtatur një ndërtesë të re moderne si kjo, duke mos humbur anën funksionale dhe duke rritur vlerat artistike. Në këtë mënyrë i kanë dhënë edhe një fytyrë më kombëtare gjithë godinës. Edhe ana e jashtme e pallatit duket e bukur mbasi është gjetur vendi i përshtatshëm për t'u ngritur pjesa kryesore, e cila së bashku me anekset e tjera, krijojnë një tërësi artistike të bukur. Arkitekti ka shfrytëzuar mirë dhe me vlerë artistike disa sipërfaqe të veshura me gurë në dy ngjyrat, të zezë dhe gri, që lidhen organikisht me ndërtesën. Po me kaq shije të gdhendur bukur nga mjeshtrit korçarë, janë vazot në hyrje dhe çezmja, të cilat lidhen nga ana plastike me gjelbërimin e parkut. Këto të kujtojnë mjaft punime të bukura me të cilat mjeshtrit korçarë të gdhendjes së gurit e kanë pasuruar herë pas here qytetin e tyre. Guri është shfrytëzuar edhe në brendi. Punë e kujdesshme është bërë në shtrimin e dyshe-meve me pllaka mermeri, granili e mozaik granili, ku janë krijuar me shije motive të mbështetura në artin tonë popullor e që lidhen me ambientin e përgjithshëm të dhomave. Me shije janë bërë edhe lysterjet e ambienteve, duke krijuar kudo ngjyrën që i përshtatet më tepër.

Në pajisjet e brendshme dhe në parmakët e shkallëve, që janë punuar me hekur të rrahur, po kështu edhe ndarjet në dru dhe karriget, tavolinat, artizanët kanë shfrytëzuar me kriter të drejtë artistik motivin popullor të gdhendjes në formë cfurku. Ky motiv është gjetur dhe përshtatur mirë dhe kur është përdorur në dru ose në hekur, ka ruajtur specifikën e materialit duke krijuar forma të ndryshme

Meritë e projektuesve dhe e mjeshtrave realizues në këtë pallat është jo vetëm shfrytëzimi i motiveve kombëtare, por edhe përshtatja e drejtë e tyre në këtë ndërtesë të re, krijimi i një ambienti të pasur dhe të ngrohtë, ku ndjehet përgjithësisht atmosfera popullore në hapësira plot ajër e dritë, në një ambient kulturor dhe modern. Mendoj se ky është shembulli pozitiv i shfrytëzimit dhe i mbështetjes në tabanin kombëtar të arkitekturës sonë dhe shërben si nxitje për arkitektët dhe artistët në projektimin e godinave dhe institucioneve tona social-kulturore, me fytyrë të qartë kombëtare. Një gjë e tillë mungon në mjaft hotele të rinj që janë ngritur kohët e fundit tek ne. Në këto godina jo vetëm që nuk gjen sa duhet mbështetje në arkitekturën tonë popullore, por pothuajse nuk gjen të shfrytëzohet asnjë element i saj, nuk gjen asnjë

(vijon në f. 10)



Mobilje të shtëpisë së pushimit të mbështetura në traditën popullore

Fshatarët diskutojnë Projekt Kushtetutën

Rudolf Marku

E lanë punën,
Por prapë lopatat i muarën me vete
Ashtu në këmbë, mbështetur mbi pjesën e drunjtë fort
Më të sigurt se kurrë fshatarët gjithmonë e kanë
ndjerë veten.

Sot diskutojnë Projekt Kushtetutën
Atje në fushë, atje në arë.
Poshtë këmbëve të tyre gruri gjelbërohet më shumë,
Dhe rritet më shumë, në këto caste patjetër.

Ligjet në shekuj kanë qenë të frikshëm,
Kanë qenë burg, uri, mallkim,
Kanë qenë boshllëk i stomakut të atij që punon,
Dhe njëkohësisht për atë që punon
veç kërrusje e shpinës.

Cokajt dhe Sykajt kanë qenë ligji,
Gjithfarë feudalesh, priferinj, zotërinj
Kamzhiku i tyre shkruante nenet
Jo vetëm mbi letër të bardhë, por dhe mbi tonën
shpinë.

Ligjet në shekuj kanë qenë të frikshëm për ne,
Si fjalët - uri, si fjalët: - fëmijët nuk kanë so-
nte bukë!
Fjalët e ngatërruara të neneve me një djallëzi prif-
tërore
Na rëndonin me peshë të tmerrshme në trup, në
shpirt, në grykë.

Por dhe ne kishim me vite ligjin tonë të urrejtjes
Ligj i pashkruar, i cili me shekuj që shfaqur në qe-
nien tonë
Ligj i grushteve të mbledhura, i pushkës së fshehur
Ligj i bisedave të bukura njerëzore, në mbrëmje vonë.

Njerëz me kasketë punëtore erdhën në kasollet tona,
Në buzët e tyre po ajo sharje, po ai mallkim.
(Në kohën e rrebesheve të mëdha,
Ata strehuan vetë Shqipërinë).

Kështu arritën në tek Partia, bashkësi e gjithë li-
gjeve tona
E drejtësive tona shekullore, të marrura nëpër këmbë
E dashurive tona, të shndërruar në fëmijë të bukur
Që librat e Enver Hoxhës me lapës në duar do të le-
xojnë.

E dashurive tona për jetën, për grurin, për çdo gjë
të gjallë e të ndershme
E ligjeve tona të urrejtjes (urrejtja prapë s'u zhduk
natyrisht!)

Sepse armiku i strukur ngre vesh e përgjon.
Dhe po s'e godite të sulmon.
Kështu, fshatarët diskutojnë Projekt Kushtetutën
RPS e Shqipërisë - në nenin e parë!
Gruri gjallërohet patjetër në këto caste më shumë
Kur koha jonë nënshkruan ligjet, me mençurinë e
saj.

Bregu i Matit, mars 1976.

Për një vepër të re të arkitekturës

(vijon nga f. 7)

ambient më karakteristik kom-
bëtar.


Arkitektura ndihmon në zhvi-
llimin e arteve të aplikuara. Ajo
krijon mundësi të mëdha për
zhvillimin e tyre, sidomos në
stadin e sotëm kur kërkesat ideo-
estetike të popullit tonë. krahas
mirëqenies materiale janë rri-
tur shumë; mundësitë teknike
për krijimin e veprave të arte-
ve të aplikuara në materiale të
ndryshme janë të përshtatshme.
Krijimi i lidhjeve të tilla lozin
një rol të madh edhe në edu-
kimin ideoestetik të masave,
mbasi vepra merr një formë më
artistike, prandaj kjo kërkon ba-
shkëpunim akoma dhe më të
madh ndërmjet arkitektit, artis-
tit dhe mjeshtrove artizanë, ba-
shkëpunim që duhet të fillojë jo
kur të jetë mbaruar vepra së
ndërtuar, por qysh në fillim. Ata
së bashku, të mendojnë për çdo
sipërfaqe, çdo mur e tavan, e gjer

tek pajisjet e brendshme, qofshin
këto mobilje apo objekte të tje-
ra.

Duke e parë në këtë drejtim
edhe në këtë pallat pushimi të
punëtorëve mund të ishte bërë
një punë më e thelluar. Akoma
mund të vazhdojë pasurimi i
këtij pallati me ndonjë gobelin,
rrahje në bakër, qeramikë që të
jenë në përshtatshmëri me dho-
mat sipas funksioneve që ato ka-
në. Me shtimin e këtyre tekni-
kave, sigurisht që do të shtohen
edhe më shumë vlerat e kësaj
godine.

Megjithatë, në tërësinë e
saj, kjo shtëpi pushimi, jo vetëm
që është dhuratë e bukur për
klasën tonë punëtore, por është
dhe një vepër me vlerë e arki-
tekturës sonë, një lidhje e drejtë
me artet e aplikuara, ku janë
shfrytëzuar mjaft elementë të
arkitekturës sonë popullore.

NIKO PROGRI



Orendi sipas motiveve popullore.

(vijon nga f. 9)

bimit që i kishte mbetur. Kushedi sa do të vinte hesapi i kësaj dreke
të paporositur. Atij i duhej të rrinte disa ditë në rrethin M. dhe, po të
vazhdonte kështu ta vinte barkun në bela me detyrim, do të mbetej re-
hem i ngarkuar me borxhe.

- Para se të vijë ndonjë pjatë e pestë, më mirë qero hesapin e za-
rarit që ke bërë, kthe pjatat që s'i ke filluar dhe ngreu e ikë, - i tha
vetes Meroja.

Por kamarieri erdhi përsëri me një goxha ëmbëlsirë ndër duar.
- S'kam porositur gjë, - i tha regjisorin dhe largoi duart nga tavoli-
na, sikur donte t'i thoshte: «Deri këtu, o vëlla, s'mban më tej pilafi
ujë, le ta mbyllim këtë kapak».

- Këtë e ke nga unë. Mos ma kthe, se jam për t'u martuar e më
kthehet fati, - nguli këmbë kamarieri.

Ja pushtoi dorën me të dy duart e ia vendosi të piroi.
- Po s'më halet më, M'u bë barku lundër.

- Do t'i hash të gjitha se s'bën, përndryshe do të t'i hedhim në
qafë. Pastaj dy të rrahura janë keq, por dy të ngrëna ku m'i gjen, -
qeshi ai - hi, hi, hi... Ne jemi shumë të kënaqur nga ndihma juaj.

- Po unë akoma nuk kam filluar, - u çudit regjisorin.
- Do ta fillosh, do ta mbarosh, e do të dalim faqebardhë si nga
herë, - e ndërpreu ai.

- Ju i keni ngritur grupet artistike? - pyeti Meroja.

Kjo pyetje ja prishi humorin kamarierit. Ç'do të thoshte kjo! Ai ki-
shte disa vjet në punë dhe s'i kishte ndodhur kurrë që ndihma dhe
kontrolli të fillonin në ndërmarrjen e ushqimit social që nga grupet ar-
tistike. E pa një herë Meron në dritën e syrit dhe, si u mat mirë një

dy a tri herë, mori guximin e i tha:

- Ç'po thoni kështu, shoku regjisor?

- Regjisor, - e korigjoi Meroja.

- Bobo, ç'më bëre! - thirri kamarieri sa e pati dhe i ra kokës me
grusht.

- Ç'pate? - u çudit regjisorin nga kjo vetëgoditje në kokë.

- Po si do t'i dal përpara shefit. Ç'më bëre që t'u bëfshin harram
të gjitha ato që hëngre. Ç'do t'i japim tani revizorit që presim të vijë
nga çasti në çast?

Merua ngriti supet, pagoi ato që kishte ngrënë e doli jashtë. Ka-
marieri mbylli derën me tërsëllëm dhe shikonte me inat pjatat e mbe-
tura bosh në tavolinë dhe me përkëdheli ato që Meroja s'kishte vënë
dorë, kur nga dera e brendshme doli shefi i verdhë dyllë si limo-
ni i supës që hëngri regjisorin.

- Shaqo! - i thirri kamarierit, - E hëngrem.

- Më fal, o shoku shef, se fajin e kam unë. Na ngatërroi, i paudhi,
një regjisor, e ia dhashë të gjitha ato që kishim pregatitur për revizo-
rin që presim të vijë. Por thuaj shpyr, o shoku shef, se nuk i hëngri
të gjitha qerrataj, vetëm dy pjata boshatisi, - dhe i tregoi me dorë
pjatat e pafilluara që kishin mbetur në tavolinë.

Shefi ishte bërë pikë e vrer. Po ta thërje atë çast si delte pikë gjak.

- Hajti vetë tani, o Shaqo, - i tha i legëndisur. - Ne prisim si nga
herë revizorin e vjetër që ta fillonte kontrollin nga tavolina e gjellë-
tores të mbushur plot me pjata, ku ta dinim, nëse brenda në ndërmarr-
je paska ardhur revizori i ri, grupi i kontrollit punëtor dhe paska
filluar kontrollin nga trënjët e na nxori në të dyve me këpuce të kuqe.

GAQO VESHI

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Roli edukativ i veprave të arkitekturës

Sokrat Mosko - arkitekt

Ngado që të hedhësh vështrimin në Atdheun tonë të bukur do të shohësh transformime të mëdha; ndërtime të reja dhe qytete e fshatra të rilindur.

Kushdo nga ne s'ka si të mos krenohet me përparimet e mëdha që janë arritur si në çdo sektor të jetës sonë edhe në fushën e arkitekturës. Përparimet në fushat e tjera të jetës kanë krijuar gjithë kushtet dhe kërkime që arkitektura jonë të përmbushë edhe më mirë detyrat e saj, t'i japë popullit vepra me përmbajtje të shëndoshë socialiste, në formë të thjeshtë e të bukur, të mbështetur në tabanin tonë kombëtar.

Në një sërë materiale, vendimesh e orientimesh të Partisë dhe fjalime të shokut Enver, apo në materiale të veçanta mbi arkitekturën, është dhënë e qartë rruga jonë, detyrat për përparimin dhe lulëzimin e arkitekturës në vendin tonë. Ndërtimet të jenë të thjeshta, të bukura, të shprehin shijen socialiste, të frymëzuar nga traditat më të mira të trashëgimisë sonë në fushën e arkitekturës, të kënaqin shijen e shëndoshë të njeriut tonë të ri.

Detyrat e mëdha, të shtruara para arkitekturës sonë lidhen me rolin edukativ ideologjik dhe estetik, që arkitektura ushtron tek njerëzit. Ky rol është i madh. Lidhur me këtë në ple-numin XV të KQ të Partisë për arkitekturën është thënë se ajo **ka të bëjë shumë me edukimin**

ideo-estetik... se përpara artit, në kuptimin e ngushtë të fjalës, është ajo, arkitektura, që ushtron ndikimin estetik të parë e të pashmangshëm tek masat.

Këtë ndikim ideoestetik, këtë rol të madh edukativ arkitekturës e ushtron si me përmbajtjen e saj, me llojin, masivitetin e veprave që ndërtohen, ashtu edhe me format me të cilat shprehen kjo përmbajtje. Ky ndikim buron nga funksioni i arkitekturës në jetën shoqërore si formë e kulturës materiale dhe spiritorë. Dhe ky nuk është një rol i çfarëdoshëm, por një ndikim me përmbajtje të caktuar ideologjik dhe estetik, nuk është një ndikim spontan, por me tendencë e qëllime të caktuara që varen drejtpërsëdrejti nga ideologjia e klasës në fuqi së cilës ajo i shërben. Se arkitektura kudo dhe kurdoherë ka patur dhe ka karakter klasor, i cili kushtëzon rolin edukativ, ideologjik dhe estetik të arkitekturës. Dhe s'ka si të jetë ndryshe përderisa arkitektura duke qenë pjesë e ambientit material është një nga llojet kryesore të prodhimit të vlerave materiale, pra të bazës shoqërore, dhe si e tillë, është e lidhur ngushtë me sistemin shoqëror që e lind, me ideologjinë e tij. Le të kujtojmë periudhën e paraqitjes dhe atë të viteve të okupacionit të huaj nazi-fashist. Kujt i shërbente arkitektura në ato periudha? Ajo i shërbente klasave në fuqi që kishin pushtetin, çifligarëve dhe agallarëve, satrapëve e

fajdexhinjve, klerit dhe kolonizatorëve të huaj, borgjezisë reaktionare dhe asaj pjesë të inteligjencës së shitur. Të gjithë këta si shushnja të urryera i rrinin mbi qafë dhe i pinin gjakun popullit, të cilin e lanë në mjerim. Prandaj dhe u ndëruan kasolle të zymta e burgje të forta, për ta mbajtur të lidhur popullin, ndërsa për veten e tyre, ndëruan vila e sarahe, kisha e xhamia. Kështu, nëpërmjet këtij kontrasti të theksuar, klasat në fuqi përdornin arkitekturën për qëllimet e tyre. Nga njëra anë ata siguronin kushte luksore për jetën e tyre, duke lënë në mjerim masat e shtypura të punëtorëve dhe fshatarëve, dhe nga ana tjetër, me madhësitë dhe format e kësaj arkitekture përiqeshin të arrinin qëllimet e ideologjisë së tyre reaktionare për ta mbajtur popullin gjithnjë të shtypur, për t'i rrënjësuar atij ndjenjën e përlulesisë përpara «madhësisë» dhe «forcës» së tyre.

Të njëjtën gjendje shohim sot në vendet kapitaliste dhe revizioniste.

Ndërsa arkitektura e Shqipërisë socialiste, duke pasqyruar ide të revolucionare të Partisë sonë dhe qëllimet e larta të pushtetit popullor, si nga përmbajtja ashtu dhe nga forma ndjek dhe plotëson qëllime dhe nevoja diametralisht të kundërta. Ne ndërtojmë për popullin, për masat e gjera të punonjësve të qytetit e të fshatit, ndërtojmë në masë dhe vepra të shumëllojta, që i shërbejnë ndërtimit socialist, rritjes së riprodhimit të zgjeruar dhe të mirëqenies së masave, ngushtimit të dallimit midis qytetit dhe fshatit. Arkitektura jonë, me fondet kolosale që pushteti popullor investon për të mirën e popullit ka marrë një shtirje shumë të madhe, duke ia ndryshuar krejtësisht pamjen qyteteve dhe fshatrave, duke zhdukur në të gjurmët e prapambetjes e të dallimeve klasore, duke i kthyer ato në qendra banimi komode, me arkitekturë të lehtë, të pastër, të bukur e me thjeshtësi proletare, me dritë e gjelbërime, në luftë të ashpër me çdo ndikim të huaj për luks e teprime, ekstravagancë dhe for-

më të shijes borgjezo-revizioniste. Qytetet tona zhvillohen e transformohen pa dallime klasore. Është zhvilluar e zbuluar kryeqyteti i Atdheut tonë, Tirana, por janë zhvilluar, transformuar e përtërirë qytetet ekzistuese e kanë lindur të rinj, shumë të tjerë si Gramshi, Librazhdi dhe Erseka, Puka dhe Kukësi i Ri, Laçi dhe Ballshu e kështu shumë qytete dhe fshatra. Vepra të panumërta ekonomike, fabrika e kombinat madhështore, spitale dhe shtëpi kulture, shkolla, kopshte, çerdhe e ndërtime të tjera shoqërore, kulturore dhe komunale mbushin sot anëmbanë Atdheun tonë. Në Tiranë vetëm gjatë pesë-vjeçarit të pestë u ndëruan mbi 8500 apartamente dhe shtëpi të reja banimi. E kështu të gjithë qytetet dhe fshatrat tona janë të mbushura me ndërtime të reja.

Të gjitha këto ndërtime madhështore me shtrirjen e tyre të gjerë, me masivitetin, llojin dhe funksionin që kryejnë në shërbim të popullit ushtrjnë një ndikim të madh edukativ tek masat. Ato shtojnë optimizmin dhe vullnetin e njeriut tonë për ta zbuluar më tej Atdheun, për ta fuqizuar e begatuar atë se Partia, çdo gjë e bën për popullin. Është kjo forcë e madhe edukative e arkitekturës sonë të realizimit socialist, e cila, duke u përshkuar nga ideologjia revolucionare marksiste-leniniste e Partisë sonë dhe mësimet e shokut Enver, ndikon drejtpërsëdrejti në edukimin e njeriut tonë, që ai kudo të krenohet me qytetin dhe fshatin e tij, me transformimet dhe lulëzimin e arritur. Nga kjo u dalin detyra të mëdha punonjësve të ndërtimit, arkitektëve, projektuesve të tjerë, punëtorëve, mjeshtrave dhe personelit inxhiniero-teknik të zbatimit, që ta përdorin me nikogjilëk çdo lek në investimet dhe duke projektuar e ndërtuar me ekonomi të madhe, me fondet e planifikuara të përfitohet më shumë sipërfaqe e dobishme, që të plotësohen më mirë kërkesat e zhvillimit socialist e të jetës së popullit dhe këto ndërtime, kjo arkitekturë me përmbaj-

(vijon në f. 13)



Ndërtime në një nga rrugët e Tiranës.

(Foto: P. Kumi)

Roli edukativ i veprave të arkitekturës

(vijon nga f. 7)

tje socialiste të lozë edhe më mirë, edhe më fort rolin e saj edukativ.

Nën ndikimin e ideologjisë borgjezo-revizioniste edhe tek disa nga ne arkitektët, sidomos para plenumit IV të KQ të PPSH, u dukën shenjat e koncepteve dhe të shijes së huaj. Ato u shfaqën nga mosthelli i mjaftueshëm në mësimet e Partisë, nga kuptimi i cekët i karakterit klasor dhe i brendisë ideologjike të arkitekturës. Ky është ndër shkaqet kryesore që disa nga ne arkitektët, ndër ta edhe unë, ramë në ndikimin e shkëlqimit falco të arkitekturës reklamiste borgjezo-revizioniste mbi disa çështje të estetikës së arkitekturës sonë, të cilat gjetën vend edhe në një artikull që kam shkruar bashkë me dy kolegë më 19.3.72 me titullin e gabuar «Bukuri që e ndërtojmë apo ndërtime që i zbu-kurojmë», ku bëhen disa teorizime të ndikuara nga arkitektura e huaj lidhur me raportin e faktorëve ekonomikë dhe estetikë, duke anuar nga këta të fundit, me tipizimin, ndaj të cilit kemi mbajtur qëndrim skeptik, me forcimin e tipareve kombëtare të arkitekturës sonë që e kemi ngritur si detyrë të arkitekturës dhe pasurisë e madhe të trashëgimisë sonë, të cilën edhe pse nuk e kemi mohuar kemi shfaqur mendime të padrejta lidhur me mënyrën e shfrytëzimit të saj. Ato ishin koncepte të gabuara, që qenë reflektuar edhe në disa projekte konkrete si p.sh. në kinoteatrin e Fierit, projektuar nën ndikimin e shijes së shëmtuar të arkitekturës borgjezo-revizioniste. Tendenca të gabuara u dukën edhe në punën e disa arkitektëve të tjerë me xhamllëqe të tepruara dhe lartësi të pajustificuara, me tendencë luksit dhe gjigandomanie, përpjekje për lavdi personale, me faqe muresh të plota e gjithfarë formash të çrregullta krrabash e strehësh të ndikuara nga shija e shëmtuar e huaj si biblioteka e Korçës, teatri në Sarandë, godina ATSH, Agjencia Ajrore, pallati karshi mapos nr. 1 në Tiranë, stacioni foragjerëve Fushë-Krujë, hoteli e larta në Tiranë, Shkodër, Korçë, Elbasan e Sarandë, godina administrative në Corovodë e Fier, kabinat në Currilat Durrës e disa të tjera.

Duke u thelluar në materialet e plenumit IV të KQ të PPSH dhe fjalimet historike të shokut Enver, arkitektët, së bashku me projektuesit e tjerë nën udhëheqjen e organizatave-bazë të Partisë dhe të ndihmuar nga punëtorët e ndërtimit e të shfrytëzimit, në mbledhje, analiza e aktive të gjera, i kanë rrahur gjerësisht këto probleme, kanë zbuluar shkaqet e ndikimeve të huaja në arkitekturën tonë dhe format e shfaqjes së tyre, duke përcaktuar njëkohësisht edhe masat dhe punën që do të bëhet. Por kjo punë lipset të thellohet më tej me një punë më të bashkërenduar nga Ministria e Ndërtimit, Akademia e Shkencave, Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve, Universiteti, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Institutet dhe zyrat e projektimit dhe ndërmarrjet e ndërtimit. Du-

ke tërhequr gjerësisht mendimin e masave të gjera të punëtorëve e mjeshtrove të talentuar të ndërtimeve të ndërmirren studime shkencore e të bëhen përgjithësimet, konkluzione e të nxirren detyra të qarta e konkrete, me qëllim që t'i pritët çdo shteg këtyre ndikimeve, që arkitektura jonë të zhvillohet e të lulëzojë e shëndetshme. Këto, në radhë të parë, për të kuptuar sa më thellë e për të zbatuar sa më mirë mësimet e Partisë mbi karakterin klasor të arkitekturës dhe mbi rolin e saj të madh edukativ, ideologjik dhe estetik. Këtë rol arkitektura jonë e realizmit socialist do ta kryejë si duhet duke forcuar tiparet e saj dalluese origjinale shqiptare, me formë kombëtare të mbështetur në traditat tona të pasura dhe në karakteristikat e vendit tonë. Se vërtet arkitektura e çdo kohe ka përfaqësuar dhe ka shprehur ideologjinë e klasave të ndryshme, por në veprat e ndërtuara, mjeshtri i madh popullor ka shkruar talentin dhe aftësitë e tij të rralla krijuese dhe ka bërë vepra sipas shijes së tij të thjeshtë e të lartë. Me dashuri e pasion latoi populli gurin që vuri në vater e në qoshen e shtëpisë, drurin që vuri në strehën e çatisë. Megjithë kushtet e vështira politike dhe ekonomike të rrethave shfrytëzuese populli ynë ka ndërtuar vepra me vlerë funksionale dhe artistike që përbëjnë një pasuri shumë të madhe, por që nuk është vlerësuar sa duhet, prandaj dhe përpjekjet serioze për ta njohur hollësisht, për ta dashuruar, përgjithësuar e përdorur, nuk janë kryer në shkallën e duhur.

Ndonjë mendim i shkëputur, që duket tek ndonjëri, që e njëjësion këtë përpjekje me «anakronizëm» dhe me gjoja shpenzime të teprta, që na u dashkan për të përdorur forma e traditën tonë në artin e të ndërtuarit është padyshim i gabuar dhe i ndikuar nga ideologjia e huaj.

Mjeshtri popull nuk ka krijuar gjëra ekstravagante e të mbingarkuara, ai ka ndërtuar me një thjeshtësi shumë të madhe, por me forma e proporcione që dallohen nga një harmoni dhe bukuri e rrallë. Për këtë le ta hedhim vështrimin qoftë edhe tek Berati dhe Gjirokastra. Në to shfrytëzimi me mjeshtëri të rrallë i terrenit është i përkryer, ndërtimi i është përshatuar terrenit të thyer, duke shfrytëzuar çdo pëllëmbë tokë e shkëmb, i lidhur organikisht me natyrën, me një kombinim të habitshëm mjetesth e materialesh të thjeshta, të përdorura me ekonomi shumë të madhe, janë krijuar forma e proporcione me bukuri e elegancë të jashtëzakonshme, duke shfrytëzuar me mjeshtëri të rrallë orientimin, dritën, gjelbërimin në dobi të një funksioni të përsosur e të pamjeve nga më të ndryshmet, njëra më e bukur se tjetra.

Me të tilla pasuri është i mbushur i gjithë Atdheu ynë dhe detyra jonë është t'i njohim mirë, t'i studiojmë, të zbulojmë vlerat e tyre të mëdha ekonomike, funksionale, teknike dhe estetike dhe në mënyrë krijuese, në përputhje me kushtet dhe kërkesat e jetës sonë.


SOKRAT MOSKO

PAK HUMOR



Atyre që nënvleftësojnë traditën.

(Viz: Z. Bunçaj)



Je larguar shumë nga baza.

(Viz: V. Lalo)



Tavolina e ndonjë redaktori.

(Viz: Sh. Palushj)

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Të njohim elementët

arkitektonikë të banesës

Valentin Voshtina - arkitekt, Burrel

Problemi i karakterit kombëtar në arte i ka preokupuar vazhdimisht krijuesit tanë. Por ndërsa në gjini të tjera të artit si në pikturë, skulpturë, në muzikë letërsi etj. janë shfrytëzuar krijimet e bukura të artit popullor, për forcimin e karakterit kombëtar, në arkitekturë, akoma nuk po shprehet siç duhet në krijimet e sotme, ai trashëgim i bukur e ajo larmi e pasur e artit tonë të ndërtuarit. Në goftë se do të kishte vazhduar puna e nisur para disa vitesh, por duke luftuar dobësitë që u shfaqën në fillim, bie fjala, tek godinat e banimit pranë hotel Pezës, në Tiranë, sot do të kishim krijime shumë më të bukura e më me vlerë, tek të cilat do të ndihej mirë kombëtarja.

Futja e frymës kombëtare në ndërtimet tona, zgjidhja e drejtë e këtij problemi merr një rëndësi të dorës së parë, sepse ato (ndërtimet) përbëjnë vetë ambientin material ku jetojmë e puno-

jmë, i cili ndikon në formimin e shijeve tona ideestetike.

Është e domosdoshme një studim i përgjithshëm i artit tonë popullor e i kushteve social-ekonomike e politike që ndikuan në formimin e tij. Njohja thellë e banesës, e elementëve arkitektonikë dhe evidentimi i tyre në ndërtimet e sotme përbën në vete një punë të vështirë. Ndërsa mund të arrihet thellësi në këtyre detajeve karakteristike në përshtatje me materialet e sotme të ndërtimit dhe të arkitekturës bashkëkohore, shprehja e tyre harmonike, duke iu ruajtur formalizmit, paraqet sot një problem që duhet zgjidhur drejt. Sigurisht, është gabim të mendohet se kombëtarja në arkitekturë mund të arrihet me vendosjen shabllone të disa clementëve të arkitekturës popullore ose nëpërmjet veshjes së gurit në ndërtimet e sotme. Guri është përdorur kudo, si material rrethor

për ndërtim dhe ne nuk mund të pretendojmë se guri na qënka kombëtar (siç mendojnë disa) dhe me kaq çështja u zgjidh. Jam dakord me përdorimin e gurit si material rrethor dhe për ndërtim, dhe për veshje, por ai duhet të jetë në funksion të përmbytjes dhe i harmonizuar me clementët të tjerë të arkitekturës popullore. Mendoj se në disa raste veshjet me gurë janë tepëruar, duke shkuar drejt veshjes për

veshje, që shpesh të kujton veshjen me linoleum se sa veshjen me gurë.

Artin e të ndërtuarit popullor e gjejmë mjaft të larmishëm dhe të pasur po ashtu siç gjejmë dhe veshjet, këngët e zakonet e krahinave të popullit tonë. Ndryshe e gjejmë banesën në Gjirokastrë, ndryshe në Berat e

(vijon në f. 11)



Qoshku i kullës matjane.

Godinë e madhe, por me pak vlera

Nga një diskutim

Në vazhdim të diskutimit «Mendimi ynë për karakterin kombëtar në arkitekturë» që ka hapur gazeta jonë, para pak kohësh, në Elbasan, u organizua një diskutim me arkitektë, piktorë, ndërtues e punonjës të ndryshëm lidhur me godinën e hotelit «Skampa», projektuar nga arkitektja Valentina Pistoli.

Nga mendimet e shumta që dolën, në fillim u vlerësua puna e arkitektes në disa pjesë të hotelit. Në diskutimin e tij piktori **Andon Lakuriqi** tha se në këtë godinë gjen një zgjidhje të drejtë të raportit të volumeve midis atij horizontal e vertikal. Gjen edhe një pastërti dhe thjeshtësi të linjës dhe një plastikë dekorative që thyen monotoninë e sipërfaqeve të mëdha, siç janë dy faqet anësore të zhvillimit vertikal.

Por, përsa i përket mbështetjes në traditën tonë, për shfrytëzimin e kriimeve të popullit në këtë fushë, vazhdoi më poshtë ai, mbetet mjaft për të dëshiruar. Në pamjen e jashtme, po kështu edhe në ambientet e brendshme

ndërtesa nuk pasqyron pothuaj asgjë kombëtare. Kjo bëhet në një kohë kur në artin tonë të realizmit socialist i kushtohet një vëmendje e veçantë karakterit kombëtar, mbështetjes në traditën e popullit, për të krijuar më të plotë origjinalitetin e kulturës sonë të re.

Vetëm dy ambientet verore të katit të parë e të dytë, tha piktori **Bukurosh Sejdiu**, të kujtojnë në arkitekturën popullore dhe i përshtaten më mirë psikologjisë së njerëzve tanë. Një dalje të tillë e gjejmë sidomos në ndërtesat e Shqipërisë së Mesme, ku janë ndërtuar hajate të gjatë në të dyja katet, ku njerëzit dalin për t'u lodhur, për të kaluar kohën e lirë pas punës.

Kuptohet, vazhdoi më poshtë ai, këtu nuk është fjala që të kopjojmë e t'i vendosim në mënyrë shabllone elementë kombëtar goftë edhe vetëm nga Shqipëria e Mesme, por duke u mbështetur tek ato mund të krijojmë shin elementë të rinj, që t'i përshtaten jo vetëm godinës së re,

por më kryesorja, shijeve të reja estetike të njerëzve tanë.

Në ambientet e tjera nuk gjejmë pothuaj asnjë mbështetje në arkitekturën kombëtare; duke filluar qysh nga forma e lokalit, nga vendosja, mobilimi e deri tek ndërtimi. Sidomos një diktuesi më e madhe, tha në diskutimin e tij arkitekti **Athanas Ndrecko**, ndjehet në sallën e taverne. Këtu, ku është më i domosdoshëm krijimi i një ambientit intim, ku kishte mundësi të përdoshin më tepër clementët të arkitekturës popullore nuk gjen asnjë element, që të kujtojë trashëgiminë tonë të pasur në këtë fushë. Mjaft krijime të bukura në dru e materiale të tjera që mund të krijonin një atmosferë të përshtatshme këtu nuk gjejmë dhe e ndjen veten pothuaj njëjloj si në lokalet e tjera të hotelit. Dihet se në këtë fushë ne kemi një trashëgimi të madhe. Me gurin, drurin dhe rrahjet në metal, populli ynë ka krijuar elementë të bukur, që i ka vendosur në shtëpitë e tij. Këto janë mjaft të larmishëm dhe duke i pasuruar më tej mund të përshtaten fare mirë në një lokal të ri, jo vetëm për të krijuar një ambient më të këndshëm, por edhe për t'i dhënë një fytyrë më të qartë kombëtare vetë ndërtesës. Edhe në ambientet e tjera ndodh e njëjta gjë. Kjo ka krijuar edhe monotonin sidomos në mobilimin e gjen të njëjlojtë në çdo ambient.

Po kështu është vepruar edhe me shtrimin e dyshemeve, tha ndërtuesi **Shpëtim Haxhihyseni**. Këtu ne trashëgojmë një traditë të mirë, por asgjë nuk shohim nga ajo. Vendosja e pllakave i është lënë zbatuesit dhe ai i ka vendosur kudo njëjloj pa krijuar ndonjë motiv të mbështetur në artin tonë popullor. Kjo do të krijonte edhe larmi e bukur në ambientet e hotelit.

Arkitektura jonë popullore ka edhe mjaft elementë të ndryshëm e të bukur që mund t'i përshtatshin kësaj godine.

Siç doli edhe nga diskutimi, ka arkitektë që nuk e njohin sa duhet traditën tonë në arkitekturë. Kjo reflektohet në ndërtimet e bëra deri tani dhe në projekte të tjera. Studimet e botimet e deritanishme, për traditën tonë në arkitekturë, tha arkitekti **Gëzim Jaxexhiu**, janë akoma në fazën e parë, por megjithëkëtë arkitektët gjejnë një fushë të gjërë për t'u njohur me krijime të bukura të popullit tonë. Vetëm nga një studim e analizë e thellë, nga pozitat tona ideologjike, siç na porosit Partia, dhe nga një vlerësim më i madh që i duhet bërë traditës sonë në këtë fushë, veprat e ardhshme në arkitekturë do të kenë një fytyrë më të qartë kombëtare për t'u thelluar në traditën e re në arkitekturë si në çdo gjini të arteve tona të realizmit socialist.

Korresp. i «Dritës»



Tornitoret

Festivale të rinisë studenteske

TIRANE

Në pallatin e kulturës «Studenti» të Universitetit të Tiranës përfundoi festivali i dytë folklorik i rinisë universitare, organizuar në kuadrin e 35-vjetorit të themelimit të Partisë dhe të diskutimit e miratimit të Projekt-kushtetutës të RPS të Shqipërisë.

Në këtë festival u aktivizuan rreth 500 të rinj e të reja. Spektatorët duartrokiten interpretimin me ndjenjë e nivel të lartë artistik të këngëve, valleve e melodive të bukura që populli ka thurur për Partinë e shokun Enver, për jetën e ndërtimin socialist, për heronjtë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare etj. Në këtë festival pati dhe mjaft krijime të reja nga vetë studentët si këngë të grupeve labe dhe të Veriut, për 35-vjetorin e themelimit të Partisë, për Projekt-kushtetutën e RPS të Shqipërisë. Ndërkohë, grupet kanë filluar të japin shfaqje në kooperativa bujqësore, rrepte ushtarake e në kantiere ndërtimi, ndërsa grupi folklorik i fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë ka dhënë shfaqje edhe në rrethin e Krujës.

SHKODER

Për 9 ditë me radhë u zhvillua festivali i estradave të 4 fakulteteve të Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, ku u aktivizuan studentë e pedagogë. Shfaqjet i bënin jehonë hovit revolucionar në punë, aksioneve të rinisë, jetës së re e të gëzuar në fshatin tonë socialist, luftës kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale dhe trajtonin gjerësisht aspekte të punës mësimore-educative në fakultete dhe të kënaqësisë që shpreh brezi ynë i ri për të shërbyer ku të ketë nevojë Atdheu.

U pëlqyen këngët popullore të krahinave të ndryshme të vendit, kënga polifonike «Kushtetutën që e hartove, në popull e diskutove», skeçet, monologët, intermezoet dhe paroditë që vinin në tallje kushtetutën e vjetër të rendit borgjez, që godisnin tendencën e të kënaqurisë me pak në dëm të cilësisë së mësimi si dhe pjesë të tjera të shkruara nga vetë studentët.

Me flamurin e këtij aktiviteti u nderua estrada e fakultetit të biologji-kimisë. Mjaft studentëve të dalluar në këtë aktivitet u dhanë fletëlavdërimi. (ATSH)

Të njohim elementët arkitektonikë të banesës

(vijon nga f. 7)

ndryshe nga të tjerat e gjejmë kullën matjane. Pra është e natyrshme që t'i ruajmë e t'i pasurojmë karakteristikat lokale të shfaqura në artin e të ndërtuarit, për të evituar monotoninë e uniformitetin. Kjo do t'i shërbejë qëllimit të madh kombëtar, për ruajtjen e ngjyrës së veçantë karakteristike të qyteteve e fshatrave tona.


Kulla matjane, e cila dallohet për vendosje në vende dominuese, për zgjidhjen funksionalo-utilitare e prirur nga synimi për të rritur aftësitë mbrojtëse është banesa mbizotëruese në fshatrat e rrethit të Matit. Elementët e vetëm që dekorojnë ndërtesën dhe gjallërojnë pamjen e jashtme janë cikmatë dhe dyert e punuara me mjeshtëri, me gurë të gdhëndur e të zbukuruar me ornamentë të marra nga arti popullor. Mendoj se ky element i përhapur gjerësisht në kullën matjane pas një stilizimi të kujdesshëm e i harmonizuar drejt, mund të zërë vend në projektet e ndërtimit tona, duke nxjerrë në pah karakteristikën e veçantë të banesës fshatare matjane.

Kullën matjane e gjejmë mjaft

të larmishme dhe në zgjidhjen e saj volumore, që me thjeshtësinë e elementëve arkitektonikë shpreh karakterin e vetë banesës. Pra, siç shihet, artin e të ndërtuarit popullor e gjejmë me elementë të punuar me shije dhe në zgjidhje të bukura volumore, që kanë rrjedhur nga kërkesat për një zgjidhje sa më të pastër funksionale. Kemi një thesar të madh përpunues të krijuar nga gjeniu popullor. «Me shëllirë e ka ngjyer kafshatën në të kaluarën populli ynë, - ka thënë shoku Enver, - por pjatën e drunjte e kishte të skalitur si s'ka më bukur». Në ndërtimet fshatare gjejmë të përdorur gjerësisht drurin, edhe si material konstruktiv, edhe për veshje. Në të dyja rastet druri është punuar me ndjenjë e shije të hollë. Për këto tipare, të vërejtura në kullën matjane, duhet punuar me piktorët, skulptorët, duke tërhequr dhe mendimin e mjeshtërve tanë të ndërtimit për të arritur rezultatet e dëshiruara.

Në arkitektëve na takon të studiojmë traditën për të futur kombëtarin në ndërtimet tona, për të ngritur në një shkallë më të lartë artistike atë që kemi trashëguar.

VALENTIN VOSHTINA



Në ekspozitën e piktorit.

(Foto: P. Naçe)

Diskutim krijues mbi karakterin kombëtar të arkitekturës dhe urbanistikës sonë

Para pak ditësh, komisioni i arkitekturës pranë Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, organizoi një diskutim për formimin e karakterit kombëtar të arkitekturës dhe urbanistikës. Merrnin pjesë arkitektë, piktorë, skulptorë, studentë si dhe të ftuar të tjerë. Diskutantët ngritën disa probleme që kanë të bëjnë me forcimin e karakterit kombëtar, si shfrytëzimi më i drejtë, si traditës sonë, i krijimtarisë popullore, njohjen e përhapjen më të madhe të përvojës së krijuar gjatë viteve të pushtetit popullor, të industrializimit të ndërtimeve, probleme të tipizimit e standartizimit, shikimin e këtyre problemeve nga ana ekonomike, marrjen më të gjerë të mendimit të masave, sidomos të mjeshtrave popullorë, në ndërtimet e reja, shfrytëzimin më me kujdes të materialeve rrethana

apo elementëve arkitektonikë sipas specifikës së çdo krahine e mjaft probleme të tjera.

Diskutimin e hapi kryetari i komisionit të arkitekturës pranë Lidhjes arkitekti **Besim Daja**. Pastaj diskutuan: **Valentina Pistoli, Mërgim Cano, Andon Lufi, Kostaq Sahatçi, Fatmir Haxhiu, Vilson Kilica, Kostaq Taja, Mumtaz Dhrami, Faik Alimehmeti.**

Në diskutim foli edhe sekretari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë **Kujtim Buza**.

Diskutime të tilla, këto ditë, u organizuan edhe në Institutin e Studimeve dhe të Projektimeve nr 1 në degën e arkitekturës të Universitetit të Tiranës dhe në Komitetin Ekzekutiv të k.p. të rrethit të Tiranës, ku u rrahën mjaft mendime rreth këtij problemi.

Korresp i «Dritës»

Aktivite të kulturës masive

Me pjesëmarrjen e 20 shtëpi-ve të kulturës në kooperativat bujqësore të rrethit të Shkodrës filloj këto ditë takimi i 4-t i aktiviteve të kulturës masive, me temë: «Lufta për bukën ëshëme luftë për socializëm». Njëpër-

mjet formave të ndryshme në shërbim të këtij aktiviteti, si bisedave, debateve, ballafaqimeve, pyetje-përgjigjeve si dhe programit artistik, pasqyrohet puna e gjithanshme e kooperativiteve për të bërë realitet detyrën

e prodhimit të bukës në vend. Aktivite të tilla u zhvilluan ditët e fundit nga shtëpitë e kulturës në Postribë, Bërdicë, Bushat, Barbullush dhe Mjedë.

Takimi i 4-t i aktiviteve të kulturës masive, që po vazhdon, është pasqyrë e përpjekjeve të mira për ta vënë punën e institucioneve kulturore të fshatit në shërbim të zërthimit të detyrave që ka caktuar Partia në rit-

jen e prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe para së gjithash për ta prodhuar bukën në vend. Në këtë aktivitet do të konkurrojnë edhe shtëpitë e kulturës të zonave malore. Përveç konkurimit, programi i aktivitetit të kulturës masive me temë «Lufta për bukën është luftë për socializëm» do të jepet edhe në sektorët e kooperativave bujqësore. (ATSH)

Në klubin e Lidhjes



(Foto: F. Maliqi)

Të premtën, në klubin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, pedagogë dhe studentë të Institutit të Lartë të Arteve dhanë një koncert vokal-instrumental, i cili u pëlqye mjaft nga spektatorët. Bukur e me freski tingëlloi orkestra e harqeve nën drejtimin artistik të pedagogut **Ibrahim Madhi**, e cila ekzekutoi

«Koncert për dy violina dhe orkestër» të J. S. Bahut (solistë **I. Madhi, V. Ajazi**). Në program prfshiheshin edhe pjesë muzikore nga autorët tanë, që u ekzekutuan nga studentja e vitit të parë për piano **Valbona Shehu** dhe studentja e vitit të tretë për kanto **Suzana Rrapaj**, të cilën e shoqëroi në piano **Iris Kapo**.

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Thesare të arkitekturës popullore

Vlerat e traditës kombëtare në arkitekturë e urbanistikë i gjejmë në qytet e fshat, në shtrirjen tërësore të tyre, në harmonizimin midis lagjeve dhe ndërtesave me njëra-tjetrën, në kompozicionin e banesave karakteristike dhe deri në ornamentet dhe dekoracionet e tyre të brendshme. Po ashtu, tiparet kombëtare të arkitekturës sonë i gjejmë të mishëruara në forma të ndryshme, çka shpreh larinë e saj. Mirëpo, edhe pse shfaqen në forma të ndryshme, ato kanë një bosht trajtimi unik, kanë një thelb; që i bën të dallohen nga veçoritë e arkitekturës së një populli tjetër. Dhe këtë e shikojmë si në arkitekturën popullore edhe në traditën e asaj të realizmit socialist. Shumë herë, në krahina të ndryshme të vendit, të zë syri grupe fshatrash, kjo ndodh rrallë me qytetet, të ndërtuara mbi një shfrytëzim të përafërt të terrenit, të klimës etj.

Kjo u ka dhënë atyre disa veçori të përbashkëta funksionale e kompozicionale, që kanë ardhur jo thjesht nga klima e terreni, por edhe nga kushtet historike kur janë ndërtuar, nga marrëdhëniet shoqërore e familjare midis njerëzve, nga shijet, zakonet e popullit etj. P.sh., kemi fshatrra të tëra që shtrihen në rrëpi-ra, po janë të orientuara nga ka më tepër diell, lagje të ndara nga përrenj po me shtëpi të rrethuara me mure, qark tyre baçet dhe pemët po me mure.

Vlerat dhe veçoritë kombëtare të arkitekturës i gjejmë në fshat e qytet, kurse në qytetet-muze kemi si të thuash një sintezim, një grumbullim të tipareve të arkitekturës kombëtare. Kështu, p.sh., shtrirja e qytetit të Gjirokastrës në kodër është një karakteristike jo vetëm e kohës kur është ndërtuar qyteti, por një veçori e përgjithshme e qendrave të banuara shqiptare. Dhe kjo për arsye politiko-ushtarake dhe ekonomiko-shëndetësore.

Të parët tanë, kur kanë ndërtuar Gjirokastrën në kodër si edhe Beratin, Krujën etj., kanë ruajtur tokat e bukës. Por me këtë prirje janë ndërtuar edhe qytete të reja si Çorovoda, Ballshi etj. Dhe kjo është një traditë, që vlen të ruhet për arsye se përputhet edhe me kushtet e ndërtimit tonë socialist. Një gjë e tillë theksohet pasi ka patur raste që i është shmangur kësaj tradite pozitive. Në fillim plani i qytetit të Ballshit ishte parashikuar në fushë, po kjo u kritikua dhe jo thjesht për hir të traditës, por edhe për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të kohës. Dhe tani ai po shtrihet për bukuri në kodër. Dhe nuk është problemi vetëm i qyteteve dhe i fshatrave të reja që ngrihen, por kjo vlen të zbatohet edhe në zgjerimin e qyteteve ekzistuese, sigurisht, kur kjo është e mundur. Kështu, arkitektët dhe inxhinierët e Gjirokastrës, me disa prej tyre para ca kohësh u organizua një bisedë, janë të një mendimi se qyteti fare mirë mund dhe do të vazhdojë të shtrihet në kodër.

Po në qytetin e Gjirokastrës

gjejmë shumë veçori të tjera karakteristike, që vlejné të përgjithësohen dhe të zbatohen në arkitekturën tonë të realizmit socialist. E tillë është edhe ana urbanistike e qytetit, vendosja e tij e drejtuar nga lindja dhe jugu, që janë edhe më të pëlqyerat për shtrirjen e qyteteve. Po kështu, mund të përgjithësohet dhe të mësohet edhe prej sistemit radial të rrugëve, të cilat, të gjitha të çojnë në qendër. Këtë e ka edhe Tirana, Fieri etj. Kjo i shkon arkitekturës moderne, të sotme, dhe mund të themi se është aq e kohës sa çka qenë edhe kur është ndërtuar Gjirokastra.

Vlera të mëdha arkitektonike ruan shtëpia karakteristike gjirokastrite. Banesat e këtij qyteti janë njëra më e bukur se tjetra. Po të studjosh me vëmendje këtë banesë gjen në të evolucionin funksional edhe në formën planimetrike. Afër njëra-tjetrës ndodhen shtëpi me moshë të ndryshme, e megjithatë të harmonizuara mirë me njëra-tjetrën, dhe të gjitha në ansambllin arkteonik të qytetit.

Për të ndërtuar këtë banesë ka punuar artisti i gurit dhe i drurit dhe ia kanë nënshtruar njërit-tjetrit punën e tyre si rrallë gjëtkë. Originaliteti i saj nuk qëndron vetëm në muret dhe volum, po edhe në zbulimet në dru, që nga sergjenet, te dollapet, tavannet, dhipatot etj. Kjo harmoni dhe origjinalitet kërkoi e gjeti një shtrirje më të madhe, në tërësinë e qytetit. Kështu, me këtë stil e në harmoni me ndërtimet e tjera u bë pazari, dyqanet, ansambli i tregut me gur të gdhendur, me tarabatë e hekurta, me strehët e hedhura jashtë, me kalldrëmin në formë ulluku, që e merrte ujin në mes. Ndërsa në të pesë rrugët e tregut, që janë si pesë cepa e bashkohen në Qafën e Pazarit, shtrihet një gjelbërim i këndshëm edhe për të bërë hije në treg, dhe për ta gjelbëruar atë në formë tuneli, po edhe për të thyer monotoninë e ngjyrës së gurit. Nga arkitektura tradicionale e qytetit të Gjirokastrës ka ç'të mësojë arkitekti edhe në harmoninë e gjithanshme që ka ndërtesa, në të gjitha pamjet e saj. Një vend të veçantë, në arkitekturën e këtij qyteti, merr forma dhe ngjyra e çatisë, e cila për relievin kodrinor, është e dukshme. Me një fjalë, në Gjirokastrë ndërtesa është me shumë pamje, pasi i shtohet edhe ajo e çatisë, e megjithatë është zgjidhur drejt nga arkitekti-popull.

I nisur nga kjo, për ta ruajtur sa më autentike anën muzeale të qytetit, Lefter Dilo shprehu mendimin që një rrugë e tregut të merrte tamam formën e dikurshme, siç është bërë edhe në Krujë. Një rrugë e tillë, tha ai, do të ishte një kënd muzeal i gjallë.

Arkitekti ynë, u tha në bisedë, ka ç'të mësojë nga arkitekti popullore edhe se si ia ka përshtatur ai klimës ndërtimet, duke patur parasysh karakterin e ndërtesës, përmbajtjen e saj, leverdinë ekonomike etj. P.sh., qyteti i Gjirokastrës është shu-

më i nxehtë në verë e shumë i ftohtë në dimër. Prandaj edhe kompozicioni i shtëpisë karakteristike të saj është zgjidhur me dhomën e dimrit (dimërore pat) me vendin e zjarrit (oxhak), me mure të gjera dhe ditrate të vogla, dhe me dhomën e verës (oda), që është në katin e sipërm me sipërfaqe xhami të madhe.

Këto përmenden, sepse ka patur raste si në Tropojë, Korçë etj. që nuk është patur parasysh kjo përvojë e mirë e arkitekturës popullore për zgjidhjen kompozicionale të ndërtimeve në vartësi nga klima. Shtëpitë gjirokastrite janë të gjitha me strehë. Kjo ka ardhur se në këtë qytet bien shumë rreshje. Mirëpo ka mjaft raste që janë bërë ndërtime pa strehë. Dhe kështu rreshjet bëjnë punën e tyre: ambientet brenda në këto ndërtesa janë me lagështirë. Ja se si funksioni dëmtohet në emër të «modernes».

Është e vërtetë që po të krahasohet dhoma karakteristike gjirokastrite me ato të apartamenteve shihet se nuk ruhet proporcionaliteti. Që të ruhet ky proporcionalitet në ndërtimin e apartamenteve, sigurisht është e vështirë, por nuk do të thotë se është e pamundur të gjendet një proporcionalitet më funksional, si-

kurse nuk kërkohet që nëpërmjet tij të ruhen po ato volume e forma.

Por në ruajtjen e vlerave arkitektonike, qofshin këto edhe ndërtesa të grupit të parë, nuk duhet të tregohemi të ngurtë e konservatorë, sikurse nuk na lejohej të jemi liberalë. Në praktikë vihen re, edhe pse të pakta, raste të një shabllonizimi të theksuar që jo vetëm nuk kanë ndihmuar në ruajtjen e traditës së vjetër dhe të asaj të re, të realizmit socialist, po përkundrazi, e kanë keqpërdorur atë. Është bërë p.sh., rikonstrukcioni i poliklinikës në Gjirokastrë, ku është ruajtur ana e jashtme e ndërtesës. Atje u ndërtua një godinë e re mbi një mur të shkatërruar. Një mur i saj ishte shtrembëruar nga koha. Megjithëse kjo duket sheshit u ngul këmbë, dhe preteksti i Institutit të Monumenteve ishte të ruhejshin disa forma punimi, që ai të ndërtohej ashtu siç që, dmth i shtrembër. Dhe tani, që ka përfunduar, muri lëviz disa centimetra. Kuptohet se këto janë gabime të rënda, sikurse janë edhe ato kur kërkohet të ndërtohet muri me po ata gurë të vjetër, të kalbur, në vend që të zëvendësohen me të rinj, po të ruhet forma, ngjyra, lidhja etj. Për këtë foli inxhinier **Thanas Kamberi**. Po jo gjithëcka duhet parë si e vlefshme në arkitekturën e vjetër. Ka plot gjëra, të cilave u ka ikur koha dhe nuk vlejné më. Të kërkosh, bie fjala, të ndërtosh në qytete të rinj rrugë të ngushta si të Gjirokastrës, nuk është e drejtë, se zhvillimi sho-

(vijon në f. 11)



Shtëpi karakteristike në Gjirokastrë

Thesare të arkitekturës popullore

(vijon nga f. 7)

qëror kërkon rrugë të gjera. Bile, edhe në qytetet muze, jashtë zonës muzeale, ka vend që arrieret kryesore mund të zgjerohen për t'u përgjigjur lëvizjeve të shumta, por edhe këto pa prishur, qoftë originalitetin, qoftë strukturën e përgjithshme të qytetit.

Jeta kërkon që edhe në qytetet-muze të bëhen ndërtime të reja. Natyrisht, këto do të bëhen jo vetëm duke shfrytëzuar e zhvilluar më tej traditat tona të vjetra dhe ato të realizimit socialist, por edhe duke ruajtur të paprekshme zonat muzeale.

Përvoja jonë, tha arkitekti **Genç Braja**, tregon se banesës gjirokastrite mund t'i bëhen punime të brendshme pa ndryshuar pamjen e jashtme po edhe të kryejë funksionin sipas kërkesave të kohës. Kjo zbatohet me dobi kur funksioni nuk ndryshon.

Ndërsa kur objekti përshtatet për një funksion tjetër ai demtohet shumë si dhe ana funksionale nuk del plotësisht e përshtatshme.

Në këtë rast ndryshon përmbajtja e objektit dhe ruhet forma e mëparshme. Për raste të domosdoshme, kur nuk ka zgjidhje tjetër, edhe kjo mund të pranohet, vazhdoi ai, por nuk duhet kthyer në vijë. Duke u nisur nga koncepte formaliste ose duke mos i kushtuar rëndësi originalitetit, karakterit kombëtar të arkitekturës janë bërë ndërtime pa kriter, bile edhe ndërtime të rëndësishme, që jo vetëm thejnë stilin dhe ngjyrat e qytetit-muze, por edhe që janë kompozuar sipas koncepteve e shijeve të huaja për ne. Nuk është i kritikueshëm vetëm huazimi nga arkitektura borgjezo-revizio-

oniste, por edhe vulgarizimet, që i bëhen arkitekturës popullore.

Ka raste, që për nevoja utilitare, shtëpia ekzistuese, përdhese ose dykatëshe zgjatet e zgjatet si ndonjë rryp. Këto shfaqje jo vetëm nuk përputhen me stilin e qytetit, ku ndërtime kanë zhvillim vertikal, por e banalizojnë atë. Kështu, përmbi Urën e Nanzës po shtrin krahët një banesë rryp i gjatë. E njëjta gjë vihet re edhe në Hazmuratin e bukur, përmbi shkollën pedagogjike.

Po ka edhe raste më të rënda, kur është ndërtuar edhe një lagje e tërë, siç është Granica. Ajo nuk ruan arkitekturën e qytetit-muze. Përkundrazi, stonon me të si në vendosjen e godinave ashtu edhe në ngjyrë e në dritare. Në të, jashtë rregullave të qytetit-muze janë përdorur tje-gullat, që nuk janë karakteristike për qytetin dhe nuk janë as material rrethanor.

Një rëndësi të madhe për të ruajtur dhe zhvilluar karakterin kombëtar të arkitekturës, tha në bisedë inxhinieri **Niko Panajoti** ka edhe ndërtimi sa më funksional, sa më original shqiptar e sa më ekonomik i banesës-tip. Koha kërkon që tipet jo vetëm të jenë sa më të studjuara e të shprehin veçoritë kombëtare, por edhe të jenë të ndryshme, sikurse duhet të kënaqin nga çdo pikëpamje kërkesat e njeriut në kushtet e socializmit. Natyrisht, në arkitekturën tonë nuk kërkohet shtëpi e tip, por kërkohet që tipet të përshtaten me leverdinë ekonomike, ambientin, klimën etj. Por mishërimi i karakterit kombëtar në projektimin e tipave nuk duhet reduktuar në futjen në të disa detajeve apo ornamenteve. Edhe këto kanë rëndësinë e tyre,

sidomos kur janë të shumta e të larmishme, siç janë ato të shtëpisë gjirokastrite, tha **Koço Beruka**. Kryesore është krijimi i veprave arkitektuale karakteristike shqiptare, që e mishërojnë karakterin kombëtar në tërësinë e tyre, në harmoninë e përgjithshme, në kompozim e anën funksionale. I themi edhe këto se me gjithë rezultatet pozitive të aitura ka raste që karakteri kombëtar i arkitekturës është parë në anën e jashtme e jo në funksionin e saj.

Për çështjen e tipit në arkitekturë ka patur edhe mendime të gabuara, se gjoja ai nuk duhet përdorur, pasi na sillka monotonin. Dhe kjo bëhej jo për larminë e arkitekturës, (këtë nuk e përjashton përdorimi i tipit), por për t'i hapur rrugë eksperimenteve pa kriter të ndonjërit si dhe ndikimeve të huaja. Sigurisht, do të ketë tipe të përgjithshme, që mund të zbatohen në shumë qytete e fshatra të vendit; mund të ketë të përshtatshme vetëm për disa qytete me reliev, klimë e kushte të tjera të përafërta, por mund e duhet të ketë edhe për qytete të veçanta. Ndër to, e vështirë është krijimi i tipit për qytete-muze. Po edhe për këto kërkime janë bërë pak. Megjithatë, janë arritur disa rezultate, mbase jo aq në kompozicionin e përgjithshëm, por më tepër në anë të veçanta të tij. Kemi gjithmonë parasysh ndërtimin e tipit, që duke u mbështetur jo vetëm tek tradita e mëparshme, por edhe ajo e arkitekturës së re të realizimit socialist, të krijohet banesa për kërkesat e shijet e njeriut të sotëm, e njëherësh, të mos thejë arkitekturën e përgjithshme të qytetit. Në Gjirokastër nga ndërtimet e reja në periferi, që harmonizohen me arkitekturën e qytetit, tha inxhinieri **Spiro Sotiri**, janë ato të lagjes «Punëtorë». Kjo duket në trajtimin e dritareve dhe në zhvillimin vertikal. Edhe këto ndërtesa kanë të meta, por janë më afër shtëpisë karakteristike.

Në këtë drejtim vazhdojnë kërkimet, të cilat në të ardhshmen, siç u shprehën në bisedë arkitektët dhe inxhinierët e qytetit, do të jenë të shumta. Tani për tani, nga arkitektët, janë projektuar tri banesa që do të bëhen në formë eksperimentale. Në to janë ruajtur normativat shtetërore në m2, duke patur parasysh edhe anën ekonomike. Gjithashtu, është patur parasysh, në projektimin e tyre, relievi dhe disa veçori të banesës gjirokastrite si hyrja etj. Para së të miratohen si tipe ato do të kalojnë nëpërmjet diskutimit popullor.

Pra, siç shihet, edhe nga mendimet që u dhanë në bisedë, qytetet-muze janë me të vërtetë thesare të arkitekturës popullore, të cilat duhen njohur thellë e shfrytëzuar sa më shumë, veçanërisht në kushtet e sotme të thellimit të revolucionit tonë, në kushtet e rrethimit imperialisto-revizionist, kur imperialistët e revizionistët mundohen të ndikojnë në jetën, kulturën dhe shijet tonë me forma nga më të ndryshmet, ndër të cilat hyn edhe arkitektura. Dhe mbështetja në përvojën e pasur të traditës së arkitekturës popullore dhe atë të realizimit socialist jo vetëm që është taban i shëndoshë mbi të cilin arkitektura jonë do të zhvillohet më tej, por në të do të gjendet edhe larmia e ndërtimeve, duke luftuar uniformitetin dhe shabllonizmin.

BASHKIM KUÇUKU

Mbledhje me rastin

e 40-vje orit të

botimit të revistës

«Bota e Re»

Me rastin e 40-vjetorit të botimit të revistës «Bota e Re», Bashkimi i Gazetarëve të Shqipërisë organizoi këto ditë një konferencë në sallën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë.

Merrnin pjesë punonjës të organeve të ndryshme të shtypit, ATSH-së, Radio-Televizionit, ish-bashkëpunëtorë të revistës «Bota e Re», shkrimtarë e punonjës të tjerë të kulturës, artit e shkencës.

Mbi rolin që luajti kjo revistë në kohën që u botua dhe për pikëpamjet politiko - shoqërore që ajo mbronte, foli shkrimtari Sterjo Spasse.

(ATSH)

Për thellimin

e punës kulturore

në zonat malore

Në kuadrin e 35-vjetorit të themelimit të Partisë, në Gjirokastër u organizua këto ditë një seminar dyditor për thellimin e punës kulturore në zonat malore. Të pranishmit dëgjuan temën «Të ngrejme në një shkallë më të lartë punën kulturore-artistike në rreth» dhe ndoqën aktivitete kulturore-artistike si takimin me veteranë në fshatin Sopik, mbrëmjen e argëtimit të kulturuar dhe shfaqjen e pjesës teatrale «Shërbimi urgjent» në Skore, konkursin e librit bujqësor me kooperativistë e nxënës të shkollës së mesme bujqësore të Nivanit etj.

Rreth aktiviteteve të zhvilluara u organizuan mjaft diskutime dhe u përcaktuan detyra konkrete për të ardhshmen.

(ATSH)

Lajmërim

Lajmërohen të gjithë të interesuarit se konkursi për pranimin në Institutin e Lartë të Arteve për vitin mësimor 1976 - 1977 për të gjithë profilet, do të zhvillohet pranë këtij Instituti nga data 1 deri 6 korrik 1976.

Për t'u njohur me kriteret e pranimit dhe për sqarime më të hollësishme drejtohuni pranë Komitetit Ekzekutiv të rrethit, seksioni i arsimit dhe i kulturës.

DREJTORIA E INSTITUTIT TË LARTE TE ARTEVE



Brendi shtëpie gjirokastrite.

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Skulptura monumentale dhe lidhja e saj me arkitekturën

Perikli Çuli

Edhe vendi ynë ka trashëguar nga faza të ndryshme të zhvillimit lidhjen e skulpturës me arkitekturën, por veçanërisht në vitet e pushtetit popullor, kjo u pasurua me një hov më të madh.

Vetëm pas vendosjes së pushtetit popullor mund të flasim për një zhvillim të vërtetë, harmonik të artit, në të gjithë llojet e gjinitë e tij. Partia i dha një rëndësi të veçantë skulpturës monumentale, duke parë forcën e madhe shprehëse, përjetësuese e përgjithësuese të saj, rolin e madh që luan ajo për edukimin e njerëzve me ndjenjat e dashurisë për vendin, historinë e lavdishme të popullit, në ndjenjën e heroizmit, trimërisë etj.

Ndonëse në fillimet e saj, ajo hodhi shtat dhe u kristalizua nëpërmjet zgjidhjeve e realizimeve të thjeshta të disa përkujtimeve e busteve, të cilat u punuan me frymëzim, shumë shpejt u rrit në një nivel të tillë që sot njihet. Në këto vepra shprehen qartë tiparet e larta të metodës së realizimit socialist, duke i bërë jehonë veprës së Partisë.

Tani, kur janë realizuar kaq shumë vepra, që qëndrojnë me dinjitet nëpër të gjithë vendin tonë, në sheshet kryesore të qyteteve, varrezat e dëshmorëve, parqet e fasadat e ndërtesave administrative e socialkulturore është e domosdoshme të ndalemi në disa probleme që ka skulp-

tura monumentale në lidhje me arkitekturën e urbanistikën. Që vepra të kësaj natyre të ndjekin një proces më me përgjegjësi në zgjidhjet dhe realizimet e ardhshme, studimi sa më i mirë i projekteve skulpturale në lidhje me arkitekturën e qytetit, sheshet kryesore, objekteve ku vendosen, kërkojnë, në të ardhshmen, një bashkëpunim më të ngushtë arkitekt-skulptor-urbanist.

Dihet se çdo njeri, kur bie në kontakt me një qytet, krijon perceptimet e para estetike nga karakteristikat e veçanta që ka ai qytet. Në kontaktin e parë, me vepra të skulpturës monumentale, vërehet menjëherë se si qëndrojnë ato, çfarë emocionesh krijojnë. Krahas realizimit të bukur të një monumenti të veçantë artistik, kërkohej edhe lidhja e tij sa më e bukur me ambientin, në ç'vend është vendosur, ç'proporcione ka, në ç'material është, si i bie drita, si qëndron në raport me ndërtesat, rrugët etj. Të gjitha këto forcojnë përmbajtjen e veprës që ajo të ndikojë më shumë në edukimin e masave të gjera.

Kështu, monumentet e Skënderbeut në Krujë e në Tiranë, monumenti i Pavarësisë në Vlorë, monumenti i Partizanit në Përmet, Heroinat e Mirditës në Rrëshen, ndonjë nga monumentet e vendosura nëpër varrezat e dëshmorëve e shumë buste, janë ndër realizimet më të mira të skulpturës sonë monumentale, jo vetëm për

realizimin e mirë skulptural, për vlerat ideoartistike, por edhe sepse në vendosjen e tyre janë bërë përpjekje për të patur një lidhje sa më të natyrshme në arkitekturën e urbanistikën, me sheshet, rrugët e ndërtimeve përreth tyre. Në të shumtat e rasteve është studjuar përshatja që duhet të ketë vepra në raport me qytetin. Monumenti i Skënderbeut në Krujë, i vendosur në qendër të qytetit, me malet në sfond, është menduar e zgjidhur në unitet të plotë me terrenin dhe ndërtimeve të tjera të qytetit. Vendi ku është vendosur ai, ia shton bukurinë këtij qyteti, duke i dhënë edhe karakteristikat të veçanta e të papërsëritshme. Po kështu, vendosja e monumentit të Skënderbeut në Tiranë në qendër të sheshit, me dy arteret e rrugëve që i vijnë anash, drejt bulevardit qendror, krijojnë një unitet të bukur e të veçantë.


Një vendosje të kujdesshme ka edhe monumenti i Pavarësisë në Vlorë. Raporti i sheshit me skulpturën, i zgjidhur mirë, bëjnë që qendra e qytetit të tërheqë vëmendjen në mënyrë të veçantë. Vendosje të përshatshme ka gjetur edhe monumenti i 4 Heroinave të Mirditës (Rrëshen), i cili u realizua në bashkëpunim të skulptorëve me arkitektët, në bazë të disa studimeve, të cilat gjetën një zgjidhje të përshatshme për këtë qytet. Sheshi i vendosur në dy plane, në një te-

ren të bukur, ia rritin vlerat monumentale veprës dhe krijojnë karakteristikat të veçanta për qytetin mirditor.

Përmendëm disa nga veprat që zënë vend të rëndësishëm në qytet e qendrat tona të banuara dhe luajnë rol me rëndësi në edukimin e masave. Kuptohet se ato e kryejnë plotësisht këtë mision vetëm atëherë kur i nënshtrohen kërkesave që prekëm më lart, ndryshe ato krijojnë të kundërtën, kthehen në disarmoni me qytetin. Mirëpo në disa prej veprave nuk e gjejmë këtë lidhje të domosdoshme me hapësirën e destinacionin, se vendosja e tyre i është nënshtroar spontaneitetit. Ka skulptura, që ndonëse duken të realizuara bukur në ekspozitë, kur dalin në hapësirë nuk lidhen organikisht me raportet e proporcionet e hapësirës. Lidhja e veprës skulpturale me destinacionin e saj është një nga problemet më të rëndësishme, mbasi jo gjithmonë një skulpturë e bukur e ekspozitës mund të qëndrojë po aq mirë edhe në natyrë. Po përmendim grupin skulptural «Heronjtë e Vigut». Megjithëse ajo u realizua në një nivel të mirë ideoartistik, nga mungesa e konsultimit për vendin ku do të vendosej, nuk u veprua në atë mënyrë që vepra të mund të qëndronte harmonikisht e bukur në qytetin e Shkodrës. Edhe bazamenti ku është vendosur, lartësia, materiali e ngjyra nuk janë të gjetura në mënyrë të përshatshme. Përmasat e monumenteve që vendosen brenda qyteteve tona duhet t'i kërkojmë në unitet me zhvillimin e qytetit dhe lartësitë maksimale të ndërtimeve të tij, mbasi vlerat e një skulpture monumentale rriten edhe nga një zgjidhje e përshatshme, duke marrë në konsideratë vetë karakteristikat e veçanta të qytetit ku vendoset.

Qytetet tona përgjithësisht janë ndërtaur në vende të ulta ose mbi

(vijon në f. 11)



Monumenti i Pavarësisë vendosur në «Sheshin e Flamurit» në Vlorë.

Nga

Ekspozita

e arteve

figurative

25-ojet

FLA



N. Progri: Në malësi (vaj)

Diskutim krijues për Muzeun

kombëtar të Skënderbeut

Komisioni i arkitekturës pranë Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve organizoi ditën e mërkurë, në klubin e Lidhjes, një diskutim krijues mbi projektin për Muzeun kombëtar të Skënderbeut, që do të ndërtohet në Krujë, variante të arkitektëve Haxhi Subashi dhe Robert Kote.

Në këtë mbledhje merrnin pjesë arkitektë, inxhinierë, punëtorë, piktorë dhe skulptorë si dhe të ftuar të tjerë. Merrte pjesë edhe nënkryetari i Komitetit Ekzekutiv

të k.p. të rrethit të Krujës Nuhë Kërçhalii.

Mbi variantet e paraqitura dhe probleme të përmbajtjes dhe karakterit të këtij muzeu, të vendit ku duhet ndërtohet, monumentalitetit dhe vlerave unike që duhet të ketë ky institucion si dhe të shumë problemeve të tjera që lidhen me karakterin kombëtar diskutuan shokët F. Stamo, F. Shkupë, E. Faja, M. Dhrami, M. Berisha, V. Pistoli, A. Lufi, F. Daja, M. Mitroqorgji, O. Paskali, B. Daja dhe A. Kondo e K. Buza.

Takim me talente të reja

Fara disa ditësh Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve në bashkëpunim me Komitetin e Rinisë së rrethit të Tiranës, organizoi një takim me piktorë, skulptorë dhe grafistë, talente të rinj, për të diskutuar dhe rrahur mendime lidhur me disa probleme që dalin në fushën e krijimtarisë së tyre, për aktivizimin dhe gjallërimin e mëtejshëm.

Në këtë mbledhje doli që Komisioni i talenteve të reja duhet të funksionojë më mirë, të nxisë dhe inkurajojë më shumë ata, duke përdorur format e ndihmës dhe të patronazhit, të diskutimit që në projektidet të veprave të shtohet ndihma e krijuesve më me eksperiencë dhe të organizohet më mirë puna në drejtim të njohjes së jetës.

Në diskutimet e tyre artistët e rinj ngritën një radhë problemesh që kanë të bëjnë edhe me

gjallërimin e diskutimeve krijuese, aktivizimin e forcave amatore që vijjnë nga klasa punëtorë dhe të pionierëve në shkollat e tyre. Më shumë duhet drejtuar vëmendja edhe ndaj artistëve amatorë të fshatit. U vlerësua puna e bërë nga talentet e reja për ekspozitat e deritanishme, por njëkohësisht u fol për punën që duhet bërë veçanërisht, tani në vitin jubilar të 35-vjetorit të themelimit të Partisë për ekspozitën kombëtare të arteve figurative që do të hapet me këtë rast dhe të ekspozitës me temë nga fshati që do të organizohet në muajin korrik nga Komiteti Qendror i BRPSH.

Në fund folën edhe shokët Kujtim Buza, sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Mumtaz Dhrami, kryetar i Komisionit të talenteve të reja.

Korresp. i «Dritës»

Skulptura monumentale dhe lidhja e saj me arkitekturën

(vijon nga f. 7)

kodra të vogla e rrafshnalta mallee, me ndërtesa e sheshe jo shumë të mëdhenj, ku nuk qëndrojnë përmasa shumë të mëdha skulpturale, duke përjashtuar shehin kryesor në Tiranë, që edhe aty do të ishte vështirë të vendosej një skulpturë më e madhe se ajo e heroit kombëtar.

Po i kësaj rëndësie është edhe problemi i skulpturës monumentale dekorative, të vendosur nëpër ndërtesat administrative e socialkulturore. Prej saj ne trashëgojmë edhe ndonjë punim të vendosur qysh para Çlirimit, por vitet e fundit po bëhen hapa serioze për zhvillimin e saj. Kjo gjini e skulpturës monumentale është e lidhur më direkt me kërkesat e arkitekturës dhe qëndron në vartësi të plotë nga ajo, prandaj bashkëpunimi i arkitektëve me skulptorët në këtë rast është më i domosdoshëm. Nga një zgjidhje pa përgjegjësi, p.sh. relievi i shkollës së mesme «Qemal Stafa» në Tiranë, nuk ka gjetur vend të përshatshëm për t'u vendosur. Qytetet tona janë vazhdimisht në sistemime dhe ndryshime të vazhdueshme, prandaj është e domosdoshme të theksojmë që arkitektët e urbanistët duhet të krijojnë mundësinë e evidencimit të vendeve ku të vendosen skulptura monumentale, duke marrë parasysh perspektivën e rritjes dhe të zhvillimit të qyteteve. Ndodh që nga ndryshimet, sistemimet dhe rrugët e reja që hapen, ndryshon edhe raporti i skulpturave ekzistuese me ambie-

ntin e ri që krijohet. Kështu, krahas sistemimit e ndryshimeve në urbanistikë, duhet të bëhen ndryshime edhe në skulpturë. P.sh. në bulevardin e hapur në drejtim të sheshit ku është sot busti i Avni Rustemit, vendi ku është vendosur kjo skulpturë, me sistemin e ri që është bërë, kërkon një vepër skulpturale të dimensioneve mbinatyrallë. Ky problem del tani jo vetëm në qytetin e Tiranës, po edhe për qytete të tjera ku ka skulptura e bëhen sistemime të reja. Në Tepelenë p.sh. vendosja e tri busteve njëri pranë tjetrit, në qendër të qytetit, nuk është zgjidhur drejt estetikisht. Nuk është ruajtur raporti i duhur i skulpturës me arkitekturën. Duke ditur se qytetet tona janë në procesin e sistemit të disa qendrave, është e një rëndësie të dorës së parë çështja e projekttimeve e sistemeve të tyre, lidhur me përshatjen që duhet të marrë vepra e artit, duke njohur rolin dhe rëndësinë e madhe që ka ajo. Keto vepra të arteve figurative, kur lidhen me ndërtesat, luajnë një rol me rëndësi edhe për forcimin e karakterit kombëtar të arkitekturës.

Nga një bashkëpunim më i ngushtë midis arkitektëve dhe skulptorëve, pas studimit të thelluar e shkencor të traditës sonë, veprat e skulpturës do të lidhen më mirë me arkitekturën e do të bëjnë që qytetet tona të kenë karakteristika e vlera të veçanta edhe nga ana e urbanistikës.

PERIKLI ÇULI

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Elemente të traditës në arkitekturën tonë

Fizionominë kombëtare në arkitekturë duhet ta shohim edhe në elementët e traditës të shprehur në forma të reja. Domosdo kjo duhet të bëhet në përshatje me kërkesat dhe detyrat që ka arkitektura jonë sot e në perspektivë, në kushtet e ndërtimit të shoqërisë socialiste dhe në përputhje me parullën e Partisë, të ndërtojmë shpejt, mirë dhe lirë.

Rrugët për vazhdimësinë e forcimin e fizionomisë kombëtare në arkitekturë mund të jenë të ndryshme, por arrihen me një perspektivë të qartë të zhvillimit të mëtejshëm të traditës.

Mendoj se një ndër rrugët e mundshme është edhe përdorimi i elementëve dekorativë popullorë arkitekturale në arkitekturën e brendshme dhe të jashtme të ndërtimeve tona. Por këto nuk duhet të mbivlerësohen. Dihet nga historia e arkitekturës që nuk janë elementët dekorativë ato që përcaktojnë stilin arkitektonik të një periudhe. Janë një sërë veçorish më të rëndësishme si p.sh. zgjidhjet funksionale, trajtimi i formave dhe i vëllimeve, sistemi konstruksioneve, kompozimi i ansambleve, mënyra e përdorimit të materialeve etj. që luajnë një rol më me rëndësi. Arkitektura e ndërtesave të banimit, të rrashëguara nga e kaluara, është e bukur për zgjidhjet funksionale për krijimin e vëllimeve të bukura të ansambleve urbanistike etj. Por, megjithatë, elementët dekorativë si gdhendja në gurë, kornizat e penxhereve e të çatave, përpunimi i metalit, raftet në mur, parapetetë e shkallëve, ndarja e mureve etj. përbëjnë elemente me rëndësi të kësaj arkitekture nga të cilët ajo merr fizionominë karakteristike kombëtare. Por përdorimi i elementëve dekorativë duhet bërë në mënyrë të studjuar në sasinë, masën dhe vendin e duhur, që ato të mos kthehen si qëllim në vetvete. Elementët dekorativë popullorë në arkitekturën tonë duhet të përdoren

atje ku ato e kryejnë një funksion të caktuar, atje ku ato më tepër gjallërojnë dhe rrisin vlerat artistike të ndërtesave. Këta elementë dekorativë duhet t'i zhvillojmë më tej, t'i stilizojmë në frymën e traditës me vërtetësi artistike, t'i industrializojmë, që të bëhen masive dhe ekonomike. Këta mund të jenë p.sh. parapetetë e lloxhave dhe të ballkoneve, brisolej prej betonarmeje që të përdoren në ndërtesa të veçanta shoqërore, brisolej prej qeramike që përdoren në shkallët dhe në dhomat e tharjeve në ndërtesa banimit etj.

Jam i mendimit se, në këtë fushë, mundësitë e krijimit të një arkitekture me fizionomi kombëtare, të mbështetur në elementët dekorativë popullorë, janë të mëdha, si në ndërtesat e banimit, ashtu dhe në ndërtesat e ndryshme shoqërore.

Elementët funksionalë dhe dekorativë për ambientet e brendshëm të ndërtesave popullorë janë dhe raftet në mure. Këto elementë janë shumë ekonomike, se jo vetëm kursehen sipërfaqe të ambienteve, por kursehet dhe lënda e drurit për mobiljet. Përveç kësaj, përdorimi i tyre krijon pastërti në mobilimin e ambienteve. Këto elementë tradicionalë, të arkitekturës sonë, duhet t'i fusim më shumë në apartamentet tona. Për raftet në mure është folur shumë dhe më parë. Janë projektuar dhe apartamente me vend për raftet në mur, por ato nuk janë zbatuar. Arsyeja është e thjeshtë. Ndërmarrja e ndërtimit nuk e zbaton, por kështu edhe ndërmarrjet e përpunimit të drurit dhe të prodhimit të mobiljeve, këtë lloj mobilimi me sa duket nuk duan ta njohin. Zgjidhja e drejtë e këtij problemi kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërmjet ndërmarrjeve projektuese, zbatuese dhe të punimit të drurit.

Brendivë të ndërtesave shoqërore si të hoteleve dhe institucioneve kulturore mund t'i jepet një ton

Enver Faja - arkitekt

më kombëtar në qoftë se në to, në mënyrë krijuese, do të përdoren edhe mobilje, parapete, dysheme dhe tavane dekorativë, të punuara në frymën e artit popullor. Në këtë fushë janë bërë përpjekje pozitive. Kështu janë realizuar mirë qoshja e pritjes në hotelin e Gjirokastrës, ndarjet me mure dekorative në shtëpinë e pushimit të punëtorëve në Korçë, dysheme me mozaik në ndërtesa të ndryshme shoqërore etj.

Fizionomia kombëtare e arkitekturës sonë duhet të forcohet më tepër edhe në ndërtimet e reja që po bëhen në fshatin tonë socialist. Vendimi i fundit i KQ të PPSH dhe i Këshillit të Ministrave, mbi ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve midis fshatit dhe qytetit, hap njëkohësisht për arkitektët, inxhinierët dhe punonjësit e ndërtimit, perspektiva të mëdha për një punë më të thellë krijuese në fushën e urbanistikës dhe të arkitekturës së fshatit tonë.

Arkitektura e fshatit duhet të mbështetet më fort në elementë të traditës sonë popullorë, pse, e para, ajo krijohet atje ku arkitektura jonë kombëtare ka burimin e saj dhe e dyta, krijohet në rrethana ku mundësitë e përdorimit të elementëve karakteristike, rrethano-re, tradicionale, janë më të mëdha.


Forcimi i karakterit kombëtar në arkitekturë nuk është vetëm detyrë e arkitektëve, por e tërë punonjësve dhe e mjeshtrëve të ndërtimit, e punonjësve dhe e mjeshtrëve të përpunimit të drurit, të qeramikes e të beton armësë, të punonjësve të arteve të aplikuar. Për këtë duhet të mobilizohen me një frymë të lartë përgjegjësie të gjithë ndërmarrjet dhe institucionet, puna krijuese dhe prodhimet e të cilave lidhen me projektimin dhe ndërtimin e veprave të ndryshme arkitektonike të vendit tonë.

Shoku Enver, në plenumin IV të KQ të PPSH, ka theksuar se Partia ka qenë dhe është për një


art novator, që të mbështetet fort në traditën e shëndoshë të vjetër e të re dhe në partishmërinë proletare. Arkitektët, inxhinierët dhe punonjësit e ndërtimit gjatë viteve të pushtetit popullor, duke u udhëhequr nga Partia dhe mësimet e shokut Enver i kanë dhënë popullit shumë vepra, të cilat kanë formuar urbanistikën dhe arkitekturën tonë të re kombëtare dhe socialiste. Në këtë urbanistikë dhe arkitekturë, në këtë përvojë shumëvjeçare ne duhet të mbështetem më shumë tani dhe në të ardhshmen.

Në fushën e urbanistikës, ndërtimit, blloqeve dhe i komplekseve të banimit me ndërtesa të shtrira dhe të gjata, mendoj se është një përvojë pozitive. Shtrirja në gjatësi e ndërtesave të banimit, dmth përdorimi i godinave me 4-6 sekione jep jo vetëm mundësi të një planifikimi më të mirë dhe të bukur urbanistik të njësive strukturore të qyteteve, (blloqeve, komplekseve dhe lagjeve të banimit) por jep njëkohësisht, në këto pjesë, zgjidhje më ekonomike, sepse kursehet tokë, sipërfaqe rrugësh, rrjete kanalizimesh dhe furnizimi me ujë etj. Ndërtesat e shtrira dhe të gjata janë dhe më funksionale e komode. Nëpërmjet tyre sigurohet një lidhje më e mirë e apartamenteve me gjelbërimin, me ambientin e jashtëm, me hapësirat e lojrave për fëmijë etj. Për këtë arsye, kjo traditë e re, duhet çuar më tej, duhet pasuruar dhe nuk duhet të largohemi prej saj nga frika se do të biem në monoton. Vlerat kompozicionale urbanistike të lagjes «50-vjetori i Pavarësisë» në Tiranë, krijuar me godina të gjata pesë seksionesh, janë shumë më të mëdha, se sa ato të disa blloqeve dhe komplekseve të banimit, që janë të mbushura me ndërtesa me një dhe dy sekione ndërtuar në disa lagje e qytete të tjera. Po kështu kemi një traditë të mirë në krijimin e ansambleve urbanistike në qytete kodrinore dhe malore, në studimin e seksioneve-tip të banesës qytetare etj., ku është shfrytëzuar mirë terreni. Edhe për njohjen e traditës sonë të re në urbanistikë dhe arkitekturë duhen bërë studime dhe analiza të ndryshme shkencore.

Prandaj vënia në jetë e porositve të Partisë, për një arkitekturë me fizionomi kombëtare, shtron përpara arkitektëve dhe punonjësve të tjerë që merren me problemet e urbanistikës e arkitekturës, detyrën e njohjes së arkitekturës sonë popullorë po ashtu dhe të traditës së re të arkitekturës së ditëve tona.



Ndërtesa me shumë sekione.



Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Dekoracionet popullore në arkitekturën e re

Fatbardha Shkupi, piktor

Kur flasim për dekoracionet popullore të traditës në arkitekturë nuk mendojmë t'i përdorim ato në mënyrë shablone, vend e pa vend. Nuk mendojmë të aplikojmë çardaqet, saranxhat, harqet e pusët në urbanistikën tonë, por elementë të veçantë, tipike të kësaj natyre, me të cilat, duke i bërë një trajtim të ri, të zbukurujmë fasadat e brenditë lidhur organikisht me destinacionin e ndërtesës. Ky problem ka një rëndësi të veçantë dhe kërkon interesim serioz të gjithë arkitektëve e krijuesve të tjerë që merren me këtë fushë, mbasi edhe këto luajnë rol me rëndësi në forcimin e karakterit kombëtar të arkitekturës.

Merita e arkitektëve dhe e artistëve qëndron në zgjedhjen e mjeteve të shprehjes, dekoracioneve të përshtatshme me anë të cilave të pasqyrohet qartë përmbajtja e ndërtimeve. Ndër këto mjete janë dhe atributet e profesioneve, të realizuara mbi pllaka monumentale në relief të lartë e të ulët, mbi fasada apo afreskë e mozaikë në brendi. Marrim si shembull kombinatin e tekstileve në Berat. Mbi fasadën kryesore të këtij ansambli mund të krijojmë grupe tekstilistësh me endjet e tyre më tipike, të stolisura me motive popullore, ndërsa nëpër repartet të pikturohen simbole pune e prodhimit në bazë afresku ose mozaiku. Kështu mund të bëjmë për çdo rast, duke ia përshtatur specifikës së godinës atributin apo dekoracionin.

Atributet simbol, nga tradita jonë, ndeshim si në artin e afreskut mesjetar ashtu edhe nëpër mozaikët antikë të vendit, të cilat lidhen me ngjarjet e epokave përkatëse. Këto duhen njohur e shfrytëzuar më shumë në ndërtimet tona të reja. Godina ku mund të përdoren më tepër elementë dekorativë janë edhe hotellet e ndërtesat e tjera social-kulturale.

Përveç ndonjë godine tjetër, shembulli pozitiv, ku janë përdorur këto elementë është dhe shtëpia e pushimit të punëtorëve në Korçë, për të cilën u shkrua në këtë rubrikë. Atje është krijuar një ambient i këndshëm kombëtar, duke u mbështetur në dekoracionet e arkitekturës popullore. Por në disa godina të tjera, ku ka shumë vend për elemente të tilla, ato nuk gjejnë përdorim të gjerë, përkundrazi, kanë zëvendësuar me formë të tjera që jo vetëm janë më pak të bukura, por nuk krijojnë një ambient kombëtar. Në hotel turizmi «Rozafa» të Shkodrës p.sh., mund të përdorëshin, në mënyrë të veçantë, elementë të arkitekturës së pasur të asaj krahine. Holli qëndror i katit të parë e të dytë, ku është krijuar bukur një hapësirë e nevojshme, mund të plotësohet e të merrte një fytyrë më të qartë kombëtare në se aty do të përdorëshin elementë të arkitekturës popullore. Parmakët e shkallëve dhe të ballkonit të hollit të katit të dytë, që duket në hollin qëndror, fare mirë mund të ishin me kangjella sipas

motiveve kombëtare, në vend të atij betoni të rëndë që ekziston tani. Këtu ka mjaft vend edhe për elementë të tjerë dekorativë apo për mozaikë në dyshe me e piktura murale. Po këshlu mund të aplikoheshin dekoracione edhe në ambientet e tjera të hotelit, ku mund të krijohej edhe një dhomë karakteristike popullore.

Për realizimin me sukses të dekoracioneve popullore, përveç njohjes së mirë të tyre, rëndësi të madhe ka edhe kontakti e shkëmbimi i mendimeve me mjeshtrat popullore. Në krahina të ndryshme të vendit ka mjeshtra që punojnë drurin, gurin apo metalin në mënyrën e tyre të veçantë me frymë kombëtare. Prej këtyre duhet të mësojmë më shumë.

Në dukje krijohet përshtypja sikur përdorimi i dekoracioneve të arkitekturës popullore në arkitekturën e re është në kundërshtim me ritmin e ndërtimeve. Por nuk është kështu. E para, kur flasim për dekoracionet nuk mendojmë që këto t'i aplikojmë në çdo pallat banimi, mbasi kjo nuk është edhe ekonomike, këtu e kemi fjalën për ndërtesa të veçanta social-kulturale dhe, e dyta, këto dekoracione nuk mendojmë që edhe tani t'i prodhojmë në mënyrë artizanale. Kombinatit «Josif Pashko» në Tiranë dhe

kantiere të tjera të vendit tonë fare lehtë mund të krijojnë negative për prodhimin në seri të disa lloj dekoracionesh. Për të thyer monotoninë që mund të krijohej në këto raste duhet të veprojmë duke ndryshuar format e vendosjes, ngjyrën etj.

Dekoracionet popullore që përdoren edhe sot, duke i dhënë një pamje të re, mund t'i krijojmë edhe me drurin në mobiljet e objektet e tjera të ndryshme, me të cilat pajisen godinat tona. Kuptohet, nuk mendojmë t'i ngarkojmë ndërtesat me dekoracione të shumta, duke krijuar një ambient të rëndë, por t'ia përshtasim këto godinës së re.

Këto që përmendëm janë disa mendime të veçanta, por fusha e aplikimit të dekoracioneve popullore në arkitekturën tonë të re është shumë e gjerë. Këtu, përveç motiveve të traditës duhet të kemi parasysh të krijojmë edhe motive të tjera nga jeta dhe puna, që pasqyrojnë ditët tona, transformimet në të gjitha fushat e jetës. Pra, në punën tonë krijuese, përveç shfrytëzimit të traditës kombëtare po kaq rëndësi ka edhe krijimi i dekoracioneve me motive të ndërtimit socialist, që i japin një pamje të re traditës sonë në arkitekturë, duke e zhvilluar atë më tej.

Arkitektura dhe lidhja me artet e aplikuar

Agron Jano,

student në degën e arkitekturës, viti IV në Universitetin e Tiranës


Në përpjekjet për të krijuar vepra me fizionomi të qartë kombëtare ka rëndësi puna e arkitektëve për të studjuar dhe shkicuar ndërtimet tona më të mira të traditës.

Por më e rëndësishme është

që këto skica të mos mbeten vetëm në letër. Ato duhet të na pushtojnë jo vetëm syrin, por edhe mendjen, edhe zemrën, pasi në to gjejmë fare mirë frymëzimin e punës dhe të krijimit. Për këtë qëllim duhet të bëjmë në kontakt jo vetëm me veprat, por edhe me mjeshtrat e ndërtimit. Të zbulojmë në shpirtin krijues të tyre, në shpirtin prej artisti të popullit, ato vlera të reja artistike që i përshtaten realitetit dhe t'i pasqyrojmë gjerësisht në arkitekturën tonë. Kjo duhet të bëhet mbi një kriter të drejtë. Duhet të marrim ato elemente të traditës që i shkojnë përshatja jo vetëm kërkesave të jetës socialiste sot, por edhe kësaj ve të terrenit e klimës, edhe vetë traditës së qyteve e fshatrave të veçantë. Në qoftë se kompozimi i thyer e harmonizuar, me dritare të gjata vertikalisht do të rrinte për bukur në terren të pjerrët, në Berat e Gjirokastrë, s'mund ta themi këtë, fjala vjen për Tiranën apo Fierin, Shkodrën e Vlorën.

Arkitektët më me përvojë, në krijimet e tyre, ndihmojnë mjaft edhe krijuesit më të rinj në këtë drejtim. Për këtë duhet forcuar më shumë puna qysh në shkollë. Në lëndët që zhvillohen aty një vend të rëndësishëm zë kompozimi arkitektonik, por në të duhet të ketë më tepër vend jo vetëm arkitektura e jashtme, por edhe ajo e brendshme.

Interierëve pak i kushtohet vëmendje, prandaj programi për to (vijon në f. 12)



Dekoracione të punuara në dru.

Në agimin e ditës së 2 marsit 1942, në Tiranë, në oborrin e burgut të vjetër, po ngrihej një trekëmbësh. Do të varej komunisti Hamid Shijaku. Të burgosurit tërë natën nuk fjetën. Ata e dinin se shoku i tyre ishte dënuar me vdekje dhe ishin informuar se atë natë do të ngrihej trekëmbëshi.

Hesita që zotëronte nëpër kasinet (birucat) dhe korridoret e mbushura plot e përplot me të burgosur antifashistë, bënte që të dëgjohej zhurma e lëvizjeve të xhelatëve, që pregatisnin krimin.

Të burgosurit, pasi e panë, ndërmjet dritareve të burgut shokun pranë trekëmbëshit, të rrethuar nga dhetëra oficerë dhe ushtarë fashistë, hodhën sytë nga vendi i ekzekutimit.

Jehona e fjalëve të tij: «Vdekje fashizmit» u përzie me buci-tjen e fortë të burgut: «Liri Popullit!». «Hamid, hakun do të ta

Në burg u ngrit edhe një grup teatral që jepte shfaqje me përmbajtje revolucionare e program të caktuar për të gjithë të burgosurit politikë si p.sh. pjesën «Të burgosurit», në të cilën demaskohej terrori zogist kundër masave punonjëse në Shqipëri. Në këtë shfaqje në burg, përveç shokëve të tjerë, si aktor merite rrejt pjesë dhe dëshmorit Reshit Rusi. Aty jepeshin edhe skeçe të ndryshme që demaskonin fashizmin dhe tradhtarët e vendit. Po kështu u ngrit edhe biblioteka e përbashkët e të burgosurve, ku shumë të burgosur politikë kërkonin nga familjet e tyre libra dhe i dorëzonin në bibliotekën e burgut. Këtu, bashkë me komunikatat, hynin dhe libra me përmbajtje revolucionare si libri «Nëna» i Maksim Gorkit etj. Këto libra shpërndaheshin ndër të burgosurit politikë në fshetësinë më të madhe, duke kaluar dorë më

Të nesërmen, më 1 prill 1942, i nxjerrin të lidhur me zinxhira nga burguri i Brindizit dhe i futën në një vagon-burg të trenit për në Bari. Mbasditë i futën në burgun e këtij qyteti, që ishte një ndërtesë e mocme prej katër katësh, me mure të trasha, të nxira vende-vende. Për të hyrë brenda në burg duheshin kaluar disa porta hekur.

I kontrolluan në trup, u hoqën kopsat e rrobave, rripin e mesit, lidhësat e këpuçëve, u prenë flokët, u dhanë nga dy batanije, një tas dhe një lugë druri.

Vapori i vogël plot zinxhira dhe bajoneta lundronte drejt veriperëndimit të Palermos.

Nën diellin përvëlues, në një fushë të rrethuar me tela me gjëmba, çdo ditë, prej orës 11 deri në orën 14 mbasditë, bëheshin apellet e të internuarve. Koha e apelit për të internuarit ishte tepër e mërzhitshme dhe e lodhshme.

Që prej disa ditësh përpara, duke u organizuar në mënyrë tepër të fshehtë, u festua 1 Maji 1942 në çdo kolektiv, duke kënduar këngë revolucionare dhe duke shprehur solidaritetin ndërkombëtar proletar dhe antifashist.

Nën udhëheqjen e celulës së Partisë, arritën të nxjerrin komunikatën mbi luftën që zhvillohej nëpër botë, në frontin e Lindjes dhe në prapavijat e armikut.

Lajmet që vinin nëpërmjet këtyre komunikatave mbi zhvillimin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Shqipëri, i mbushnin zemrat me gëzim. Ato u jepnin kurajo për të forcuar rezistencën e tyre në këtë ishull të huaj dhe punohej të kuptonin se Partia po e udhëhiqte drejt dhe me sukses popullin tonë në luftën kundër pushtuesve dhe tradhtarëve të vendit.

Dikush nga këta, komunikatat i ruante në gjiri dhe me duart që i dridheshin nga emociioni, i lexonte dhe i rilexonte nga gëzimi e malli për Atdheun, shokët e familjet.

Një ditë u mbushën zemrat plot me mallëngjim dhe gëzim kur në një komunikatë lexuan se në Shqipërinë tonë të dashur cetat partizane po çlironin fshatra dhe qytete dhe se në Pezën heroike u formua Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, i udhëhequr nga Partia Komuniste Shqiptare.

Në ato caste, gëzimi i tyre ishte i papërkrahshëm. Përgjoheshin njëri me tjetrin. Mjaft shokë antifashistë të kombësive të tjera të internuar në Ustika, vinin e i përgëzonin për këto suksese të luftës së popullit tonë.

Në këtë ishull të shkretë, në gërxhet, zhrisitet, qelitë dhe barakat e tij të vetmuara, mbetën shumë shokë që vdiqën pa u ndjerrë, pa bujë, të varrosur pa ceremoni, por të panështruar dhe të vendosur deri në fund të jetës së tyre si antifashistë.

Ustika mbetet ishull i internimit, ku këngët e grupit të antifashistëve shqiptarë gjëmuan fort mes këngëve të tjera të luftës kundër Italisë fashiste dhe nazizmit gjerman.

(vijon nga f. 7)

mendoj se duhet të jetë më i zgjeruar. Ne duhet të mësojmë të kompozimë bukur edhe volumet e linjat, elementët dhe detajet e arkitekturës së brendshme, pasi në këto ambiente njeriu kalon një pjesë të madhe të kohës.

Shfrytëzimi i motiveve kombëtare me siguri do të na shërbejë për brendësinë arkitektonike të veprës, për të krijuar ambiente shqiptare, të pasura e të ngrohta, të kulturuar dhe moderne.

Na ka bërë përshtypje një veprë e re e arkitekturës sonë; shëpia e pushimit të punëtorëve në Korçë, ku veç arkitekturës së jashtme të kompozuar bukur, shohim një arkitekturë të brendshme të pasur; dhoma komode, intime dhe ekonomike, interiere të pasura me elementë dhe motive kombëtare në gurë, dru dhe hekur, të stilizuara dhe përshatura me mjeshtri dhe shije të lartë nga arkitekti dhe mjeshtrat. Nga kjo ndërtesë kemi ç'të mësojmë, veç të tjerash për frymën kombëtare dhe sintezën e arkitekturës me artet e aplikuar. Në këtë drejtim duhet të bëjnë akoma më shumë.

Në vendet borgjeze dhe revizioniste, piktura murale, mozaiku apo piktura e skulptura monumentale që lidhen me arkitekturën, ashtu si gjithë artet e tjera zhvillohen me tendencë të theksuara formaliste e dekadente. Kjo bën që ndërtesat atje krahas estravagancave që kanë vetë ato, duke u sintetizuar me vepra të tilla dekadente të marrin një formë të shëmtuar në kundërshtim me shijet e shëndosha.

Është një fitore e madhe që artet tona figurative në bazë të metodës së realizmit socialist, të vijës së Partisë sonë, zhvillohen në mënyrë diametralisht të kundërt me to.

Ne kemi vepra të denja nga piktorët dhe skulptorët tanë. A s'do të ishte mirë që këto vepra të zinin vend në fasadat e veprave tona arkitektonike, duke i fuqizuar dhe pasuruar ato me tipare të theksuara kombëtare?

Në këtë mënyrë vepra arkitektonike do të flasin më qartë me gjuhën e saj shqiptare.

Po kështu, mozaikët apo piktura monumentale, në faqe muri, mund të përdoren edhe në ambientet e brendshme. Sa do të pasuroheshin p.sh. hotelët e rinj, të ndërtaur tani, me vepra të tilla realiste, kombëtare, krahas pajisjeve utilitare dhe artistike! P.sh. një sallë lojrash të kish; fjalat vjen, të vizatuar në mur fragmente të lojrave popullore, si tek tabloja e piktorit Abdurrahim Buza me të njëjtin titull, ku njeriu ta ndjente veten në një hapësi më të gjerë dhe në botën e lojrave të popullit.

Kohët e fundit është gjallëruar mendimi teorik e kritika në këtë fushë, por fakti që të gjithë arkitektët janë hedhur në projektim dhe pak merrjen me studim, apo me teorinë e arkitekturës duhet të na preokupojë për të bërë më shumë në të ardhshmen në këtë drejtim. Mendimi teorik dhe kritika duhet të analizojnë jo vetëm veprat më të mira të traditës sonë të së kaluarës, por edhe ato të traditës së re të pasqirimit.

Po kështu, mendoj se problemet e arkitekturës dëhet të zënë një vend më të gjerë edhe në revistën «Ndërtuesi».

AGRON JANO

TRADITAT TONA

Forca e këngës dhe e fjalës artistike

Bedri Çoliku

marrim!» dhe, bashkë në një zë të vetëm, të fuqishëm e të kumbueshëm, kënduan «Internacionalen», nën tingujt e së cilës ra burrrërisht ai.

Burgu i Tiranës, qysh në fillim të Lëvizjes Antifashiste, u bë një shkollë, ku çdo njeri mësonte të urrente dhe të luftonte në çdo formë fashizmin dhe veglat e tij.

Me iniciativën dhe nën drejtimin e organizatës së Partisë, në burg, vepronin celulët e Partisë dhe aktivët e Rinisë Komuniste. Nëpërmjet këtyre organizatave zhvillohej një punë e gjerë politike, edukative me komunistët, me Rininë Komuniste, me grupet edukative dhe me patriotët. Komunistët u shpjegonin të burgosurve për vijën e Partisë dhe situatën e jashtme dhe të brendshme.

Nga ana tjetër, shokët e «Florës» sillnin përditë një karro me ushqime për kolektivin e burgut. Në burg organizohej edhe leximi i komunikatave, të cilat hynin ilegalisht aty. Këto komunikata lajmëronin popullin e kryeqytetit mbi sukseset e aksionet e njësitëve partizane dhe mbi aksionet e njësitëve guerile në qytet, të cilët, nën hundën e okupatorit fashist e tradhtarëve të vendit, bënin aksione të guximshme duke marrë armë e municione, duke kryer atentate kundër spionëve e tradhtarëve dhe aksione të tjera. Leximi i tyre bëhej në mënyrë kolektive.

dorë e duke i ruajtur nga agjentët e fashizmit.

Në burg të burgosurit politikë filluan të mësonin dhe këngë revolucionare, të cilat këndoheshin kolektivisht me zë të ulët që mos të dëgjohehin nga drejtorja e burgut, mbasi merreshin masa, si prerjen e ujit të pijshëm të burgosurve etj. Aty u kënduan këngët «Internacionalja», «Ne jemi pararoja» e këngë të tjera partizane.

Më datën 30 mars 1942 fashistët italianë nxorën nga burguri dhetë shokë e shoqe. I lidhën me zinxhirë njëri pas tjetrit. Ndërkohë, burgu gjëmonte nga këngët revolucionare të të burgosurve politikë.

Edhe jashtë, populli, sidomos gratë, thërrisnin, këndonin këngë revolucionare dhe hidhnin parulla antifashiste.

Nuk dinin se ku po i çonin. Në internim? Në Itali? Po në ç'vend vallë të Italisë?

Ata qëndronin kryelartë, sepse Partia Komuniste Shqiptare ishte themeluar dhe kishte nisur luftën për çlirimin e vendit.

Italianët, pasi u hoqën zinxhirët dhe i lidhën secilin në vete, i futën në vapor, që nuk vonoi dhe u nis për në det të hapur.

Kështu ata ia filluan këngës:

«Na jemi pararoja
Na jemi djemt e varfërisë
Të ngritur nga nevoja
Për të ardhmen e puntorisë»

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Ne jemi për ndërtime të bukura, të thjeshta e pak të kushtueshme

Problemi i karakterit kombëtar të arkitekturës na preokupon mjaft edhe në punëtorëve. Kam disa vjet që merrem me ndërtime dhe shoh se tani janë bërë përparime të mëdha. Është rritur shumë numri, cilësia dhe ritmi i ndërtimeve. Më kujtohet kur punoja në ndërtimin e kombinatit të tekstilëve «Stalin», në vitet e para të pasqirimit e, kur bëj krahasimin me ndërtimet e tanishme, shoh një ndryshim të madh. Por sot na preokupon problemi i ruajtjes e forcimit të mëtejshëm të traditës sonë, pa ulur këtë ritëm pune.

Ka mendime sikur harku, p.sh., është një element kombëtar dhe duhet të bëhet edhe sot. Mendoj se kjo varet nga koha dhe elementet rrethana. Para disa vitesh harku bëhej se ashtu ishte edhe teknologjia e ndërtimeve, por sot ka ndryshuar kjo gjë. Në kemi fabrika çimentoje e metalurgjinë tonë. Me beton armë nuk është nevoja të bëjmë harkë. Pra, nga tradita të marrim ato gjëra që i përshpirtat kushteve tona të ndërtimeve. Ne jemi për ndërtime të bukura, të thjeshta e pak të kushtueshme.

Një gjë e mirë në godinat e reja të banimit, që ndërtojmë tani, është zgjerimi i kubaturës së guzhinës. Kjo, mendoj, është një vazhdim i traditës. Edhe më parë populli ynë guzhinën e ka patur

më të madhe, se aty e kalonte pjesën më të gjatë të kohës. Këto guzhina që ndërtojmë tani janë pëlqyer mjaft nga masat. Dhe këtë gjë në duhet ta kemi gjithmonë parasysh. Në qoftë se na i pëlqejnë ndërtimet do të thotë se ato i përshpirtat kërkesave të njerëzve tanë.

Tani po shikohet më shumë edhe ana ekonomike. Edhe kjo është vazhdim i traditës. Në gjithmonë kemi ndërtuar me ekonomi. Në ndërtime të kemi parasysh që të mos e tepërojmë me gjëra të tepërta. Psh dihet që ne nga tradita kemi përdorimin e llozheve e ballkoneve. Në disa raste janë ndërtuar ballkone shumë të mëdha ose ballkon edhe llozhe në një apartament duke bërë harxhime ekonomike të panevojshme. Dhe kjo është bërë gjoja në emër të traditës, për t'u lidhur me ambientin, por është harruar tradita për të ndërtuar me ekonomi.

Ndërtimet tek ne, ashtu si çdo gjë tjetër, i takojnë gjithë popullit. Kjo është një gjë tjetër që na shtyn të bëjmë godinat të pëlqyeshme për të gjithë. Ndryshe ndodh në vendet borgjezo-revizioniste. Atje ato janë pronë e klasave shfrytëzuese, kështu që edhe forma e tyre është sipas tekave të arkitektëve, që kanë vënë në shërbim talentin dhe punën e tyre. Ato i bëjnë ndërtimet sipas

oreksit e dëshirave të borgjezëve, duke ndërtuar forma sa më es-travagante.

Godinat e reja që janë ndërtuar e po ndërtohen kohët e fundit tek ne, janë të bukura, të thjeshta dhe ekonomike. Kjo tregon

se po vihet më shumë në jetë pallula e Partisë sonë që të ndërtimë shpejt, mirë dhe lirë.

TRAJÇE MAZNIKU,
Hero i Punës Socialiste, mjeshtër ndërtimi, hoteli nr. 1, Tiranë

Diskutimin ta bëjmë që në projekt...

Vite më parë nuk bëheshin sa duhet konsultime me në punëtorët për projektet që ndërtoheshin. Tani, në sajë të mësimëve të Partisë e të shokut Enver, projektet diskutohen më gjerë dhe në punëtorët japin mendimin tonë. Natyrisht, një gjë e tillë duhet bërë më shumë e më mirë në të ardhshmen.

Lidhur me shfrytëzimin e traditës, kam mendimin të ruajmë e forcojmë anët më pozitive të saj. Kur isha i ri, ustai që më mësononte mjeshtërinë e të ndërtuarit më thoshte: «çdo gjë ta ndërtosh me cilësi sa më të mirë». Tani vërtet ne bëjmë ndërtime me cilësi të mirë, por aty-këtu shihen edhe gjurmët e një pune të pamenduar e organizuar mirë.

E them këtë, se ka patur raste që janë përdorur dekoracione pa fytyrë kombëtare. Kur punoja në ndërtimin e godinës së ATSH-së, e cila jo vetëm si formë, por edhe nga ana funksionale nuk është e përshpirtatshme me ato xhamalëqet e tepuara, mbasi aty janë zyrrat e duket çdo gjë, deri tek dyshe-meja, në një faqe muri të katit të parë vendosëm disa pllaka dekorative. Ato nuk të kujtojnë fare dekoracionet tona. Po të ishte menduar më mirë aty mund të vendoseshin ornamente të tjera

që të ishin më të bukura, më kombëtare e të kushtonin më lirë, se ato që vendosëm jo vetëm që s'janë aq të bukura, por kushtuan dhe më shtrenjt.

Në ndonjë rast, duke mos patur parasysh traditën tonë, janë bërë edhe gabime në planimetri-në e apartamenteve. Në një rru-gë të Tiranës janë ndërtuar pallate ku banjaja është vendosur nga ana e fasadës. Populli ynë gjithmonë ato i ka vendosur në pjesën e pasme. Atje janë më të përshpirtatshme dhe nuk dëmtojnë paraqitjen e fasadave kryesore.

Kjo duhet shikuar për të gjitha ndërtimet që bëhen tek ne. E që t'i arrihet qëllimit në këtë drejtim, është e domosdoshme që së pari të diskutojmë projektet.

Diskutimi që është hapur në gazetën «Drita» për probleme të karakterit kombëtar në arkitekturë, do të luajë një rol me rëndësi në këtë drejtim. Por unë kam një vërejtje; të zgjerohet më tepër diskutimi e të japin mendime, përveç arkitektëve, piktorëve e skulptorëve edhe njerëz të profesioneve të ndryshme, mbasi për ndërtimet mund të flasi çlido se ato i sheh dhe në to banojnë të gjithë.

AHMET TAIPI,
murator, hoteli nr. 1, Tiranë



Godina banimi në qytetin e Elbasanit.

Vazhdim i traditës në krijimet e një arkitekti

Mërgim Çapo,

Figuri Alim Mehmeti

Krijimtaria e arkitektit Skënder Luarasi, si projektues e ndërtes, është e shumanshme. Veprat e tij, së bashku me veprat e arkitektëve të tjerë, luajnë një rol me rëndësi edhe për ruajtjen dhe vazhdimësinë e fizionomisë kombëtare të arkitekturës sonë. Kjo gjë duket pothuaj në të gjitha objektet e projektuara prej tij, që janë ndërtuar në të katër anët e vendit. Në përpjekjet për krijimin e tipareve të reja të arkitekturës së re, me krijimet e tij, Luarasi ka qenë në kundërshtim me ndikimet e ideologjisë së huaj borgjezo-revizioniste, duke ia përshatur veprat e reja kushteve dhe mundësive reale të vendit tonë. Krijimtaria e këtij arkitekti përshkohet nga qartësia dhe thjeshtësia e objektit në harmoni me natyrën dhe ambientin ku është ndërtuar. Në çdo vend, fshat apo qytet që ndërtoi, ai u thellua në studimin e rrethanave, kushteve konkrete dhe karakterit të atij vendi dhe me pasion projekttoi godina të ndryshme, duke i harmonizuar ato me traditën tonë në këtë fushë. Kjo vihet re në mjaft vepra të tij. Po ndalemi në disa prej tyre të ndërtuara në qytetin-muze të Gjirokastrës.

Te hotel turizmi, arkitekti, krahas zgjidhjes së mirë të anës funksionale, ka menduar drejt si urbanist dhe arkitekt për të vendosur objektin në vendin e duhur. Pa dëmtuar sheshin, duke ruajtur përmasat e tij dhe duke e lidhur mirë me objektin përbi, me ndërtime të përreth dhe me objektet e tjera të sheshit si monumentin e

Çerçiz Topullit, bustin e dy heroinave dhe me rrapin e vjetër të këtij sheshi autori ka krijuar një ansambël të bukur arkitektonik.

Zgjidhja arkitektonike e objektit është e studjuar mirë dhe përputhet me funksionin, ku ambientet e brendshme (hollit kryesor dhe sallat e ndryshme) i japin ngrohtësi dhe kanë tiparet kombëtare të ndërtimeve tona. Ky objekt ka gjetur pëlqimin edhe të masës. Me të drejtë ai është vlerësuar edhe në shkrime të botuara në gazetën «Drita», në rubrikën «Mendimi ynë për karakterin kombinuar të arkitekturës».

Spitali i parë në vendin tonë, i projektuar me kërkesat e teknologjisë së kohës, është ai i Gjirokastrës, ndërtuar që në vitet e para të rindërtimit të vendit. Kjo është një vepër tjetër e Luarasit, që vlerësohet si një shembull i mirë i realizimit me sukses të lidhjes së brendisë me anën e jashtme arkitektonike, e cila harmonizohet me natyrën e atij vendi kodrinor.

Po kështu edhe godinat e banimit, kullat 5 katëshe në hyrje të qytetit të projektuara po nga ky arkitekt qëndrojnë mirë në terrenin e pjerrt të Gjirokastrës dhe harmonizohen me natyrën dhe ndërtimet përreth.

Përmendëm disa nga objektet e tija në qytetin-muze, ku problemi i ruajtjes së trashëgimisë të së kaluarës është më evident. Por S. Luarasi ka një inventar më të pasur objektesh, në të gjitha llojet e ndërtimeve,

në rrethe të ndryshme të vendit tonë.

Përdorimi i gurit të skalitur, i qemerit, i strehëve e i rrasave, kornizave dhe çative, dritareve me përmasa sipas funksionit dhe ambientit, janë elementë që autori i ka përdorur pothuaj në të gjitha veprat e tij. Duke ia përshatur specifikës së çdo godine ai ka rritur vlerat e veprave pa u rrembyer nga prirja moderniste për të veçantën. S. Luarasi ka punuar edhe si zbatues e drejtues punimesh në objekte me rëndësi, si në selinë e KQ të PPSH dhe në kombinatin e tekstileve «Stalin», duke u lidhur ngushtë me mjeshtrata të ndërtimit.

Një meritë të veçantë ky arkitekt ka edhe në organizimin e punës në projektimet në grup, kundër egos dhe lavdisë personale. E tillë ka qenë puna në projektimin e institucioneve shëndetësore të vendit tonë, ku në sajë të punës kolektive u arritën rezultate në drejtim të tipizimit, standartizimit të elementeve funksionale e konstruktivë, rrugë që shpejtoi ritmin e ndërtimit. Këtu Luarasi ka punuar e drejtuar grupin jo vetëm si arkitekt, por edhe si inxhinier ndërtimi.

Këto ditë ai u nda nga gjiri ynë. Duke parë gjithë krijimtarinë e tij shohim se ajo jo vetëm ka luajtur e luan rol me rëndësi në forcimin e traditës sonë, por është edhe një shembull i mirë ku mund të mbështeten krijuesit tanë të rinj, për ndërtime të bukura, funksionale e me karakter kombëtar.

Diskutim krijues për festivalin e këngës popullore-1976

Të mërkurën në Teatrin e Operës e të Baletit u zhvillua diskutimi krijues për festivalin e këngës popullore - 1976, të organizuar nga Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe i Valleve Popullore. Morën pjesë kompozitorë, poetë, këngëtarë, instrumentistë dhe punonjës të artit e të kulturës të qytetit të Tiranës.

Problemi kryesor rreth të cilit u përqëndruan diskutimet ishte thellimi i mëtejshëm i karakterit kombëtar e popullor i këngës sonë shqiptare në dritën e mësimave të Partisë dhe të shokut Enver Hoxha, përmes pasqyrimit të mendimeve e të emocioneve konkrete të njeriut tonë dhe trajtimit artistik të temave të marrura nga krijimtaria muzikore popullore, si dhe zhvillimit të tyre sipas kritereve artistike të muzikës sonë kombëtare e popullore (në harmoni, ritmikë etj.). Për këtë qëllim, u tha në diskutim, nuk mjafton vetëm puna e krijuesve, por duhet edhe kujdesi e pasioni më i madh i të gjithë interpretuesve dhe ekzekutuesve (dirigjentë, këngëtarë dhe orkestrantë), të cilët, duke mësuar nga më të mirët, të ndihmojnë me të gjitha mundësitë për zbulimin e vlerave ideoartistike të këngës sonë dhe pasurimin e karakterit të saj kombëtar e popullor. Ishin pikërisht këto të meta, në ndonjë rast të veçantë si të mjaftuarit vetëm me marrjen e temës nga këngëtarë popullore dhe trajtimi i saj larg kritereve të krijimtarisë muzikore të popullit, interpretimi i përgjithshëm e pa frymë popullore që u vunë re në ndonjë këngë të këtij festivali, Sidoqoftë shumica e krijimeve të tija mbeten një shembull pozitiv për thellimin e kësaj tradite të mirë të Ansambli Shtetëror të Këngëve e të Valleve Popullore dhe të krejt muzikës sonë të realizimit socialist. Gjithashtu, në këtë diskutim krijues, u theksua edhe nevoja për pasurimin e orkestrave me instrumenta popullore, duke flakur tutje çdo koncept frenues e duke kapërcyer me përpjekje më të mëdha çdo vështirësi që del në praktikë. U vlerësua më shumë interes iniciativa e instrumentistëve të këtij Ansambli të njohur profesionist, për të zotëruar secili më tepër se një instrument popullor, por kjo tanimë duhet bërë realitet nga të gjithë e të çohet nga secili gjër në fund. Po kështu, në këtë diskutim, pasi u vunë në dukje sukseset edhe në realizimin e disa poezive për tekste kënge, në forcimin e bashkëpunimit të kompozitorëve, poetëve, dirigjentëve e këngëtarëve, u theksua se është e domosdoshme afrimi më i madh i poetëve e shkrimtarëve në këto institucione artistike. Për këtë, vetë institucionet e interesuara, në radhë të parë, duhet të bëjnë më shumë, të kenë kontakt të vazhdueshëm me ta, t'i ftojë herë pas herë në diskutime, në shfaqje e në koncerte, të shkëmbejnë e të dëgjojnë më dendur mendimet e njëri-tjetrit për problemet e krijimtarisë



Hoteli i Gjirokastrës, projektuar nga Skënder Luarasi.

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Mendimi i masës dhe tradita

(Bisedë e redaktorit të gazetës sonë me punonjës të ateliesë, museut, anëtarë të degës së Lidhjes të Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Beratit.)

Redaktori: Në rubrikën e gazetës sonë «Mendimi ynë për karakterin kombëtar në arkitekturë», shkëmbejnë gjerësisht mendimet e tyre arkitektë, projektues, inxhinierë, krijues të arteve figurative, mjeshtra të ndërtimit etj. për çështje të ndryshme që kanë lidhje të drejtpërdrejta me këtë problem kryesor. Nder të është përmendur edhe siguri i mendimit të masës për të diskutuar qysh në fillim veprat e arkitekturës. Na duket me interes që të qëndrojmë posaçërisht në këtë çështje. Cili është mendimi juaj, çfarë do të sugjeroni në këtë drejtim dhe mundësisht disa forma pune konkrete?

Shuaip Mane: (drejtor i ateliesë) Kemi vite që degjojmë e shohim se si krijuesit tanë në disa lloje të tjera të artit, si në letërsi, (prozë, poezi, dramaturgji), artet figurative etj. diskutojnë projektidet e veprave të tyre me masat punonjëse. Dëgjojnë mendimet e tyre, mësojnë, marrin vërejtjet dhe pasurojnë veprat artistike përkatese. Bile për raste të tilla të shumta, anë e kënd Atdehat, lexojmë edhe në shtyp. Kjo tani më është një përvojë shumë e mirë që duhet praktikuar më mirë e gjerësisht edhe në arkitekturë. Ndokush mund të thotë se raste të tilla nuk mungojnë edhe në këtë lloj artit. Mundet. Por ato janë të pakta. Dhe këtu fjala është, ashtu si porositi vazhdimisht Partia dhe shoku Enver Hoxha, për një kriter pune sistematike e jo një apo dy herë sa për justifikim.

Ajet Nallbani: (teknik ndërtimi). - Në fund të vitit të kaluar u zgjerua këshilli i zyrës së projekteve në Komitetin Ekzekutiv të kp të rrethit tonë. Aty kanë hyrë tani edhe punëtorë, mjeshtra të njohur popullorë. Kjo është një gjë e mirë. Por jo gjithëka. Më duket shumë e rëndësishme që kjo këshillë të mos mbesi formale, por të funksionojë rregullisht dhe t'i shërbejë qëllimit për të cilin është ngritur. Të diskutohen projektet gjallërisht, aty të jenë edhe autorët. Anëtarët e këshillit të organizojnë diskutime masive, të mbajnë shënime dhe pastaj mendimi i masës të grumbullohet e të studjohet me vëmendje, të nxirren mësimet të drejta dhe këto të zbatohen. E theksojmë këtë, sepse edhe në ndonjë rast tepër të rrallë kur janë bërë të tilla diskutime (jo vetëm në Berat, por edhe në qytete të tjera të vendit tonë), sikur janë organizuar sa për të kaluar radhën. Megjithatë vërejtjet e bëra, objektet prapë është ndërtuar po atje po ashtu si në variantin e projektit që u diskutua. Kështu p.sh., ndodhi me ndërtimin e tregut të perimeve pallatin e kulturës etj. Sot pikërisht vepra të tilla ashtu si janë vendosur e si janë projek-

tuar e ndërtuar stonojnë me krejt urbanistikën dhe arkitekturën (qoftë të traditës, qoftë edhe me atë bashkëkohore të qytetit tonë).

Kapllan Dehari: (mjeshtër ndërtimi). - Ka edhe disa raste që projektet nuk janë diskutuar me masën dhe me specialistët e ndërtimit. Prej diskutimeve të tilla mund të përfitohet shumë. Le të shohim disa institucione social-kulturorë si kinema, bibliotekë, hotel-turizmi etj. Janë të rënda, tepër të rënda. Aty-këtu ndonjë përpjekje për ndonjë element dekorativ nga tradita. Qyteti i Beratit është një ndër qytetet-muze të vendit tonë, që ka një pasuri të çmuar në kulturën materiale. Arkitekti, që ndërton këtu, bile edhe të gjithë të tjerët, duhet të dinë të marrin nga kjo traditë e ta trajtojnë atë me art përshatat kërkesave jetike dhe social-estetike të masave tona punonjëse. Kush më mirë se ata, mund t'u vij në ndihmë arkitektëve në këto raste? Masat janë shumë të interesuara për këto ndërtime. Ato jetojnë në to, ato i përdorin. Ja p.sh., në restorantin e turizmit e në kafene të «mbysin»-bufetë me lëndë të parë shumë të kushtueshme. Të tilla ambiente gjejmë edhe në ndonjë hotel - restorant tjetër. Po pse të


mos ndërtohen ato më thjeshtë, e më bukur, duke pas njohur e studjuar arkitektët dhe projektuesit tanë më parë interierët që ka përdorur populli ynë. Me sa mençuri dhe finesë i shfrytëzon arkitekti popullor sipërfaqet e mureve (kamara, musandra dhe interiere të tjera për takime kafeje, çaji etj.). Kurse në rastin që përmenda - bufe përmbi bufe, - aq të ngarkuara me sirtarë, të gjitha me rimeso a plastmasë të kualiteteve të shtrënjta. Këtu, si të thuash, zburon leku dhe jo mendja e atij që ndërton. Behet në këto raste, siç thonë, «luftë me lekun». Por ne kemi një mori modelesh të bukura interieresh, gdhendjesh në dru etj., që po të bëhen objekte studimi nga arkitektët e dekoratorët, po të punohet me frymëzim e dashuri prej tyre, bëhen gjetje shumë të bukura nga kjo traditë e pasur kombëtare e popullore që kemi. Se mos vetëm në këtë rast, po ashtu si është thënë edhe në disa shkrime të tjera të kësaj rubrike, edhe për probleme më të rëndësishme në urbanistikë dhe në arkitekturë (tipet e ndërtesave, konstruktet, vendosja e lagjeve, qyteteve etj.) Vetë takimet me masat dhe specialistët e ndërtimit do të nxjerrin çështje me dobi për zhvillimin e arkitekturës sonë, ashtu siç e tregon edhe përvoja jonë më e mirë.

Redaktori: - Gjetje dhe trajtime të tilla arkitekturale në konstruktet, interiere, bufe (banak) elemente dekorative etj me karakter kombëtar, funksionalë dhe të leverdisshëm kemi në disa vepra të arkitekturës sonë të realizimit socialist. Nder të është p.sh. edhe ndërtesa në pikën turistike të Drilonës në Pogradec me anekset dhe interieret e saj, vendet e çlodhjes, shfrytëzimin e sipërfaqeve të murit etj. Ose edhe në shtëpinë e pushimit të punëtorëve në Korçë. Gjetje dhe zgjidhje të goditura për forcimin e karakterit kombëtar në arkitekturë në ndërtimet tona ka. Por


duhet pasuruar edhe diskutimi rreth tyre që të përhapet kjo përvojë pozitive. Pra, si po shtjellohet çështja edhe në këtë bisedë kryesorja është që mendimi i masës dhe i specialistëve të tërhiqet në kohën e duhur dhe të synohet kryesisht drejt zbulimit dhe pasurimit të vlerave pozitive.

Myslim Hotova: (drejtor i muzeut). - Sigurimi i mendimit të masës, më duket i nevojshëm edhe për ndërtimin e fshatrave tona të reja. Bile në këtë drejtim duhet bërë shumë. Janë bërë planimetri fshatrash, por kooperativistët duhet t'i njohin këto planimetri e projekte. Mendoj, gjithashtu, se projektuesit duhet të njohin mirë edhe problemet aktuale social-ekonomike dhe ato të perspektivës së fshatit tonë socialist. Ndërtuesit e fshatrave të dikurshëm vërtet projekte e planimetri në letër nuk bënin, por kriteret social-ekonomike të kohës së vet i kanë zbatuar. Ai e ndërtonte p.sh. fshatin në një vend me mundësi maksimale për mbrojtje në rast lufte, të kishte ujë të pijshëm, ujë edhe për të vaditur. Banesën e vendoste në një vend që e lëronte shtësinë e saj në funksion të rritjes së familjes patriarkale. Edhe në shtëpitë e ngritura në shpatë malesh, në krepë, buzë honesh e gjetkë të shkosh të bëjnë përshpytje të madhe. Ngado që të hedhësh sytë sheh horizont pa fund. Shumë male, shumë qiell, shumë hapësirë. Është rritur shqiptari në këto fshatra me këmbët e mbrëthyer në tokën e vet e me psikologjinë e botën shpirtërore jo të njeriut të një vendi të vogël, por me pafundësinë në zemër. Në këtë vështrim, mendoj se urbanistika e fshatrave të reja është mirë që të diskutohet më gjerë e më thellë. Në diskutimet e bëra po dalin sugjerime interesante. Por për plotësimin e nevojave të tyre dhe të kërkesave estetike, arkitektët tanë, projektuesit dhe urbanistët duhet të njohin mirë stadin e

(vijon në f. 12)



Ndërtim karakteristikë në lagjen «Mangalem», Berat.



ATENTATI DË JALOSHI SHQIPTAR
QË QELLOI VIKTOR E MANUELINE
ISHITE FILIMI I NJË KRYENGRITJEJE
TË MADHE QË PO PREGATITET

Th. Thomaj:
«Atentatori»

Mendimi i masës dhe tradita

(vijon nga f. 7)

zhvillimit të sotëm të fshatit e të qytetit, dhe të perspektivës. Në qytete p.sh., ata kanë më shumë suksese. Po kështu do të kemi edhe në fshatra, si për vendosjen e tyre në përgjithësi, ashtu edhe për banesën në vecanti, në funksion të kërkesave jetike dhe social-estetike të kooperativistit tonë të ri. Diskutime të tilla janë bërë, p.sh., në Lapardha, Poshnje, Goriçar, Kutall etj. të rrethit tonë. Bile ka filluar edhe zbatimin i projekteve të diskutuara e të aprovuara.

Redaktori: - Gjatë bisedës sonë mbi sigurimin e mendimit të masës dhe gjallërimin e diskutimeve sistematike për urbanistikën dhe veprat e arkitekturës, u shprehën edhe mendime lidhur me rolin e madh të traditës kombëtare e popullore në zhvillimin e mëtejshëm të këtij lloj arti të realizmit socialist. Cilat do të ishin disa nga mënyrat konkrete për studimin, shfrytëzimin dhe trajtimin artistik të kësaj tradite (dhe asaj të realizmit socialist) në arkitekturën tonë.

Vangjel Papa: (skulptor) - Janë të drejta mendimet e shfaqura për studimin e traditave tona në Degën e Arkitekturës, bile edhe në atë të Ndërtimit të Universitetit të Tiranës, organizimin e studimeve apo të sesioneve shkencore për këtë qëllim. Por për një angazhim më të madh të arkitektëve dhe projektuesve tanë në njohjen dhe studimin e kësaj tradite, mendojmë se është e nevojshme që secili prej tyre vazhdimisht të ketë kontakte me këtë

traditë, të bëjë skica, të fotokopjojë ose të shfrytëzojë arkivat ekzistuese në qytetet-muze, në Institutin e Monumenteve të Kulturës. Dhe do të ishte mirë që rezultatet e hulumtimeve të tilla të botoheshin herë pas here edhe në shtypin tonë.

Hatem Hyseni: - Në këtë drejtim ka edhe përpjekje. Kështu, p.sh., në Berat vijon çdo vit ekspedita nga Universiteti (ato mund të bëhen me një pjesëmarrje më të gjerë të studentëve, të pedagogëve dhe të arkitektëve). Po çfarë studojnë, ku qëndrojnë vlerat e kësaj tradite, si mund të përdoret e për çfarë paraqet interes ajo në ditët tona, të gjitha këto mendojmë se janë çështje për të cilat duhet shkruar e të popullarizohen, ndoshta dhe në programet e Radio-Televizionit.

Vangjel Papa: - Aq më tepër të nevojshme janë diskutimet krijuese dhe pasqyrimi i tyre në shtyp, mbi veprat e arkitekturës të realizmit socialist. Si i kanë zgjidhur ato problemet për të cilat diskutohet e çfarë duhet përgjithësuar, si shmangen të metat në procesin e trajtimit artistik për të mos rënë në kopjim të traditës, por edhe për të mos e mohuar atë gjoja në emër të «forcës krijuese» dhe të «ecjes përpara» etj. Dhe ashtu, si na porositin Partia dhe shoku Enver Hoxha, vazhdimisht në diskutime të tilla të tërhiqet, krahas mendimit të arkitektëve, specialistëve e mjeshtrëve të ndërtimit, edhe mendimi i sociologëve, ekonomistëve, inxhinierëve të zbatimit etj., sepse të gjithë jemi të interesuar për problemet e arkitekturës.

Në frontin e punës krijuese

Për 35-vjetorin

e themelimit

të Partisë

Forcat krijuese të letërsisë dhe të arteve të rrethit të Korçës janë mobilizuar për të vënë në jetë objektivat dhe zotimet që ata kanë marrë për nder të 35-vjetorit të themelimit të Partisë. Gjatë këtij viti jubilar shumë shkrimtarë, letrarë të rinj, kompozitorë, piktorë, skulptorë etj. do të përfundojnë mbi 125 krijime të gjinive dhe të llojeve të ndryshme, nga të cilat 9 janë në proces botimi.

Mjaft shkrimtarë dhe letrarë të rinj po shkruajnë vepra skenike. Ata janë zotuar të mbarojnë 6 drama dhe dy komedi. Shkrimtari Hamza Koçi po përfundon dramën «Përsëri në deb». Në dramën «Gjilpërat», të Guri Micinotit, spikat ideja e mbështetjes në forcat e veta për të thyer bllokadën e egër imperialisto-revizioniste. Për formimin

botëkuptimor të njerëzve në ndikimin e realitetit tonë socialist flet drama që po shkruan Vangjush Ziko. Disa autorë të tjerë si Andon Mara në dramën e tij «Pisha dhe asfalti», Riza Hysa etj. po trajtojnë temën e luftës së klasave në fshatin tonë. Shkrimtari Miço Kallamata po mbaron romanin me temë historike, në qendër të të cilit është figura e Rrapo Hekalit. Kurse Petraq Zoto dhe Petraq Samuri trajtojnë në romanet e tyre probleme të edukimit të rinisë dhe të fëmijëve. Kanë pregatitur vëllime me poezi Julia Naçi, Petraq Kita, Rafael Stavre, Ilija Graboka.

Nga 60 vepra që kanë filluar të punojnë piktorët dhe skulptorët e këtij rrethi, 20 janë kompozime me temë nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, ndërtime socialist e vendit, aspekte nga puma dhe jeta në fshat, nga r.brojtitja e Atdeut tonë socialist etj. Piktori Sotiraq Sholla po punon për kompozimin me temë nga ndërtimi, Fiqiri Progri e Kristofor Naslazi me temë nga lufta, Vangjush Tushi një portret etj. Skulptori Ilija Xhano po skalit në gur portretin «Metalurgu», ndërsa skulptori Piro Dullaku kompozime dhe portrete me tema aktuale etj. Një cikël me grafika po pregatit Andrea Themeli. Me krijimet e tyre piktorët dhe skulptorët do të nderin 3 ekspozita.

Edhe kompozitorët, sipas zotimeve që kanë marrë, po punojnë për të përfunduar mbi 30 krijime muzikore. Një triptik vokal instrumental po e përfundon kompozitori Kristo Kono, kurse kompozitori i ri Josif Minga po kompozon një temë me varacione për oboje dhe orkestër dhe një uverturë festive.

(ATSH)

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Studimi i krijimtarisë popullore në arkitekturë

Aleksandër Meksi

Studimet në fushën e arkitekturës shqiptare përbëjnë një nga degët e reja të shkencave albanologjike. Vitet e fundit ato kanë marrë një shtrirje më të gjërë në sajë të kujdesit të Partisë dhe të angazhimit të mjaft forcave shkencore. Në këtë fushë, që përfshin kufij kohorë shumë të gjerë, që prej lashtësisë ilire e deri në ditët tona, një vend të posaçëm zënë ndërtimet popullore. Kjo krijimtari e mirëfilltë spikat veçanërisht në ndërtimin e banesave, një nga kategoritë më të lidhura me kushtet ekonomiko-shoqërore të jetës.

Rëndësia e madhe e krijimtarisë popullore në arkitekturë, si për historinë e arkitekturës shqiptare,

ashtu dhe për historinë e popullit tonë është shkak i vlerësimit që iu bë kësaj fushe të shkencave albanologjike. Në fillim arkitektura popullore tërhoqi vëmendjen e etnografëve, të cilët krahas gjurmimit të komponentëve të tjera etnografike, nuk lanë pas dore as ndërtimet popullore e veçanërisht banesën si në fshat ashtu dhe në qytet.

Më vonë, e sidomos tani, që po punohet më gjërësisht për forcimin e karakterit kombëtar në arkitekturë, krahas vënies në mbrojtje shtetërore të shumë ndërtimeve popullore, ka filluar një punë e gjërë për dokumentimin e tyre shkencor, grafik, fotografik dhe përshkrimor. Një rëndësi e

posaçme i është kushtuar ansambleve të qyteteve-muze që përbëjnë një dëshmi të plotë të realitetit arkitektonik të qytetit shqiptar në shekujt 18-19-të. Me përgatitjen më të gjërë të kuadrove, ka filluar puna për një gjurmim më të thelluar të vlerave të arkitekturës popullore në qytetet tona. Kështu, numri i ndërtimeve popullore qytetare të vënë në mbrojtje është rritur. Krahas saj në disa qendra janë vënë në mbrojtje shtetërore dhe ansamble lagjesh të banuara; apo pazare të vjetra. Përveç vënies në mbrojtje të ndërtimeve, për historinë e arkitekturës shqiptare janë dokumentuar dhe një sërë ndërtimesh të tjera që ruajnë vlera, duke rritur kështu mjaft fondin e dokumentacionit shkencor të arkitekturës popullore. Është bërë një punë sistematike edhe për gjurmimin e ndërtimeve fshatare. Deri më sot janë gjurmuar shumë rrethe të vendit dhe është grumbulluar një dokumentacion i pasur. Krahas gjurmimit sistematik të ndërtimeve fshatare, nuk janë lënë pas dore fshatrat - rrënojës, disa prej të cilave i përkasin shek. XIV - XV dhe kanë një rëndësi të posaçme për njohjen dhe studimin e trashëgimisë sonë arkitektonike. Kjo punë gjurmuese dhe dokumentuese ka prurë si pasojë grumbullimin e një materiali të gjërë dokumentar, të mbledhur me kritere të drejta shkencore, i cili, së bashku me objektet e vëna në mbrojtje shtetërore, përbën fondin themelor, i

cili do të ushqejë studjuesit e arkitektët tanë që t'i kenë si mbështetje për ndërtimet e reja. Deri tani, në arshivat shkencore të Institutit të Monumenteve të Kulturës, sektorit të arkitekturës dhe arteve dhe atij të etnografisë; pranë Institutit të Historisë, ruhen rievimet e plota apo të pjesshme të disa qindra ndërtimeve popullore, si dhe një numër shumë i madh fotografish.

Studjuesit e kësaj fushe janë në pragun e një hopi cilësor në këto studime, për të kaluar në monografi dhe tema me karakter krahasues dhe përgjithësues. Materiali i mbledhur, veprimtaria studimore dhe botuese e derisotme dhe ngritja e nivelit shkencor të kuadrove që merren me këtë fushë, janë një bazë e shëndoshë për rritjen e numrit të botimeve dhe thellimin problematik lidhur me trashëgiminë e arkitekturës sonë popullore.

Studimi i arkitekturës popullore i kalon edhe caqet e kuadrit kombëtar për faktin se, në vendin tonë, ruhen shumë tipa banesash që nuk i takojmë në popujt e tjerë ballkanikë. Studimi i banesës shqiptare, në kuadrin ballkanik, sjell pa dyshim një kontribut akoma më me vlerë për sqarimin e problemit të huazimeve, influencave reciproke dhe lidhjeve ndërballkanike. sidomos po të kemi parasysh veprimtarinë e madhe ndërtimore të mjeshtrave shqiptarë. Interesi për banesën shqiptare është i madh dhe për larinë e madhe të tipeve dhe ruajtjen e shumë formave të lashta që gjenden vetëm në vendin tonë. Kjo shprehet edhe nga interesi me të cilin priten jashtë studimet tona, për arkitekturën popullore.

Puna kërkimore dhe botuese e bërë deri më sot është një kontribut me shumë vlerë në këtë fushë të re të shkencave albanologjike. Për intensifikimin e mëtejshëm të saj, forcat shkencore do të rriten sidomos për të përfunduar sa më parë gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të ndërtimeve fshatare, të cilat për shkak të ndryshimeve rrethësore të kushteve të jetës, bëhen jo të përshatshme dhe rrezikohen të humbasin, sepse i nënshtrohen ndryshimeve të gjithanshme, deri në prishje për t'i rindërtuar nga e para.

Krahas punimeve të mësipërme, detyrë me rëndësi është dhe publikimi i gjërë i këtyre materialeve në revistat tona shkencore, në formë artikujsh si dhe kalimi në studime të veçanta monografike. Botimet në lidhje me arkitekturën popullore pa dyshim do të kontribuojnë ndjeshëm në njohjen e kësaj trashëgimie jo vetëm nga arkitektët, për të cilët është e domosdoshme, por edhe nga masat e gjera. Kjo do të bëjë që arkitektura popullore të shërbejë si burim i madh nga ku projektuesit tanë, mbi bazën e një njohjeje të thellë të saj, do të dinë të marrin atë që është pozitive dhe me vlerë për të mbështetur më shumë krijimet e kohës sonë mbi tabanin e shëndoshë kombëtar.



Pazari karakteristik në Frujë.

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

T'i bëjmë veprat e arkitekturës të bukura dhe ekonomike

Bardhul Shehu, ekonomist

Qytetet tona dikur të vegjële të pazhvilluar, sot kanë ndryshuar fizionominë e tyre; janë transformuar në qendra të mëdha banimi, ku pasqyrohet e përsia e rendit tonë socialist me të gjithë treguesit e tij.

Fonde të konsiderueshme janë investuar nga shteti për zhvillimin e mëtejshëm të qyteteve dhe transformimin socialist të fshatrave.

Realizimi konkret i ndërtimeve të deritanishme dëshmon për përpjekjet e përbashkëta të projektuesve dhe ndërtuesve për të krijuar kështu kushte të përshatshme banimi dhe ambiente shoqërore të kulturuar.

Ndërtimi i Kukësit të Ri, i qyteteve të reja industriale Laç dhe Ballsh, i qendrave të banuara në Batër, Kurbnesh, i fshatrave socialistë Ninesh, Godurov të rrethit Fier; Shikaj, Fajzë të tjerë, pa përmendur zgjerimin e gjithë qyteteve ekzistuese si rezultat i zhvillimit të madh në vendin tonë, dëshmojnë për zbatimin e orientimeve të Partisë për ndërtim të bukura dhe ekonomike. Pozitive në këto ndërtime, në përgjithësi, është se kombinohet drejt faktori i të bukurës me ekonominë, duke shfrytëzuar racionalisht tokën, duke rritur shkallën e komoditetit të përgjithshëm, me pamje të thjeshta, duke shfrytëzuar në maksimum ajrin, diellin dhe gjelbërimin. Kjo është në fakt tabloja e ndërtimeve në shoqërinë tonë të re socialiste.

Lufta për një arkitekturë të shëndoshë, me nivel të lartë ideoartistik, me vlera ekonomike, në përputhje me shijet e popullit dhe në vazhdim të tradita-

ve tona kombëtare, ka qenë e mbetet një nga preokupimet kryesore të punonjësve të projektimit. Por me gjithë sukseset që kemi në këto drejtime, duhet theksuar se ka patur raste që disa arkitektë ta shohin arkitekturën të shkëputur nga faktori ekonomik, të veprojnë kështu të veçuar, duke u larguar edhe nga karakteri kombëtar i saj.

Mendimi që ka shprehur ndonjë se e bukura nënvlefësohet në raport me dobishmërinë dhe fortësinë dhe është në kontradiktë me faktorin ekonomik është një koncept i huaj. Këtë gjë e hedh poshtë vetë realiteti; realizimet e bërë deri më sot tek ne. Vlerën estetike, të së bukurës, në arkitekturë, nuk ia humbet faktori ekonomik, përkundrazi, janë pikërisht shijet e huaja, pikëpamjet estetizante, që e përgojnë vlerën arkitektonike të një veprë, duke e ngarkuar atë me forma të tilla të rëndomta, pa funksion, pa shije artistike dhe për pasojë me shpenzime të tepërta që e rëndojnë ekonominë.

Vetë tradita e pasur e ndërtimeve tona, e trashëguar, me arritjet e saja të çmuara kombëtare dhe me vlera ekonomike hedhin poshtë këto koncepte. Gjithmonë populli ynë ndërtimet i ka bërë duke i dhënë komponentët e vet, funksionin edhe të bukurën të lidhur ngushtë me ekonominë.

Janë pikërisht edhe këto nënvlefësimet të traditës, të mos shfrytëzimit të kësaj pasurie që disponohet, që tek ndonjë arkitekt bënë të lindin koncepte të huaja dhe antiekonomike. Si rezultat i këtyre mendimeve u krijuan vepra të tilla si Biblioteka në Korçë; Shtëpia e Kulturës në Burizanë; Muzeumi në Krujë, banesa karshi

mapos nr. 1, Tiranë e ndonjë vepër tjetër, ku ju dha prioritet formës, në kundërshtim me shijet tona ideestetike, jofunksionale dhe me shpenzime të mëdha ekonomike, vepra të cilat janë kritikuar me të drejtë edhe në këtë rubrikë të gazetës dhe nuk janë pëlqyer nga populli.

Në godinën e banimit karshi mapos nr. 1 në Tiranë projektuar nga M. Velo, kostua për apartament vajti dyfish, mbizotëron një anomali në ndërtimin e brendshëm të apartamentve, jepen sipërfaqe banimi e shërbimi të pa-justifikuara me forma e madhësi të ndryshme. Në fasadë, për hir të «arkitekturës së lirë», janë krijuar ballkone pa asnjë funksion.

Shijet e huaja, në këtë rast rënduan jo vetëm mbi funksionin dhe pamjet e kësaj ndërtese, por më shumë edhe mbi ekonominë, sepse me ato harxhime do të ishin ndërtuar dyfishi i atyre apartamenteve që janë në këtë veprë.

Vepra të tilla nuk kanë dobi shoqërore. A pra kush e lind kontradiktën, ndikimi dhe shija e huaj dhe jo faktori ekonomik. Porcimi i regjimit të kursimit është në harmoni me të bukurën, të thjeshtën, për stilin popullor dhe me të njëjtën kohë barrikadë kundër teprimeve, luksit, përdorimit pa kriter e nikoqirllëk të materialeve deficitare.

Madhësinë e një veprë nuk e përcaktojnë ngarkesa me format estravagante ose madhësia voluminoze, apo shpenzimet e mëdha ekonomike, por në radhë të parë përmbajtja dhe vlera e saj ideestetike.

Arritjet pozitive kemi në projektimin e ndërtimin e lagjes në kodër në Gjirokastrë, shtëpisë së kulturës në Gramsh, hotelit në Fushë-Arrës, shtëpisë së pushimit të punëtorëve në Korçë etj., vepra që mbështeten në traditën tonë dhe kanë dalë dhe ekonomike.

Zhvillimi i shkencës dhe i teknikës në ndërtim ka ecur përpara. Duke u zgjeruar parafabrikimi dhe industrializimi i ndërtimit është rritur gama dhe cilësia e përdorimit të materialeve ndërtimore. Ky faktor me rëndësi ka ndikuar jo vetëm në ndërtimin e shpejtë, por në ato raste kur janë përdorur me kriter këto materiale, ndërtesa ka kushtuar edhe më lirë.

Por, përdorimi pa kriter, pa studim i betonarmesë si në rastin e disa fabrikave të miellit të çon në atë që konstruksioni t'i kundërvihet kërkesave të kohës, forcimit të regjimit të kursimit. Një vepër mund ta vlerësojmë pozitivisht kur arkitektura është në harmo-

ni me konstruksionin, kur konstruksionin të mos e pranojmë për hir të formës si në godinat e ndërtuara në rrugën Skënderbej në Tiranë, ku përdorimi pa ekonomi i betonarmesë dhe materialeve të tjera ka shëmtuar jo vetëm pamjen, por në të njëjtën kohë u harxhuan pa kriter e pa përgjegjësi fonde të mëdha për ndërtimin e tyre.

Në përgjithësi problemën e të bukurës dhe ekonomisë që kërkojnë në ndërtimet tona duhet ta koordinojmë dhe ta përballojmë me vendosjen e standarteve. P.sh., ulja e kostos së banesave realizohet po të përdorim drejt e me kriter industrializimin, tipizimin dhe strandartizimin dhe s'kemi pse t'i trembemi monotonisë, sepse standarti shpie në përsosmëri dhe vendosja e drejtë të standarteve përballon edhe problemën e së bukurës, ekonomisë, duke manovruar nëpërmjet varianteve të ndryshme për t'iu shmangur uniformizmit. Pozitive është studimi për ndërtimin e banesave në rrugën «28 Nëntori» në Tiranë, Studimi i njësive së banimit që po përfundohet nga punonjësit e Institutit të Projektimeve, ku kombinohet drejt funksioni, pamja dhe ekonomia, kundrejt sesioneve tip ekzistuese. Vetëm si kosto ky studim i ri për çdo apartament do t'isjellë ekonomisë një kursim të konsiderueshëm, duke ngritur shkallën e komoditetit, duke sjellë llojshmëri të shumta në ndërtimin e apartamenteve në unitet me të thjeshtë dhe të bukurën dhe, siç e theksuam edhe më lart, me kosto më të ulët.

Në rrugë të drejtë u ec edhe me rihartimin e pamjeve të kinoteatrit në Sarandë, ku me një punë të kujdesshme dhe studim të thelluar, u realizua një projekt me pamje të thjeshta e të bukura, ku spikat stili popullor i ndërtimeve tona. Ajo që kontribuoi në këto realizime ka qenë dhe zbatimi i drejtë i vijës së masave, rrahja e mendimeve me mjeshtrat e specialistët e ndërtimit, me popullin, shfrytëzimi i traditave dhe kulturës kombëtare në artin e ndërtimit.

Ka dhe shembuj të tjerë që tregojnë se sa drejt po kuptohen dhe po vihen në jetë porositë e Partisë dhe mësimet e shokut Enver, për një revolucionarizim të punës në projektim e ndërtim, duke luftuar egon, individualizimin, lavdinë personale, duke i dhënë prioritet unitetit përmbajtje - formë - ekonomi, duke shfrytëzuar kulturën tonë kombëtare të ndërtimit, duke kombinuar drejt kërkesat e kohës me stilin popullor dhe shijet e popullit.



Qytetet tanë të rinj.

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Veçori të traditës sonë

Valentina Pistoli, arkitekto

Populli megjithëse ndërtime nuk i ka bërë njëherësh, apo një pjesë të tyre i ka ripunuar më vonë, në çdo kohë ka mundur të ruaj një zhvillim harmonik dhe estetik të përgjithshëm të tyre.

Në unitetin e formës me përmbajtjen, që shohim në këto ndërtime, në zhvillimin harmonik dhe estetik të tyre, ne duhet të mbështetemi më fort për ndërtimet e reja, për t'u prerë rrugën dobësive dhe të metave dhe sidomos për të luftuar shfaqjet e ndikimit e huaja.

Nga mosshfrytëzimi i kësaj tradite të mirë ka patur raste të vendosjes së objekteve me vend e pa vend, me forma e ngjyra të e veçanta, me mbitheksime volumore të tepruara, të cilat nuk janë në unitet me njëra-tjetrën, nuk japin një rregullsi dhe të krijojnë përshtypjen sikur janë ndërtime të epokave të ndryshme. Kjo ka ndodhur edhe nga moskordinimi i mirë i punës ndërmjet vetë projektuesve, urbanistëve, si në ndërtime e rrugës «Myslym Shyri» të një pjese të unazës, të rrugës «Skënderbeg» në Tiranë, Kurse ndërtime e shtesës së ATSH-së dhe e godinës së Agjencisë Ajrore, jo vetëm që nuk kanë asnjë lidhje me ambientin ekzistues, por me ngritjen e tyre në lartësi kanë prishur unitetin e gjithë ndërtimeve në atë rrugë. Edhe rastet e tjera që tani janë të njohura për lexuesit si kino-teatri në Fier, biblioteka në Korçë, apo godina në formë sharre në rrugën «Skënderbeg» në Tiranë etj., me format dhe volumet

e tyre të papërshtatshme, me trajtimin e pamjeve me kontraste të mëdha midis pjesëve të plota e xhamlleqeve të tepruara nuk i përgjigjen funksionit të veprave, s'kanë asgjë të përbashkët me shijet tona ideestetike. Konceptimi urbanistik i kontrasteve të mëdha midis volumeve të shtrira e atyre të larta, që është shprehur në zgjidhjet e shesheve apo nyjeve kryesore të disa qyteteve dhe që ne projektuesit e kemi konkretizuar me ndërtimin e hoteleve të larta shumëkateshe, dy prej të cilëve kam projektuar dhe unë, është i huaj për arkitekturën tonë. Këto hotele nuk janë mbështetur sa duhet në traditën tonë, siç është vënë në dukje me të drejtë në shkrime të kësaj rubrike.

Edhe problemën e unitetit të raporteve midis anës funksionale estetike dhe asaj teknike në krijimtarinë arkitektonike, populli në ndërtime e veta i ka zgjidhur me sukses. Që në konceptimin e veprës mjeshtrat janë nisur që të shfrytëzojnë njëherësh të gjithë vetitë e materialeve rrethorë të gurit, drurit, tullës etj. si aftësi mbajtëse të tyre, të cilat i kanë vënë në shërbim të konstruksionit për të dhënë strukturë ndërtimore të qarta, të forta dhe ekonomike, ashtu edhe vlerat e tyre estetike, duke realizuar me to elemente të bukura dekorative. Me shumë logjikë janë shfrytëzuar vetitë mbajtëse të gurit, si në muraturë të thjeshtë, ashtu edhe në mbulime të hapësirave të ndryshme, duke na dhënë forma të bukura, së

bashku me trajtimin e sipërfaqes së dukshme të tij të gdhendur me shije. Po kështu janë zgjidhur edhe materialet e tjera si druri i përdorur në tavane, strehë, parapetë, korniza dritaresh e qoshe muresh etj., të cilat kryejnë funksione mbajtëse dhe dekorative njëkohësisht. Krahas kësaj veçorie të rëndësishme të traditës, del në pah edhe ana tjetër e saj. Materialet e forta janë lënë gjithmonë në dukje, si brenda ashtu edhe jashtë objektit.

Këto veçori sa ekonomike aq edhe estetike, ne duhet t'i kemi mirë parasysh në objektet që qendrojmë. P.sh. sot gurin e përdorim kryesisht si mur masiv për themele e cokol dhe më rrallë si muraturë të kateve, por shpesh ne atë e suvatojmë. Lënia e gurit në dukje në pamjet e jashtme, duke i bërë edhe një përpunim minimal të fugave të tij do do të ish më i mirë dhe më i efektshëm, se sa kur ay mbulohet qoftë edhe me suva granili. Gjithashtu duhet të zhvillohet më tej përdorimi i tij si material veshës, duke e industrializuar atë për të krijuar forma me fakturë të përshtatshme për veprën dhe ambientin ku ndërtohet, pa lënë mënjani sigurisht anën ekonomike të tyre. Veshjet me gurë që janë bërë në disa objekte të ndërtuara kohët e fundit nga mjeshtrat tanë, si në Galerinë e Arteve, në hotelin e Gjirokastrës, spitalin e Rrëshenit etj. janë mjaft të efektshme dhe duhen inkurajuar.

Një trajtim më i mirë i muraturës sidomos i asaj me tullë të kuqe dhe një zbatim më i kujdesshëm i tyre nga ana e ndërmarrjeve të ndërtimit me anë të fugaturave të rregullta, të kombinacionit të tij me përpunimin e pjesëve të betonit si të brezave dhe të elementëve të tjerë të parapeteve të ballkoneve apo lloxhave, të strehëve etj., do të na jepte pamje më të përshtatshme e të bukura se sa lënia e saj karabina me mendimin se do të suvatohet në të ardhshmen që ndërkohë mbetet për shumë vjet në gjendjen e karabinasë. Për veshjen e mureve të brendshme apo tavaneve të varura në disa vepra shoqërore ka raste që përveç suvatimeve përdoren materiale importi sintetikë të ndryshme që s'janë as më të bukura, as më të forta se sa druri dhe nënprodu-


ktet e tij (plakat e zdrukthit, kompesatoja, rimesoja etj.), që janë ndërkohë materialet të ngrohta dhe dekorative.

Është për t'u theksuar se të gjitha karakteristikat pozitive të traditës sonë janë të lidhura ngushtë me ekonominë. Sa pari, është shfrytëzuar me nikoqirllëk trualli i ndërtimit duke shfrytëzuar tokat kodrinore ose duke bërë zgjerim të kateve të sipërme. Zgjidhjet planimetrike, përmasat dhe format e ambienteve janë konform komoditetit optimal të tyre. Shfrytëzimi i materialeve rrethorë është shprehje e drejtë edhe e faktorit ekonomik, krahas faktorëve të tjerë që përmendëm më sipër. Po të shohim p.sh. se si janë trajtuar dollapat dhe mësyndrat në mur do të bindemi se ekonominë populli ynë e ka patur gjithmonë parasysh, ndaj i shfrytëzojmë mirë sipërfaqet deri tek shpatullat e dritareve apo parapetet e tyre. Duke i futur ato në mur ai lë një sipërfaqe të pastër të ambientit ku mund të sistemohen pajisjet e tjera të domosdoshme. Shpesh vendosja e dallapeve në mur zë një front unik dhe shfrytëzojnë në lartësi gjithë sipërfaqen e një faqe muri, që që ka edhe vlera estetike. Në këtë drejtim ne projektuesve na mbetet shumë për të bërë. Duhet të përkrahemi edhe nga zbatuesit, ndërkaq ndërmarrjeve të prodhimit të mobilisë duhet t'u vlejë në sishembull që të shfrytëzojnë këto veti të vendosjes frontale për të dhënë mobilje më të mira e më të lira.

Nga veçoritë e traditës sonë, nuk mund të mos përmendim atë që në gjithë veprimtarinë e tij mjeshtri popullor ka patur parasysh t'i shërbej njerëzve. Çdo gjë, që nga përpunimi i mendimit, nga konceptimi i zgjidhjes deri ke proporcionet, përmasat, format, volumet, materialet, strukturat, detajet etj., i ka zhvilluar në dobi të tij, për të plotësuar nevojat dhe shijet e njerëzve, për t'i lidhur ata me prodhimin e jetën shoqërore e jo për t'i coroditur, për t'i krijuar iluzionet të reme, siç përpigjen të mashtrajnë popujt me anë të arkitekturës kozmopolite moderniste ideologjia borgjeze e revizioniste.

Në vazhdim të traditës ne kemi arritur rezultate të mira sidomos në trajtimin e apartamenteve të

(vijon në f. 13)



Ndërtime në Kukësin e Ri.

Veçori të traditës sonë

(vijon nga f. 7)

banimit. Kriteret bazë për projektimet e tyre, i përgjigjen mënyrës së jetesës, përbërjes familjare, kërkesave dhe shijes së popullit, të diktuara nga zhvillimi shoqëror e ekonomik i ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Kështu, përbërja e apartamenteve tona, kryesisht, në një e dy dhoma e kuzhinë i përgjigjet përbërjeve familjare të familjes sonë të re. Dhomat e ditës ose kuzhinat, siç thotë populli, kanë madhësi të mjaftueshme për të zhvilluar në to funksionet bazë të banimit, ngrënies, pushimit, studimit, pritjes së miqve etj. Pajisja e saj me anekstet, me çirroi atë nga procesi i gatimit dhe e bëri më të qetë e më të përshtatshme. Dhomat e gjumit kanë madhësi dhe forma të përshtatshme, lidhje të drejtë funksionale të pavarur nga njëra-tjetra. Ato janë të lidhura me korridorin, i cili në vetvete është edhe ambient i parë prezantues, ku kryhen edhe funksione të tjera, ndaj përmasat dhe format e tyre rreth katrorit janë më të preferuara. Zgjidhja e banjës është detyruesisht me dritë e ventilim direkt dhe përmes optimit për funksionin e saj. Apartamentet pajisen me llojë apo balkon, të cilat e lidhin atë me ambientin e jashtëm që përkon me traditën tonë; me çardaqet, hajajat etj.

Rastet kur ndërtimet janë kryer jashtë këtyre kriterëve bazë, si përdorimi i kuzhinave të vogla, dhomat e gjumit me forma e madhësi të papërshtatshme ose kur zgjidhja e tyre është bërë me dhoma kaluese ku banjot nuk kanë patur dritë e ventilim direkt, ose apartamentet nuk kanë patur depo, kur ndërtimi i tyre është bërë mbi 5 kate etj., nuk na kanë dhënë rezultate e ato janë kritikuar me të drejtë nga populli dhe koha i ka rrëzuar.

VALENTINA PISTOLI

(vijon nga faqja 1)

si, duke venë theksin në të metat e tyre, vunë në dukje se goftë aktorët apo regjisorët, goftë dhe shokët e drejtorisë duhet të bëjnë shumë për të ngritur në një shkallë të re kritikën e shfaqjeve, të sigurojnë vazhdimisht mendimin e masave. Gjithashtu, u tha në mbledhje, duhet të dalë nga prapambetja edhe puna për përvetësimin e përvojës artistike të trupave, regjisorëve dhe aktorëve në t'johur brenda një kolektivi dhe estradave të tjera në rrethet. Por, njëkohësisht, ata me të drejtë theksuan se për të tilla çështje edhe shtypi ynë, sidomos ai letrar-artistik, duhet të shkruajë më me seriozitet dhe jo vetëm brenda llojit të kritikës recensionele. Kemi kaq aktorë të talentuar në estradat tona. Disa prej tyre edhe të nderuar me titujt e lartë «Artist i Popullit» apo «Artist i merituar». Po cila është përvoja e tyre ideo-artistike? Kontributi i tyre në mjeshtërinë e aktorit? Të folurit skenik? Përvoja e tyre për një lojë realiste e me karakter kombëtar e popullor? Për këto duhet folur e shkruar më shumë.

Duke nxjerrë mësim nga tradita, ne përforcojmë mendimin tonë të zhvillimit të standartizimit e tipizimit në dy drejtime kryesore. E para, me tipa mund të forcohet karakteri kombëtar dhe nuk është e vërtetë që monotonia e uniformiteti janë produkt i tipizimit dhe standartizimit. Kjo përforcohet po të analizojmë drejt e thellë banesat beratase, gjirokastro, shkodrane, tiranase, korçare etj., të cilat megjithëse janë të shumëllojshme e kanë bazën në disa banesa tipe të diktuara nga plotësimi i nevojave utilitare, nga mënyra e jetesës, nga zakonet që i ka diktuara zhvillimi shoqëror e ekonomik popullit tonë. Shumëllojshmëria e tyre është fryt i aftësive krijuese të mjeshtrove tanë popullorë, që kanë ditur dhe mundur t'ia përshtasin këto tipe vendit, terrenit, klimës, ambientit, materialit etj.

Ne na mbetet shumë për të bërë në drejtim të zgjidhjeve planimetrike e volumore, e sidomos në drejtim të shprehjes arkitektonike të pamjeve të lidhura ngushtë me vendin, relievin, klimën e vendit tonë.

Dhe e dyta, vetëm duke njo-hur mirë kushtet konkrete të vendit - mundësitë tekniko-materiale, duke u futur thellë në jetën e gjallë të popullit për ta njohur nga afër atë, duke zhvilluar më tej vijën e masave, duke u njohur dhe frymëzuar nga thesari i pacmuar i traditës sonë popullore dhe asaj gjatë viteve të pushtetit popullor, që i ndrojo faqen atdhet tonë, mbështetur në përparimin shkencor që është arritur, do të forcojmë karakterin kombëtar të arkitekturës, fuzionimin dhe stilin popullor në unitet me përmbajtjen socialiste, vetëm kështu do të zhvillojmë në një stad më të lartë arkitekturën.

Të gjitha këto, e shumë çështje të tilla, janë me shumë interes për rritjen dhe kualifikimin e mjetshëm të krejt masës së aktorëve tanë profesionistë e amatorë.

Në diskutim u shkëmbyen mendime edhe për probleme të tjera si për organizimin më të mirë të punës, për forcimin e unitetit artistik të krijuesit, regjisorit dhe trupës, për figurën morale të artistit, për forcimin e bashkëpunimit me lëvizjen amatore në fshat e qytet, për punën më të madhe të sektorit të muzikës, veçanërisht për një trajtim më të madh të këngës e të valles popullore në estradë etj. Në diskutim u theksua se estrada profesioniste e qytetit të Durrësit nën udhëheqjen e organizatës-bazë të Partisë, duke e bërë problemin e hopit cilësor problem të krijuesve dhe të trupës, duke nxitur dhe inkurajuar iniciativën dhe duke përfunduar shembullin e më të mirëve, do të punojë që të japë në kuadrin e 35-vjetorit të themelimit të Partisë premiera aktuale e që të militojnë fuqimisht në edukimin e masave tona punonjëse.

Korresp. i «Dritës»

(vijon nga f. 2)

ndjekim shembullin e më të mirëve, siç është brigada-flamur e Servet Çauhallarit në Senisht. Do të zbatojmë shkencën bujqësore: bimët duhen mbjellë në rreshta dhe të sigurohet numri i tyre për hektar; duhen plehruar dhe prashitur. Pastaj, farërat duhen zgjedhur.

Komunistët janë në krye të kësaj pune. Brigada e komunistit Skënder Gozdari në Lozhan është brigadë e rendimenteve të larta. Ajo ka marrë gati katër quintalë për hektar grurë më shumë se mesatarja e kooperativës. Kooperativistët punonin dhe këndonin këto ditë. Në kooperativë është përhapur kënga e vajzave të Gribecit:

T'u ngjitemi maleve, të mbuluar me gurë,
T'i kthejmë në ara, të prodhojmë
Të prodhojmë bukën ne në vendin tonë,
Të prishim bllokadin që na imponojnë.

* * *

Etja për mësim, për dije e go-rarëve, ka qenë e madhe. Ata nuk kishin bukë për të ngrënë, por donin të mësonin, të lexonin e të shkruanin gjuhën e tyre, se ishin atdhetarë. Shkonin në kurbet në vendet e Ballkanit dhe që andej, brenda torbave, sillnin abetarët shqipe që botoheshin jashtë. Më 1918 hapën në Lozhan shkollën e parë. Por jo ata e saj nuk ishte e gjatë. Hapu sota e mbyllu nesër. Kështu kaloi jeta, kështu u endën së kotë përpjekjet e bëra atëherë, gjersa erdhi dita e Çlirimit të vërtetë të Atdheut, gjersa kudo shkëlqeu dielli i Partisë.

Shkollat tani i ke në çdo fshat. Në Strelcë dhe në Moçan ngrihen ndërtesat e reja të 8-vjeçareve, me klasa kabinet, lobaratore të fizikës e të kimisë, me mjetet të tjera mësimore-educative, ashtu si i gjen dhe në shkollat e qytetit.

Drejtori i shkollës së Zvarishtit, Pellumb Lipo, na tha:

- Në të 17 fshatrat e krahinës ka sot shkolla të ciklit të ulët, 5 tetëvjeçare dhe një shkollë të mesme pa shkëputje nga puna. Në to mësojnë afro 2000 nxënës dhe japin mësim 68 mësues, kurse para Çlirimit në gjithë Gorën vinin në shkollë 20-25 nxënës. Në fshat kemi edhe arsimin parashkollor, vatra kulturore. 3.200 go-rarë kanë mbaruar arsimin 8-vjeçar. 180 kuadro tona janë me arsim të mesmë, kurse 60, si mjekë, agronomë, ekonomistë e të tjerë, kanë mbaruar shkollat e arsimit të lartë dhe shërbejnë brenda dhe jashtë krahinës.

Hymë në spitalin e Lozhanit, i cili që në pragun e tij na tërhoqi vëmendjen dhe na la mbresa për pastërtinë, rregullin dhe me kushtet e tjera që ka për shtrimin dhe mjekimin e të sëmurëve. Gorarët mburren me spitalin e tyre, me mjekët dhe punonjësit e tjerë të shëndetësisë, që u shërbejnë.

Gorë, 1976

Në korridor gjetëm disa kooperativistë, burra dhe gra.

Një grua na tha: - Tani doktorin e kemi në prag të shtëpisë. Mamitë dhe infermieret në fshat. Sot nuk shkon më njeriu për hig gjë, për dhjamë qeni, kur i thonë fjalës.

U hap dera e ambulancës, një grua me një fëmijë në krah doli fytyrëçelur. Kooperativistët e tjerë, me radhë kaluan te mjeku dhe te pediatreja.

- Do të më falni pak, - na tha doktori.

Si mbaroi ekzaminimet, mjeku Enver Muço, drejtor i spitalit, erdhi e ushtrua në bisedë me ne plot ngrohtësi. Djalë i ri, i ciltër dhe i ëmbël në bisedë. Ai na tregoi, ndër të tjera, për realizimin e ëndrrës së tij që të bëhej mjek.

- Kur isha i vogël në fshat, - tregoi, - kur shikoja ndonjë që vritej në punë a ndonjë të sëmurë, thosha me vete: «Do të bëhem doktor, t'i shëroj njerëzit». Dhe ëndrra ime, siç e shikoni, u plotësua. Studjova me bursë të shtetit. Tani kam për detyrë t'ia shpërblej me punë Partisë dhe popullit.

Ëndrra e mjekut Enver Muço u plotësua. Ashtu si u plotësuan ëndrrat e gjithë gorarëve. Nga krahina kanë dalë ose janë duke studjuar për mjekë më shumë se 10 mijë të krahinës. Jo. Shëndeti dhe jeta e fshatarit sot nuk është lënë në mes të katër udhëve, si ndodhte dikur. Për shëndetin dhe jetën e masave punonjëse kujdesen Partia dhe qeveria. Qëllimi më i lartë i shoqërisë sonë është njeriu ynë i ri, mirëqenia dhe lumturia e tij.

«NE JEMI NE KEMBE...»

Veterani i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Hekuran Tai-pi, na foli plot gjallëri dhe me zë të fortë:

- I shikoni këto maja e këta rripa! Eh, shumë herë janë mbushur me luftëtarë! Por baballarët na thoshin: «Kemi luftuar e kemi luftuar, por hair nuk kemi parë». Hairin ata dhe ne e pamë vetëm kur lindi Partia. Luftuam e derdhëm gjak, vërtet, po situam pushtetin e punëtorëve e të fshatarëve. Prandaj jemi në këmbë të gjithë me veteranët, të rinjtë dhe fëmijët. Syrin në shënjestrë dhe gishtin në këmbëzën e pushkës.

Në malet e larta të Gorës, që ngrihen si kështjella të përjetshme e të pakapërcyeshme për armiqët, pamë edhe të rinj e të reja, burra e gra, që, krahas punëve bujqësore, mësonin dhe stërviteshin ushtarakisht për të qenë gati dhe për t'i dhënë përgjigjen e duhur, për t'i tretur plumb në gojë, çdo armiku ngado që të vijë. Sytë e tyre thoshin: «Askujt nuk i lejojmë të na cënojnë lumturinë. Ne do të punojmë dhe do të kalitemi që ta rritim dhe ta mbrojmë lumturinë tonë».

Gora bujare, trime dhe luftëtare hedh tani hapin e saj gjithmonë e më të madh në rrugën e gjerë të socializmit tonë fitimtar.

ANDON MARA

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Mbi karakterin klasor në arkitekturë dhe urbanistikë

Maksim Mitrojergji - arkitekt

Arkitektura, si teknikë dhe art, është një nga fushat e aktivitetit njerëzor ku gërshtohen probleme të shumta, duke filluar nga ato teknike dhe ekonomike, estetike dhe artistike e deri tek problemet sociologjike dhe ekologjike 1). Kjo sferë e gjërë e veprimit të arkitekturës i jep asaj një karakter të theksuar klasor.

Sisteme të ndryshme shoqërore, në përputhje me kushtet konkrete të zhvillimit shoqëror e tekniko - shkencor, kanë përpunuar dhe krijuar gjuhën e tyre arkitektonike, e cila ka shprehur e shpreh qartë ideologjinë e klasave në fuqi.

Shoku Enver ka thënë se çdo krijim në çfarëdo epoke, është bërë me tendencë, i frymëzuar nga idetë e kohës, nga gjendja shoqërore e asaj epoke.

Përmbajtja socialiste në veprat e arkitekturës dhe urbanistikës tek ne spikat, në mënyrë të qartë, në interpretimin që i bëhet realitetit tonë objektiv, ndërtimit të shoqërisë socialiste dhe edukimit të njeriut të ri. Në analogji me procesin e zgjedhjes dhe përcaktimit të temës, karakteristike e shumë llojeve të artit, dhe tipologjia e objekteve që ndërtohen sot tek ne flet për një përmbajtje të re socialiste të arkitekturës dhe urbanistikës sonë. Qytetet e rinj industriale, ansamblet e banimit, fshatrat e rinj, shumëllojshmëria dhe numri i madh i objekteve kulturore, shëndetësore, arsimorë, të pushimit, të shërbimeve dhe industriale etj, janë dëshmi të kësaj përmbajtjeje. Kjo tipologji e re tregon se arkitektura jonë është vënë në shërbim të masave të gjëra punonjëse, se janë masat ato që i ndërtojnë dhe i shfrytëzojnë gjithë objektet që ndërtohen.

Me rëndësi të veçantë në arkitekturë është gjetja dhe përpunimi i gjuhës arkitektonike, pra i elementëve të formës me qëllim që të materializohet sa më mirë përmbajtja e re socialiste në veprë, mbasi për vetë karakterin e tyre masiv veprat e arkitek-

turës ndikojnë aktivisht mbi popullin, duke i transmetuar atij tendenciozitetin klasor të përmbajtjes së tyre.

Forma arkitektonike, si mënyrë e organizimit të elementëve arkitektonike, është dhe mënyra e lidhjes së këtyre elementëve me përmbajtjen e re. Në këtë drejtim rruga e vetme që kanë ndjekur e ndjekin projektuesit tanë është ajo e njohjes, studimit dhe përpunimit të formave të arkitekturës sonë kombëtare. Kështu arrijmë në krijimin e elementeve të reja në përshatje me idealet e njeriut tonë të ri dhe nivelin e sotëm tekniko-shkencor.

Forma kombëtare nuk duhet kërkuar vetëm në elementët formalë të dekorit, të trashëguara nga e kaluara, por, para së gjithash në konceptet dhe mendimin përparimtar të popullit tonë, që i krijoi dhe i pasuroi ato vazhdimisht, duhen kërkuar në atë

filozofi të popullit që ndikon në vetë ruajtjen e pastër të kulturës sonë, të zakoneve tona, mënyrës së jetesës. Ajo duhet kërkuar para së gjithash edhe në konceptet që kanë udhëhequr popullin tonë në organizimin e hapësirave të jashtme në qytete e, nëpërmjet këtyre hapësirave, në organizimin e jetës së banorëve në qytet. Këtu mund të dallojmë në mes shumë karakteristikash të tjera karakterin laik të qëndrave të qyteteve tanë të vjetër, kompozimin e ngjeshur urbanistik dhe trajtimin me kurimsim të tokës, dashurinë për natyrën dhe peisazhin e vendlindjes etj.

Estetët dhe kritikët borgjezë, të fushës së arkitekturës, mundohen t'i mohojnë asaj karakterin klasor. Ata analizojnë stilet e nënstylet e epokave të ndryshme historike, raportet midis njëri - tjetrit dhe kushtet e faktorët teknikë dhe estetikë që i lindën, duke folur pak ose aspak për kushtet ekonomiko - shoqërore. Rrallë herë ata analizojnë raportin e stileve zyrtare të epokave të ndryshme me arkitekturën popullore. P.sh., flitet shumë për pallatet mbretërore, për bukuritë dhe madhësitë e tyre, por pothuajse aspak për banesën popullore masive. Kjo bëhet jo pa qëllim, sepse, në kontrastin e madh të mënyrës së jetesës së shtresave të ndryshme të shoqërisë, pasqyrohen kontradiktat e thella të vetë asaj shoqërie.

Kritika borgjeze mundohet të unifikojë gjuhën e folur me gjuhën arkitektonike dhe në përgjithësi me arkitekturën. Nëpërmjet këtij krahasimi dhe unifikimi ajo mundohet ta servirojë arkitekturën bashkëkohore si vepërimitari jashtë çdo superstrukture shoqërore, t'i heqë asaj karakterin klasor.

Të gjitha këto manovrimë bë-

hen nga kritikët borgjezë me qëllim që të fshehin njollat e shoqërisë së sotme kapitaliste që reflektohen dhe në krijimtarinë ndërtimore, ku spikat karakteri i theksuar i reklamës dhe konkurrencës kapitaliste; kontrasti i theksuar qendër-periferi në qytete dhe mbipopullimi i tyre, kushtet e këqija higjieno - sanitare dhe ndotja e ambientit, individualizmi dhe tektet e miliardëve, «izmat» dhe modat e ndryshme të artit dhe arkitekturës me bazë filozofike idealizmin, ku qëllimi i arkitektit është fitimi.

Rrugë tjetër ndjek arkitektura jonë e re e cila, në luftë të vazhdueshme me influencat e huaja dekadente borgjezo-revizioniste, mbështetet fuqimisht në trashëgiminë e pasur të popullit tonë. Kjo mbështetje, në radhë të parë, mbizotëron në metodën e punës për ta thelluar sa më shumë karakterin kombëtar në drejtim të një pune kolektive që t'i nënshtrohet gjykimit të masave. Monumentet e mrekullueshme arkitektonike, që kemi trashëgim nga e kaluara, nuk janë pjellë e mendjes së një njeriu, por fryt i përpjekjeve krijuese të një populli, sepse vetëm arkitektura popullore ka krijuar vepra të tilla të bukura, të larmishme, origjinale, vazhdimisht në ndryshim e në progres, simbolike e të kuptueshme për popullin, se flasin për jetën, luftën e aspiratat e tij.

Duke u mbështetur në këto tradita të shëndosha të së kaluarës dhe eksperiencën tonë 32 - vjeçare, duke ruajtur gjithmonë tendenciozitetin klasor, arkitektët do të krijojnë vepra në të denja për popullin tonë edhe në të ardhshmen.

1) Ekologjia - shkencë që studion raportet e njeriut me ambientin natyror dhe ruajtjen e këtij ambienti.



Ndërtime të reja në Vlorë

(Foto: S. Xh. Kaba)

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Përdorimi i gurit

në ndërtimet tona

Taqo Mibo — specialist ndërtimi

Karakteristikë në ndërtimet tona është edhe përdorimi i tij në forma e dimensioneve të ndryshme dhe vendosja jo vetëm si material ndërtimi, por edhe për efekt arkitektonik, në shumë qytete si Gjirokastër, Berat, Korçë, Sarandë etj., ka bërë të realizohen ndërtime të mrekullueshme. Edhe si material veshës guri ka gjetur një fushë të gjerë përdorimi në objektet social-kulturore, duke u dhënë atyre një pamje më të bukur dhe kombëtare.

Në përgjithësi, veshjet prej guri shkojnë shumë me ambientin rrethues të ndërtimeve. Në mënyrë të veçantë në vendin tonë, me natyrë malore e plot gjelbërim, kjo është më se e përshtatshme. Guri gjendet me bollëk pothuaj në çdo vend dhe me cilësi të mirë, me ngjyra të ndryshme nga më të bukurat.

Po të kemi parasysh porosinë e Partisë e të shokut Enver, që të

përdorim sa më shumë materiale tradicionale të vendit dhe të ruajmë e zhvillojmë traditat tona të mira, duhet të themi se përvoja i përket përdorimit të gurit për veshje e dekoracion në ndërtim, ka shumë për të bërë, mbasi veshjet me gurë janë akoma të pakta.

Kohët e fundit janë bërë disa veshje me gurë në ndërtime të ndryshme si në Galerinë e Arteve në Tiranë etj. Një shembull i mirë i përdorimit të gurit është edhe ndërtesa e Komitetit të Partisë në Tiranë projektuar nga arkitektja N. Mitrojorgji. Qysh në shikimin e parë ky objekt të jep idenë e një muri me gurë të punuar nga mjeshttrat popullore gjirokastritë, mbasi këtu, ashtu si në ndërtimet e Gjirokastrës, gurin ngado që ta shohësh krijon rreshta horizontale. Kjo lloj veshje jo vetëm që është pëlqyer shumë nga populli, por shkrihet mjaft hijshëm me ambientin rrethues dhe i jep ndërtesës një fytyrë më të qartë kombëtare. Përvoja i përket veshjeve me gurë du-

het patur parasysh që të kalohet edhe në trajtime artistike, duke përdorur motive të krijuara nga mjeshtrit tanë popullore. Kuptohet që këto motive nuk do të merren shablon, por të trajtohen dhe të stilizohen duke ruajtur gjithmonë tiparet kombëtare të tyre. Edhe përvoja i përket kostos veshjet prej guri nuk shkon në më shumë se sa veshjet e tjerë, bile, me industrializimin e prerjes dhe skuadrimit të tyre, ato kushtojnë edhe më lirë.

Veshjet me gurë duhet të zënë vend më mirë në kokolaturat, në fasadat e përparme apo anësore, si veshje zbukurimi në ambientet e brendshme, si veshje kolonash të kateve të para etj. Përvoja i përket fortësisë, këto veshje, janë shumë më të rezistueshme kundrejt agjentëve atmosferikë. Veshjet me gurë duhet të përdoren më gjerë në ndërtimet e ndryshme social-kulturore, sidomos në shtëpitë muze etj. Ato luajnë rol më rëndësor dhe në përmbajtjen e vetë godinës. Për shembull, në muzeumin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare jepet rasti të përdoret gur masiv, në formë blloqesh të mëdhenj, jo vetëm si funksion veshës, por edhe mbajtës, duke pasqyruar kështu në këtë ndërtim, madhësinë e maleve tona legjendare që kanë qenë çerdhe e luftrave të lavdishme për liri e pavarësi. Me përdorimin e gurit, po të mbështetemi më thellë në traditën kombëtare të arkitekturës sonë, mund të ndërtojmë godina mjaft të bukura e dinjitoze. Për këtë duhet që kompozimet të mos jenë shablone, të përsëritura e monotone, por të bëhen sa më të ndryshme dhe me variacione, sepse ka patur edhe ndonjë rast që është bërë vendosja e njëllotjeve të gurit. Po të studjohen ndërtimet tona me gur, sidomos në Gjirokastër, gjen shumë kompozime të bukura e origjinale me karakter kombëtar e krejt ndryshe nga njëri-

tjetri. Mbështetur në këto motive kombëtare, në punimin e përdorimit të gurit, mund të krijojmë kompozime të reja e shumë më të bukura.

Gurë të përshtatshëm ndërtimi për veshje e dekoracione gjenden në mjaft qytete të vendit tonë. Kështu, vendburime të mira kemi në Gjirokastër, Sarandë, Ura Vajgurore, Berat, në Shtyllë të Korçës, në Rubik etj. Bile, edhe në Tiranë, në malin e Dajtit, gjendet gur që del në shtresa dhe që mund të punohet mirë për t'u përdorur për veshje ndërtimesh. Të gjithë këta gurë janë shumë të mirë dhe punohen me lehtësi.

Për punimin dhe përdorimin më të gjerë të gurit, për veshje dhe dekoracione, duhet të kemi parasysh dhe anë të tjera. Së pari, mjaft nga mjeshttrat e talentuar që na kanë dhënë vepra të bukura janë në moshë të vjetër, prandaj lipset që këtë lloj zanati ta ripërtërijmë në specialistë më të rinj. Një shembull i mirë në këtë drejtim është grupi i mjeshtreve të Korçës, që ka përgatitur një grup tjetër mjeshtresh më të rinj.

Njëkohësisht, projektuesit duhet të parashikojnë në projektet e tyre më shumë variante veshjesh me gurë dhe të bashkëpunojnë më ngushtë me specialistët e zbatimit për të realizuar variante të mira për ndërtim.

Industrializimi i prerjes sipas dimensioneve e llojeve të ndryshme të gurit dhe skuadrimit i tij, ka rëndësi tjetër të madhe, sepse shkurton në mënyrë të ndjeshme punën e krahut, që nevojitet për gdhëndje dhe që kërkon shumë kohë. Nga ana tjetër kjo shpie në uljen e kostos së veshjeve. Jam i mendimit se guri në funksion veshës ka mundësi të bëhet një nga materialet kryesore në ndërtimet tona të arkitekturës për anë e shumta pozitive që ka ai kundrejt shumë materialeve të tjera me natyrë artificiale që përdoren për këtë qëllim.



Përmeti në ditët tona

(Foto: A. Dhimitri)

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Qyteti, urbanistika dhe gjelbërimi

Një ndër elementët e arkitekturës dhe të urbanistikës është pa dyshim edhe gjelbërimi, ku bëjnë pjesë sipërfaqet e gjelbërta, parqet e lulishtet etj. të cilat ndërtohen në bazë të parimeve të caktuara arkitektonike. Po të sodisim me vëmendje dhe kujdes panoramën e të gjithë qyteteve dhe qendrave tona të banuara, ku më shumë e ku më pak, është trashëguar një bukurri e rrallë natyrore e përbërë nga drurë, shkurre dhe lule dekorative. Vendi ynë, dikur me qytete që karakterizoheshin me rrugë e rrugica me kallëdrim, të ngushta e të shtrembura, me kanale të ujërave sipërfaqësor (rema), godina banimi një-dy katëshe dhe, aty-këtu, me një ombrellë të gjelbërt, që ia jepnin disa drurë, ka ndrruar plotësisht pamjen në vitet e Partisë nëpërmjet ndërtimit të qyteteve të rinj dhe zgjerimit të atyre ekzistuese me rrugë e trotuare të drejta e të asfaltuara, me kanalizime, me pallate banimi të rehatshme e komode dhe me një rrjet gjelbërimi, rrugë, parqe e lulishte që ia kanë rritur mjaft bukurinë qendrave të banuara. Këto elemente të domosdoshëm arkitektonikë, dora e talentuar e popullit tonë jo vetëm nuk i ka harruar, por, përkundrazi, me interesimin direkt të Partisë e pushtetit popullor e ka shtrirë akoma më tej, duke ndërtuar gjatë këtyre 30 e ca vjetëve qindra mijëra m² sipërfaqe të gjelbëruara. Dhe kjo jo pa arsye. Dihet nga të gjithë se këto sipërfaqe kanë rëndësi të madhe goftë për estetikën e një qyteti, goftë edhe për rolin e madh higjieno-sanitar, përmirësimin e konditave mikro-klimaterike, pastimin e ajrit nga pluhuri dhe gazërat e industrisë, pakësimin të zhurmës etj.

Pra, në një drejtim diametralisht të kundërt me konceptet estetike borgjeze në arkitekturë dhe me praktiken e ndërtimeve në përgjithësi në qytetet e botës imperialiste, ku kryesisht zotërojnë ndërtesat që gryejnë qiellin, blloqe të tëra të ngjeshura në qendër e lagjet e vjetra në periferi, pa asnjë kujdes për gjelbërimin, sidomos në ambientet me një përdorim më të gjerë publik, tradita onë popullore dhe ajo e arkitekturës së këtyre 30 vjetëve ka arthur dhe po vjen gjithnjë duke pasuruar. Për t'u përmendur anë p.sh. parqet e çlodhjes të Tiranës, Korçës etj., disa blloqe banimi të gjelbëruara e me lulishte si në Vlorë, Pogradec, Elbasan e gjetkë, këndet e lodrave të gjelbëruara për fëmijë në isa rrethe të vendit etj. Me gjithë sukseset e mëdha të rritura në këtë drejtim, është eëndi që të vemë në dukje të metat e të japim disa mendime rreth etij problemi, për gërshetimin a më mirë të gjelbërimit me traktën e ndërtimit të popullit tonë, e kuadrin e këtij diskutimi të

çelur në gazetën «Drita». Arkitektët dhe urbanistët tanë, krahas hartimit të veprave dinjitoze për një sërë objektesh social-kulturore, hotele, pallate banimi, qendra qytetesh etj., kanë kontribuar deri diku edhe në fushën e ndërtimit të sipërfaqeve të gjelbërta, veçanërisht përsa i takon planizimit të tyre gjatë projekteve të veprave arkitektonike dhe urbanistike. Por duke e parë problemin e gjelbërimit si të dorës së dytë, vihet re se këta në disa raste këtë element arkitektonik e kanë shfrytëzuar thjesht për të harmonizuar ndonjë zgjidhje të shkëputur ose pjesore të studimit të objektit të ndërtimit dhe nuk janë thelluar në ligjet e arkitekturës peizazhiste. Në studimin për hartimin e planeve rregulluese të qyteteve tona, është e vërtetë se projektuesit kanë vendosur «njolla» të jeshilta, ku tregohen sipërfaqet e gjelbërta që do të kenë në të ardhshmen qendrat e banuara, por se në ç'raport me sipërfaqen në tërësi të qytetit dhe me numrin e popullatës në vecatit, nuk është pasur parasysh gjithmonë drejt planizimi i tij. Arti peizazhist ka parasysh disa parime në planizimin e tij dhe që mvaren nga struktura e qendrës së banuar, (këtu është fjala nëse qyteti është i përbërë nga godina të ulta një ose dy katëshe, ose godina me shumë kate) nga numri i ndërmarrjeve industriale, si dhe nga shkalla e dëmit që i shkaktajnë këto ndërmarrje pastërtisë së atmosferës në qytet, nga faktoret natyralë të disfavorshëm (si

p.sh. vapë e madhe gjatë verës dhe ngrica e erëra të forta etj. në dimër), nga reliefi i terrenit ku është ndërtuar qendra e banuar «nëse është i sheshtë, i valëzuar ose i thyer», nga popullsia dhe madhësia e qytetit etj. Në bazë të këtyre të dhënave mund dhe duhej të planizohej gjithnjë drejt nga urbanistët sipërfaqja e përgjithshme e gjelbërimit për qytetet tona. Gjatë studimeve urbanistike për qendrat tona të banuara, merr rëndësi të veçantë sidomos vendosja e sipërfaqeve të gjelbërta. Kjo vendosje mund të jetë në brendësi të qendrës së banuar, ku zakonisht parashikohen qoshkat dhe kopshtet e ardhshme të qyteteve, në anë apo përreth saj, si dhe në afërsi të qendrës së banuar. Për këtë të fundit fjala është për parqet e mëdha të kulturës e çlodhjes dhe pyjet-parqe. Deri tani bie në sy më tepër në qytetet tona ndërtimi vetëm i qoshkave në këtë drjetim është puna e mirë që është bërë për parkun e madh të kulturës e të çlodhjes të kryeqytetit dhe atë të qytetit të Korçës, të cilët po plotësojnë më së miri kushtet për një pushim dhe çlodhje në këtë ambient. Përsa i takon qyteteve të tjera, ende pritet që të punohet për ngritjen e tyre, duke u ndihmuar nga arkitektët dhe urbanistët. Në qytetin e Elbasanit, fjala vjen, është punuar vite të tëra për ndërtimin e parkut popullor, ndërsa brenda një periudhe të shkurtër në teritorin e tij u vendosën godina, nën pretekstin se plani rregullues e parashikon parkun e ardhshëm në një vend tjetër. Atëhere shtrojmë pyetjen: a është i përshtatshëm ai vend që parashikohet në planin rregullues për park kulturor e çlodhje në një kohë që sot ai është i okupuar me ndërtime dhe ku struktura e tokës është e atillë që për ta kthyer në park do të nevojiteshin disa qindra mijëra lekë? Ky shembull tregon më së miri për mosnjohjen nga afër të terrenit nga ana e specia-


listëve që në raste të tilla projektet i bëjnë direkt nga zyra e projektimit.

Dicka tjetër që bie në sy sot në disa qytete është edhe raportin jo i drejtë që ekziston ndërmjet shëtitoreve dhe trotuareve nga njëra anë, me sipërfaqet e gjelbërta nga ana tjetër. Kjo, për mendimin tonë, nuk është parë me syrin e perspektivës. Pothuajse në të gjitha qytetet tona, ku më shumë e ku më pak, gjerësia e trotuareve është e tillë që nuk lejon këmbimin e dy çifteve kalimtarë. Kështu p.sh. shëtitorja kryesore e qytetit të Elbasanit nuk ka gjerësi më tepër se 13 m. trotuaret nga 3 m, ndërsa vija e gjelbërt 8 m! Kjo zgjidhje ndoshta i përgjigjet qytetit atëhere, kur ai kishte një popullatë relativisht të vogël, por sot kur qyteti është rritur gati 2-3 herë ndihet puna e pa studjuar dhe pa perspektivë që është kryer nga ana e urbanistëve. A nuk do të ishte me vend që një zgjidhje e tillë të ishte më e studjuar, pas gjerësisë së shëtitoreve, të vinte gjersia prej 5 m. a më shumë e trotuareve dhe mandej një rrip gjelbërimi, për të kryer efektin estetik në përputhje me zgjidhjen funksionale të të gjithë ansamblit të shëtitores? Mendojmë se po. Kjo e metë vërehet edhe në disa qytete të tjera të vendit tonë, ku gjelbërimi është vendosur në mënyrë të tillë që pengon qarkullimin lirisht të njeriut dhe nuk kryen si duhet efektin për të cilin vendoset dhe ndërtohet.

Monotoni është shkaktuar edhe përsa i takon vendosjeve të shiritave të gjelbërt nëpër rrugët e pallate banimi në disa qytete dhe pak përpjekje është bërë për të krijuar një larmi në përputhje me natyrën specifike të çdo qyteti. Le të marrim fjala vjen dy qytete nga më të rinjtë siç janë Fieri e Lushnja, ku janë vendosur në mënyrë të cunguar dhe të shkëputur midis shëtitores dhe

LIGOR SQAPI
AGIM GARIBOLLI
inxhinierë gjelbërimi, Elbasan

(vijon në f. 11)



Pamje nga qyteti i Elbasanit.

(Foto: I. Starja)

ARKIVI YNE

«Përpara furtunës popullore,

s'ka fuqi që të qëndrojë»

Me rastin e 10 Korrikut, ditës së krijimit të Ushtrisë Popullore po ribotojmë, me pak shkurtime, dy shkrime të marrë nga gazeta «Trumbeta çlirimtare», që botohej në ish-qarkun e Vlorës në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Të gjithë për liri!

Lufta e shenjtë popullore që po bëjmë prej kaq vjetësh, për një Shqipëri të lirë dhe demokratike, kundër fashizmit italian në fillim dhe sot kundër nazizmit gjerman dhe reaksionit të ngordhur shqiptar, na ka mësuar të jemi të matur në veprimet tona. Para se të fillojmë një punë, është bërë zakoni të caktojmë një program. Vetëm në këtë mënyrë kemi mundur të fitojmë simpatinë dhe admirimin e gjithë botës liridashëse, që lufton kundër botës së shtypjes dhe të kusarisë, vetëm në këtë mënyrë, zëri i gjakut të derdhur për liri, u dëgjua edhe në qoshen më të fundit të botës. Dhe sot Ushtria Nacionalçlirimtare është në radhë të parë të ushtrive çlirimtare të vendeve të tjerë, që luftojnë kundër barbarëve gjermanë, për triumfin e lirive demokratike.

Ne do të ecim përpara ballëhapur, në punën tonë. Jemi mësuar me rreziqe dhe jemi në gjendje t'i kapërcejmë... Armiqtë tanë le të ulërijnë si çakenjtë. Ne u themi vetëm një gjë: «Përpara furtunës popullore, s'ka fuqi që të qëndrojë». Ata e dinë mirë këtë të vërtetë, e dinë mirë, dinë gjë-

thashtu se dita e hesapeve është e afërme. Mjerë ata që kanë ngjyer duart e tyre me gjak të kulluar! Këlliçi i popullit do t'i shuajë nga vendi ynë. Pse populli sot është në gjendje t'u verë gishtin atyreve që janë mësuar të kërcëjnë valle mbi kurrizin e gjakosur të tij.

Plagët e rënda që na janë hapur nga kjo luftë, nuk na pengojnë. Ashtu si jemi, të plagosur, të djegur, të çveshur, të zbatthur, por me moral të lartë, do të punojmë natë e ditë, pse ky vend i përgjakur kërkon mëkëmbje. Nuk do të ndalemi asnjë minutë, gjaku i martirëve thërret: «Përpara për çlirim popullor». Dhe përpjekjet tona shkojnë gjithnjë përpara... përpara... përpara... Ushtria jonë Nacionalçlirimtare, mburja jonë, rritet për ditë, armiku dhe tradhtarët po shkojnë drejt gremisë, në malet shqiptare zgjidhet qeveria e parë demokratike popullore, me prijësin e saj në krye, shokun Enver Hoxha, kudo dëgjohej zëri i lirisë, Kudo!

«Trumbeta çlirimtare»
Nr. 1, 21 korrik 1944.

Pse u forcua Ushtria

Nacionalçlirimtare?

Ushtria jonë Nacionalçlirimtare, lindi nga populli, për të luftuar zaptuesin fashist, zagarët tradhtarë, dhe për të çliruar Shqipërinë.

Në fillim, kjo ushtri e popullit,

u duk në lëvizje të vogla, pak njerëz të vendosur muarën përsipër detyrën e rëndë, të organizojnë këtë përpjekje, e cila do të shtohet gjithnjë dhe do të bëhet një fuqi e madhe, që do të përqa-

fonte gjithë popullin e ndershëm shqiptar.

Armiqtë e popullit, fashizmi dhe yzmeqarët e tij, s'lanë gjë pa thënë kundër kësaj lëvizjeje popullore. Ata nuk e shihnin me sy të mirë këtë lëvizje, pse kjo lëvizje mbronte interesat e popullit dhe këta zotërinj ishin kundër popullit.

Po si e luftuan armiqtë e popullit. Lëvizjen Nacionalçlirimtare? Ata thoshnin kështu:

«Lëvizja e re popullore, lëvizja e ciliminjve s'ka mjete, ajo s'ka ushtri, ndërsa fashizmi dhe yzmeqarët e tij, kanë ushtri të rregullt dhe të gjitha mjetet.

Lëvizjes së re popullore i mungojnë ushtarakët, mbasi është një lëvizje të rinjsh, pa praktikë». Të gjitha këto ishin të vërteta, armiqët e popullit, në këtë rast, dhe vetëm në këtë rast nuk gënjenin. Po si atëherë mundi Lëvizja Nacionalçlirimtare t'i kalonte të gjitha këto pengesa dhe të bëhej tmerri i zaptuesit dhe i këlyshëve të tij?

Lëvizja Nacionalçlirimtare mori një hov të madh dhe u bë tmerri i armikut, pse politika e saj është e drejtë, mbron interesat e popullit, në luftë kundër armiqve të tij më të pashpirt. Vetëm një lëvizje që bëhet kundër interesave të popullit, nuk rron shumë dhe kjo lëvizje është fashizmi dhe tradhtarët, që kanë armë me shumicë, oficera me praktikë, ushqime dhe çdo mjet tjetër. Vetëm një gjë i mungon kësaj klিকে të ndyrë; mbështetja e popullit. Ja pse fashizmi dhe tradhtarët muarën rrugën e shkatërrimit.

Ushtria Nacionalçlirimtare u forcua, pse është besnike e popullit dhe prandaj populli e ndihmon me çdo gjë, pse është ushtria e tij. Ushtria që lufton me heroizëm të pashoq, për të ngritur, në Shqipëri, një jetë të re, pa zaptues dhe pa dallaveraxhinjë.

Ushtria Nacionalçlirimtare, u forcua sepse u bë mobilizimi i prapavijave, i gjithë popullit, në shërbim të luftës.

Ushtria Nacionalçlirimtare u forcua, pse ata që bëjnë pjesë në të, partizanët trimë, dinë përse luftojnë.

Ushtria Nacionalçlirimtare u forcua, pse ka si pararojë Partinë Komuniste Shqiptare, që jep çdo ditë, në altarin e lirisë, anëtarët e saj më të mirë.

Ushtria Nacionalçlirimtare u forcua, pse diti të formojë në radhët e saj udhëheqësa ushtarakë dhe politikë, të dalë nga lufta dhe të provuar në luftëra, të ngjeshur me një vetmohim të pashoq, pse e duan popullin me gjithë zemër.

Pra, me një ushtri të tillë popullit shqiptar po shkon drejt çlirimit të plotë. Fashizmi dhe tradhtarët dridhen pse ndodhen në buzë të varrit.

Populli i shumëvuaqtur, me armë në dorë, do të shkojë përpara dhe nuk do t'i lëshojë gjersa të mos jetë çliruar krejt.

Popull shqiptar! Bëje akoma më të fortë Ushtrinë tënde, që të futen të gjallë në dhe armiqtë e tu.

Të gjithë dhe me të gjitha kundër fashizmit dhe zagarëve të tij.

Beteja e fundit e lirisë, arritit Bashkë me të arriti dhe Fitorja.

«Trumbeta çlirimtare»
Nr. 6, 6 tetor 1944.

(vijon nga f. 7)

trotuarit copëza me formate arkaike të parcelave gjoja të gjelbërta.

Në ndërtimin e blloqeve të reja të banimit (kuartaleve) është bërë një punë e mirë dhe e lavdërueshme nga ana e arkitektëve dhe urbanistëve sidomos në kryeqytet. Ato kanë krijuar zona krejtësisht të reja me kushte shumë të favorshme për jetën e njeriut dhe kanë justifikuar plotësisht harmonizimin respektiv të godinave, rrugëve dhe gjelbërimit të tyre. Por jo në të gjitha qytetet janë bërë të tilla studime. Kështu p.sh. në qytetin e Elbasanit janë krijuar kuartale të tilla, por ç'ndodh? Godinat e banimit janë vendosur aq afër njëra me tjetrën, sa që aty nuk ka mundësi as të krijosh gjelbërimin e as të vendosish ndonjë kënd lojrash për fëmijë, por përkundrazi janë krijuar paralelizma dhe u mungon në përgjithësi frymëmarrja e kuartalit.

Po kështu, gjatë studimit për hartimin e planeve rregulluese në ndonjë qytet tjetër nuk është patur parasysh një gjë mjaft e domosdoshme për jetën e tij - vendosja e parqeve për argëtimin dhe zbavitjen e fëmijëve që duhet të përfshihen dhe të përcaktohen meodomsos në kuadrin e përgjithshëm të sipërfaqeve të gjelbërta. Zgjidhja e këtij problemi në disa raste është konsideruar thjesht si një problem komunal dhe ndonjëherë vendosja e tyre është kryer nga dëshira e njeriut apo e tjetrit person, si rrjedhim ato janë bërë me sipërfaqe të kufizuar dhe nuk plotësojnë kërkesat sipas moshave të fëmijëve. Mirë do të ishte që këto parqe brenda mundësive që ekzistojnë, të shpërndaheshin në disa pikë të qytetit.

Në vitet e para të pasçlirimit, populli ynë, krahas rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta, ndërmerre herë pas here edhe aksione për pyllëzimin e vendeve të zhveshura në afërsi të qyteteve ose buzë lumenjve me drurë pyjorë. Me kushtet e sotme të krijuara dhe për stadin e zhvillimit, në të cilin ecim, mendojmë se ka ardhur koha që të ndërhyhet për studimin e këtyre vendeve, që nuk i mungon as edhe një qyteti, dhe të shndërrohen ato graduallisht me shpenzime minimale në pyje - parqe, që janë më se të domosdoshëm për jetën e një qyteti. Të tillë kemi p.sh. në periferi të Korçës, Tiranës, Elbasanit etj. Ato do të ndikojnë pa dyshim në përmirësimin e kushteve higjieno - klimaterike të qytetit dhe njëkohësisht do të sigurojnë vend çlodhjeje për masat punonjëse në ditët e pushimit.

Në tërë sipërfaqet e gjelbëruara pranë pallateve, në rrugë, parqe e lulishte, do të ishte mirë, gjithashtu që të zinin më shumë vend bimët dhe lulet tona tradicionale dhe me vlera për funksionin e tyre në aspektet që diskutuam. Ndër to janë p.sh. rrepet, blinj, magnolia, pishat etj. Të përhapim në këtë drejtim përvofën e mirë që vihet re në disa raste në Korçë, Tiranë, Vlorë e gjetkë. Shqiptari e ka patur dhe e ka zakoni: shtëpinë e do fare pranë natyrës, gjelbërimit, hapësirës dhe dritës. Në këtë mënyrë do t'i përgjigjemi më mirë edhe kërkesave të kohës sonë.

LIGOR SQAPI
AGIM GARIBOLI
inxhinierë gjelbërimi, Elbasan

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Dekori në ambientet tona

Pandi Mele, piktor

Sot nuk gjen qytet, fshat, shesh e rrugë deri në koda dhe e male ku të mos zenë vend mjetet figurative, që nga parulla e deri tek pllakati politik, që nga tabelat në emërtimin e rrugëve deri tek tabelat me karakter kulturor e tjerë. Në këtë drejtim, nga viti në vit, janë bërë përparime të dukshme. Me ndryshimet e transformimet socialiste fizionomia e qyteteve e fshatrave është bërë më e plotë dhe e bukur si rezultat i kujdesit që i kushtohet paraqitjes së tyre jo vetëm me anën e arkitekturës dhe urbanistikës, por edhe të dekorit.

Ndryshe nga vendet borgjezo-revizioniste, ku zien një propagandë e ethshme për kapitalin, biznesin, modën, seksin etj., me të cilat çorodisin njeriun, telt ne, në sajë të orientimit e kujdesit të vazhdueshëm të Partisë, mjetet e agjitacionit figurativ në përgjithësi e dekorit në veçanti, janë vënë plotësisht në shërbim të masave punonjëse për formimin e shijeve të shëndosha, për edukimin e tyre ideoestetik.

Në këtë vështrim dekori luan një rol të dyfishtë në karakterin e tij politik e ideologjik dhe utilitar e estetik. Çdo dekor tek ne ka anën e vet funksionale në jetën e përditshme dhe në raste festash. Pra, ai është gjithnjë në zhvillim e sipër e kërkon pasurim të përhershëm. Paraqitja e ideve më të rëndësishme politi-

ke të kohës, zbrëthimi e pasqyrimi i problemeve kardinale që ngre Partia për zhvillimin e gjithanshëm socialist të vendit dhe mbrojtjen e Atdheut janë bosh-tit kryesor i përmbajtjes së saj militante dhe gjithnjë aktuale. Në këtë drejtim rezultate të mira janë arritur kudo, por në mënyrë të veçantë sipkat dekori në qytetin e Shkodrës, Durrësit, Tiranës, Dekore të tilla dëshmojnë për një qëndrim krijues në funksion të zbrëthimit të përmbajtjes. Përveç kësaj në to spikakat aplikimi i gjerë i artit dekorativ dhe kombinimi i drejtë me arkitekturën dhe urbanistikën. (Kujtoni p.sh. vendosjen në fasadat e pallateve në hyrje e në qendër të qytetit të Shkodrës dhe Durrësit, ose disa pika dekori në qendër të Tiranës). Por duhet thënë se në disa qytete të tjera si në Elbasan, Lushnjë, Korçë e gjetkë, për sllakak të mospërdarjes së duhur të dekorit me kritere, janë krijuar pika tepër të ngarkuara që e lodhin kalimtarin e nuk e «thërrasin» atë.

Në rastet më të mira vihet re gjithashtu efekti ideoemocional dhe efekti dekorativ, qartësia, lakonizmi, lexueshmëria, paraqitja, estetika, mënyra e kulturuar, niveli i mirë për realizimin artistik. Kjo tregon se kur merren masat e duhura dhe organizohet mirë puna arrihen edhe rezultate. Një ndër shembujt më të

freshët është dekori i Tiranës për 1 Majin 1976, pa përmendur këtu edhe të gjithë ato dekore të mira në raste ngjarjesh të shënuara apo festash, si ai i qytetit të Shkodrës, kur u zhvillua atje Kongresi i 6-të i BGSF etj. Duke u nisur nga kjo përvojë e mirë duhet ta përhapim dhe ta bëjmë traditë punën tonë të dekorit në qytet e në fshat.

Në fazën e tanishme thellimi i punës për të ngritur në një shkallë më të lartë nivelin ideoartistik të dekorit, përbën një nga problemet themelore. Po cilat janë disa të meta, që duhet t'i evitojmë?

Në përgjithësi ka ende nivel të ulët shpesh diletantesk në kuptimin, aplikimin dhe paraqitjen ideoartistike të dekorit, gjë që nuk i përgjigjet gjithmonë përmbajtjes së lartë që duhet të shprehë. Ka një lloj uniformiteti, mungesë larmie dhe pasurie e mjeteve të shprehjes artistike që shpesh dobëson efektin ideo të përmbajtjes. Jemi të mendimit se kjo vjen nga që kryesisht me problemet e dekorit merren shokë pa ndonjë përgatitje. Ende praktikohet rrallë aktivizimi i artistëve, piktorëve e skulptorëve, sidomos angazhimi i tyre konkret. Por këtu ndikon për të keq edhe ai koncept frenues sipas të cilit, «me punë të dekorit, nuk ka pse të merren ata që kanë mbaruar shkollën e lartë artistike» etj. Kjo ka sjellë që për disa dekore dhe në vendosjen e tyre të ketë cektësi e mungesë fantazie. Nga ana tjetër vihet re se në shumë qytete janë krijuar disa qendra të agjitacionit figurativ që shpesh ngarkohen me shumë materiale, kanë tekste shumë të gjatë e shkronja të vogla, të pallexueshme, që nuk tërheqin vëmendjen e kalimtarit. Në mjaft raste ato nuk kombinohen si duhet me elmetet e arkitekturës, duke mos u harmonizuar me to. Në të kundërtën këto qendra janë më fort mikrokënde që humbasin në hapësirë në vend që të spikasin e të bëjnë efekt në distancë.

Dobësi më të theksuara, sidomos, vihen re në dekorin e fshatit e në disa qendra industriale. Në këtë drejtim mendojmë se është e domosdoshme ndih-

ma nga qyteti për gjallërimin e një dekori për problemet politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturoro-artistike të ditës. Grupe piktorësh, urbanistësh (e pse jo?) edhe me arkitektë në përbërjen e tyre, mund dhe duhet të ndihmojnë konkretisht. Atje ku është punuar me kujdes, ka dekore të punuara me kulturë e përmbajtje të lartë politike, aktuale. Ja p.sh. në Manzë, Fierzë etj. kemi shembuj pozitivë që tregojnë shumë. Duke patur parasysh edhe faktin që masat tona punonjëse janë tepër të ndjeshme ndaj dekorit dhe agjitacionit figurativ në përgjithësi, është e nevojshme që të reagojmë sa më tepër për plotësimin e kërkesave të tyre në këtë aspekt të pasurimit të jetës dhe të emulacionit socialist në qendrat e banuara me këto mjete të artit. Po kështu më mirë duhet punuar në përgjithësi edhe me dekorin që lidhet me tabelat e pllakatet me karakter kulturor e tregtar.

Ndërsa këto probleme lidhen drejtpërdrejt me punonjësit dhe realizuesit e dekorit, nga ana tjetër edhe urbanistët dhe arkitektët duhet të mendojnë më shumë për krijimin e mundësive në aplikimin e dekorit në arkitekturë, ambiente, shesh e pika-kyqe të qytetit e të fshatit. Kështu p.sh. është i domosdoshëm krijimi i disa vendeve fikse për dekorin në qytete e fshatra pranë ndërtesave social-kulturorë, udhëkryqeve, ambienteve shoqërore, në ndërmarjet e mëdha, në parqe e lulishte e gjetkë. E theksojmë këtë, sepse praktika e gjertanishme tregon se pak kanë menduar urbanistët dhe arkitektët tanë në këtë drejtim. Kryesorja është të nisemi nga porosia e Partisë së arkitektura njëkohësisht është edhe shkencë e përpiktë edhe art, ajo ka të bëjë shumë me edukimin ideoestetik të masave, dhe se: «Ngado që të shkojmë, do të ndeshemi me ndërtesat, ambientet e ndryshme, parqet, fshatet, monumentet, bile qoftë edhe me vitrinat e magazinave. Të gjitha këto nuk kanë si të mos ndikojnë në edukimin estetik të bashkëqytetarëve tanë». Pra, kjo lidhje e ngushtë e arkitekturës dhe e urbanistikës, me dekorin kërkon patjetër një punë më të studjuar e të centralizuar. Zyrat e urbanistikës pranë Komiteteve Ekzekutive të k.p. të rrethëve kanë shumë mundësi të punojnë e të kontrollojnë më tepër në këtë drejtim. Duhet punuar gjithashtu më me kujdes për caktimin e vendeve të dekorit dhe në raporte të drejta me ambientin rrethues; gjuha e dekorit në përgjithësi të jetë e thjeshtë, dekorative dhe e kapshme shpejt. Nga ana tjetër edhe degët e Lidhjes nëpër rrethe duhet t'i aktivizojnë më dendur piktorët që janë antarë e kandidatë të Lidhjes, sepse eksperiencia na tregon (si në rastin e 1 Majit 1976 në Tiranë, kur për dekorin festiv u angazhuan disa piktorë), se me pjesëmarrjen e tyre bëhen gjetje dhe realizime dinjitoze në dekorin e qyteteve tona, qoftë në raste festash, qoftë të jetës së përditshme.

Në këtë mënyrë, duke ngritur më tej rolin e dekorit, nivelin e tij ideoestetik, do të gjallërohet më shumë fizionomia e ambienteve tona, do të rritet edhe më kultura e paraqitjes së tyre.



Në ditë feste

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Diskutimet të mos

i bëjmë vetëm në faqet

e gazetës

Mellan Drusbku

Hero i Punës Socialiste

Diskutime të tilla, si ky që ka hapur gazeta «Drita» për karakterin kombëtar në arkitekturë, janë shumë të nevojshme të bëhen, sepse, duke shkëmbyer mendime me njëri-tjetrin, do të përcaktohen më mirë disa gjëra. Ja përshembull, para ca kohësh lexova një artikull të shoqëzimit të Trajçës Mazniku. Ishte për punën e qemerit. Trajçia thotë se qemerin e kemi pasur në traditë, ndërtimet më përpara populli ynë i bënte me qemer, sepse çimento e hekur nuk kishte, kurse sot që kemi çimento e hekur, kemi më nevojë ta përdorim qemerin. Nuk di si të them, po unë jam i mendimit që qemerin ta ruajmë se është i bukur. Tani kush ka të drejtë? Nuk them dot se kam unë të drejtë, ose ka Trajçia, prandaj diskutimi është shumë i mirë.

Dua të jap ca mendime për ndërtimet që bëjmë. Nga përjashta shumë ndërtesa janë njësoj, standarte. Mua më duket se është tepëruar në këtë drejtim. Standarti është standart, po nuk duhet të përfshijë gjithëka. Mirë, të bëhen standarte dritaret, hapësirat etj., po nga përjashta s'kemi pse t'i bëjmë të gjitha ndërtesat njësoj, se biem në monotoninë. Populli ynë, po të vësh re, si ka bërë shtëpitë njësoj; dikush e bënte me një ballkon të rrumbullakët, dikush me një dhomë të rrumbullakët etj. Edhe ne tani mund ta ruajmë këtë traditë dhe qytetet kanë për t'u dukur më të

bukur. Mund të thotë ndonjëri se kjo punë ka harxhime, por s'është ashtu, përkundrazi, është me ekonomi dhe këtë e ka vërtetuar praktika, përvoja jonë.

Tani dy fjalë për mbulesat. Të gjitha mbulesat e pallateve i bëjmë njësoj, si kapakë betoni me trashësi pesë centimetër. Një ndërtesë dykatëshe mund t'i shkojë një mbulesë e tillë, po një pallati 5-6 katësh nuk i shkon, i humb bukuri. Arkitektët duhet të vrasin mendjen se si duhet mbuluar një pallat, mbulesa të jetë në harmoni me gjithë ndërtesën, vende-vende bordura e betonit mund të jetë e hollë, vende-vende më e ngritur, sipas rasti.

Përsa i përket dekoracionit, si domos në ndërtimet social-kulturore, nuk jemi mirë. Ne e dimë që populli ynë edhe një tavan me dërrasë të bënte, e zbukuronte, e gëzonte. Në disa ndërtime kjo sikur është lënë mënjanë, sikur po e harrojmë natën që kanë mjeshtrat e zbukurimit. Dekoracione bëhen, po u ka mbetur mendja disave o me granit e me brisoletë, o s'ka. Mirë, edhe me granit e brisoletë do të bëhen zbukurime, por mund të bëhen edhe më të thjeshta, edhe më ekonomike, sipas traditës që kemi. Dritaret, përshembull, mund të bëhen nga jashtë me kornizë llaçi e gëlqereje, nga brenda me kornizë llaçi me sherbet allçiu etj. Sidoqoftë, ndërtesat, veçanërisht ato social-kulturore, duhet ta kenë një zbukurim, sepse i japin sy

godinës. Një portë kryesore, përshembull, sa ta bësh me beton, bëje me një kornizë të thjeshtë dhe del më e bukur.

Unë kam një vërejtje për vendosjen e godinave. Ka një mani që godinat t'i vendosin në formë sharre, qoshe më qoshe, jo drejt. Kështu përshembull i kanë vendosur në disa qytete, edhe në Tiranë. Mua kjo s'më duket e bukur, sikur e copëzon paisazhin e rrugës dhe të vret syrin. Unë jam i mendimit që ndërtesat të vendosen drejt, me fasadë nga rruga, jo të kthyer më qoshe, si sharër. Po kështu, kur e bëjmë një ndërtim, duhet të kemi parasysh perspektivën. Buzë rrugës, pranë institutit të kulturës fizike «Vojo Kushi» është ndërtuar një stadium i lojrave me dorë. Për mendimin tim ky stadium s'duhet ndërtuar aty, se në të ardhshmen në atë vend duheshin ndërtuar godina që ta plotësonin rrugën kryesore dhe, së dyti, sepse ai është i projektuar keq, pa shije (nuk e di në e ka mirë anën funksionale apo jo).

Tani diçka tjetër, për anën funksionale të dhomave, apartamenteve. Dhomave që bien në ballkone, në disa herë derën ua bëjmë me tri kanata, me një xhamllëk të madh. Ç'është nevoja t'i bëjmë kështu? E para e punës kush-tojnë mjaft dhe janë para të harxhuara fare kot, sepse këto dhoma në dimër janë të ftohta dhe nuk shfrytëzohen mirë. Dhoma të tilla, me një xhamllëk kaq të madh, për mendimin tim, janë gjymë dhome, sepse pranë xhamllëkut as tavolinë vë dot, as krevat, por është një vend që mbetet bosh.

Diskutimi për arkitekturën është i gjërë. Unë shfaq vetëm disa mendime, mbase të shkëputura, për ato që më kanë rënë në sy dhe që mendoj se kemi mundësi t'i bëjmë më mirë. Në kemi ndërtuar shumë godina të bukura. Në të ardhshmen edhe më të bukura do t'i bëjmë, me vullë kombëtare, ja, me përpjekjet e ne të gjithëve punëtorë e mjeshtra e arkitektë. Këto diskutime të mos i bëjmë vetëm në faqet e gazetës, por edhe në mbledhjet tona të punës, midis shokësh sa herë që të dalë nevoja për një gjë të tillë. Atëherë gjërat do t'i kemi edhe më të qarta dhe do të punojmë edhe më mirë.

Analiza

dhe debate

Në vitin jubilar të 35-vjetorit të themelimit të Partisë kryesia e degës së Lidhjes në Durrës, ka marrë në analizë punën e sektorëve të arteve figurative, muzikës, teatrit dhe letërsisë.

Në këto analiza kanë marrë pjesë, përveç anëtarëve të degës, edhe krijues dhe interpretues, amatorë e talente të rinj. Gjithashtu kanë marrë pjesë edhe shokë nga Komiteti i Partisë së rrethit, seksioni i arsimit e kulturës e tjerë. Gjatë këtyre analizave ka dalë në pah puna e mirë e shkrihtarëve dhe artistëve të rrethit, të metat, dobësitë e shkaqet e tyre si dhe janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për një ecuri sa më të mirë në të gjitha drejtimet.

Një frymë autokritike e shëndoshë përshkoi mbledhjen e sektorit të muzikës në drejtim të rritjes së vigjilencës për parandalimin e edo shfaqjeve të huaja, sado e vogël që mund të duket, në krijimin, orkestrimin dhe interpretimin vokal e orkestral të këngës sonë. Më shumë interes që mbledhja me dramaturgët e rrethit, në të cilën u ndal gjërësisht si në trajtimin e temave të ndryshme të kohës dhe në shqyrtimin paraprak të këtyre krijimeve.

Në konkursin kombëtar të dramës do të paraqiten edhe disa autorë durrsakë. Po kështu teatri «A. Moisiu» po pregatit dramë e autorëve B. Hoxha e K. Pirro, që trajtojnë temën e ruajtjes së pastërtisë së kuadrut dhe luftën e madhe të Partisë sonë kundër revizionizmit modern.

Për të njëjtin qëllim kryesia e degës ka organizuar takime pune dhe me krijuesit e qytetit të Shijakut e të Kavajës. Diskutimet krijuese për mozaikun «Çlirim i Durrësit» të autorëve G. Priftuli e N. Vasija, vëllimin «Vjersha në torbën e fishekëve» të autorit Sh. Peçi, për muzikën në estradat amatore të klasës punëtorë, për libretin e operetës «Yje mbi det» të shkrimtarit Gj. Vlasi, për muzikën në premierën e re të estradës profesioniste e tjerë, janë karakterizuar nga një frymë e gjallë debati e kritikash dashamirëse, të cilat i kanë ndihmuar shumë krijuesit për të përmirësuar punimet e tyre e për të ngritur në një nivel më të lartë krijimtari-në dhe interpretimin.

Koncerti instrumental i organizuar në bashkëpunim me shkollën e mesme «Mujo Ulqinaku» paraqiti një tablo të punës me talentet e reja në muzikë. Një takim interesant bënë shokët Gj. Vlasi, M. Zeqo e H. Ulqini me të rinjtë e fshatit të rinisë. Po kështu, ditë të bukura pune e frymëzimi kaluan piktorët e rrethit në fshat, pikërisht tani që kooperativistët janë në fushatën e madhe të korrje-shirjeve.

Korresp. i «Dritës»



(Foto: S. Kaba)

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Shtëpitë janë të bukura, por kemi edhe vërejtje...

Jemi disa punëtorë në ndërmarrjen artistike «Migjeni»; kemi hyrë në shtëpi të reja dhe jemi shumë të kënaqura nga ato. Shtëpitë tona kanë gjithçka: dhomën e bukës të madhe, aneksin, ballkonet, dhomat e përshtatshme, korridorin etj. Tani dhe dhomën e bukës mund ta përdorim më mirë, se gatujmë e punojmë në aneks. Këtu kemi një vërejtje të vogël: dera e aneksit do të ishte mirë të dilte në ballkon. Ballkonet që vendosen në dhomën e gjumit kuptohet se s'janë dhe aq të përshtatshëm. Që të vesh të rrish atje duhet të kalosh nëpër krevatë, por edhe nuk vendos dot asgjë për përdorim të përditshëm. Derisa nuk është zgjidhur ende mirë çështja e depos së druve, (vetëm një kthinë e vogël në banjë që mezi i nxë) shumë nga ne i vendosin drutë dhe në ballkon. Por në ballkonet e dhomave s'ke si i vendos, se drutë mbajnë dhe papastërtira, pluhura, miza dheu etj. Nga ana tjetër, ballkonit në aneks, qoftë edhe i vogël, do të ishte shumë i përshtatshëm kur gatujmë. Gjatë verës sidomos, po edhe në dimër, dihet se shumica gatuan në furnellë me vajguri, e cila ka vetëm një të metë: bie erë dhe bën tym kur

shuhet. Për këtë arsye, ka disa që furnelën me gjithë tenxhere, nuk e venë në kuzhinë, por edhe në banjë nuk mund të vendoset, sepse s'është aspak gjë e mirë, përkundrazi, po të ishte një copë ballkon në derën e aneksit, gjithçka do të zgjidhej. Gjithashtu, sot në apartamentet tona të reja nuk ka shumë rra-ngulla, siç mbaheshin dikur nëpër shtëpitë me oborr, por megjithatë çdo shtëpi ka diçka, që duhet ta vendosë dikur. Për këtë banja mund të ishte më e madhe, por jo vetëm për këtë edhe për faktin se banja është një ambient higjenik.

Edhe ne jemi të një mendimi se një vend i hapur në mur, diçka e ngjashme me musëndrat e traditës sonë shqiptare, do të ishte shumë e nevojshëm. Çdo familje ka dyshekë, jorganë, jastëkë e rroba të tjera për miqtë, që s'mund t'i verë në krevat, por tani ato, nga që s'kemi ku t'i vëmë, i vendosim sipër dollapit, duke shëmtur dhomën dhe në një vend aspak të përshtatshëm; ose sajohej ndonjë e ndarë me perde që të merr shumë vend e s'ke ku vë komonë, tualetin apo krevatin. Ndërsa po të hapej vendi në mur, ato vendosen aty, me rregull dhe pastër. Kjo mund të zgjidhet

ndoshta duke marrë pak nga gjerësia e ndonjë dhome apo më tepër nga korridori, i cili s'ka pse të jetë shumë i madh, megjë tek ne ai nuk përdoret për të ndënjur. Me që ra fjala për korridorin, në disa banesa aq mbehet vetëm me dritë elektrike. Ndoshta po të bëhej një derë me xham mund të ishte mirë. Ndonjëherë na vjen keq që në këto shtëpi të bukura pikojnë pllakat dhe dëmtohet tavanit, për shkak të punës së dobët; del priza nga vendi apo dorezat e

dyerve, kjo tregon vetëm pakujdesi. Tani ne jemi në atë fazë të ndërtimeve ku gjithçka duhet të bëhet me cilësi të lartë, ashtu si dhe tek ne, në ndërmarrje, ku kërkesat janë jo vetëm për sasi, por edhe për cilësi sa më të mirë.

DHIMITRA KOTE rep. galanterisë

AISHE ÇERKEZI, rep. çorapeve.

MARIANA HATIBI, VJOLLCA

BENGU, rep. qëndisjes në ndërmarrjen artistike «Migjeni», Tiranë.

Mundësitë t'i shfrytëzojmë deri në fund

Rubrika e hapur në gazetë për arkitekturën me ngjalli interes dhe mendova të them dhe unë dy fjalë, të hedh ndonjë mendim, jo aq për planimetrinë apo ndërtimet nga jashtë në përgjithësi, por më tepër për ambientet tona të brendshme, për mënyrën se si ndërtohen tani tek ne apartamentet e reja. Unë banoj në një nga ndërtesat që janë ngritur para një viti, në lagjen 3, buzë rrugës. Mund të them se jemi të kënaqur nga kjo shtëpi: ka hapësirë e dritë, kushte të përshtatshme, ballkon, aneks etj. Një nga veçoritë pozitive të këtyre apartamenteve të rinj është pikërisht aneksi i kuzhinës. Kjo mund të duket gjë e vogël në krahasim me gjithë apartamentin, por për ne gratë, është më se i domosdoshëm dhe ka plotësuar një sërë kërkesash e na ka zgjidhur shumë probleme që kishim përpara. Shqiptarët, sipas traditës, e presin mikun zakonisht në kuzhinë, aty ku rri gjithë familja, ndërsa dhoma e pritjes, pothuajse rri e mbyllur,

sidomos gjatë dimrit, prandaj veçimi i sobës, lavamanit, i enëve e gjërave të tjera të kuzhinës në një kthinë, në aneks e lë të pastër dhomën e bukës, komode e të rehatshme dhe nuk shqetësohesh nga tymrat, enët e të tjera gjëra. Edhe punët bëhen më mirë, pa rrëmujë, në kushte higjenike. Duke qenë i domosdoshëm, them se ai mund të bëhet edhe më i madh, ndoshta le të zvogëlohet pak kuzhina apo korridori, dhe aneksi e banja - e kam fjalën për apartamentet ku banojmë ne, të jenë më të mëdhenj. Për banjën, bile do të thosha se dritarja e saj, e hollë dhe e ngushtë, e vogël, do të ishte shumë mirë të qe një dritare e madhe nga e cila të hynte sa më shumë ajër e diell, sa më shumë dritë. Edhe në dhomat mund të bëhen dritare më të mëdha. Klima e Tiranës nuk është e ftohtë, dritaret e gjera, xhamllëqet i japin bukuri shtëpisë. Shpesh kemi vënë re se njerëzit, duke dashur ta zbukurojnë dhomën, i vendosin perdet anës dritares, mbi mur, për të dhënë përshtypjen se dritarja është më e madhe. Kjo ndjenjë estetike mund të konkretizohet duke e bërë vërtet dritaren më të madhe.

Unë kam banuar dhe në Berat e në Qytetin Stalin. Në Berat kishim një apartament në të cilin kishim dy vende (në dhomë dhe në kuzhinë) të hapura në mur, ku mund të vendoseshin rrobat, dyshekët etj. Një gjë e tillë mendoj se hyn mirë në punë në një shtëpi.

Në Tiranë e në qytete të tjera janë ndërtuar e po ndërtohen kaq shumë apartamente, pra kaq investime e para të harxhuara për to, po jo gjithnjë puna bëhet me kujdes. Kështu, pllakat e dyshemeve janë të ndryshme, të kuqe, jeshile, me pika, të verdha etj. Zakonisht ato përzihen dhe dyshemeja duket lara-lara, aspak bukur. Pse të mos shtrohet një dhomë me pllaka jeshile, tjetra të verdha etj. Ato janë, nuk është se bëhet ndonjë harxhim këtu. Fjala është që kur i kemi mundësitë, t'i shfrytëzojmë ato me estetikë.



Rrugë në Shkodër.

(Foto: L. Mazreku)

AJKUNA XHOKAXHIU, arsimtare.

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Veçori dhe probleme të arkitekturës si art

Andon Luti

inxhinier-arkitekt

Arkitektura në kuptimin e përgjithshëm të fjalës (dmth arkitekturë e urbanistikë) është një pjesë e ndërtimit. Si e tillë ajo është pjesë e sferës së kulturës materiale, pra pjesë e bazës shoqërore, e prodhimit të të mirave materiale.

Ndërtimi i qendrave të banimit, me sheshet e rrugët e tyre, me lagje e komplekse godinash dhe me godina të veçanta, me paisje e zbukurime e monumente të lidhura me natyrën e vendeve ku ndërtohen, krijon ambiente ku linden, rriten dhe edukohen brezat e jeton shoqëria, ku masat e popullit punojnë, zhvillohen dhe krijojnë të mirat në të gjitha fushat e jetës shoqërore, ato materiale dhe shpirtërore.

Partia e shoku Enver kurdoherë e kanë vlerësuar rolin edukativ, ideologjik dhe estetik që luan arkitektura, por gjithnjë e kanë theksuar se këto dy anë nuk duhet të veqohen, mbasi ato paraqesin një unitet dialektik.

Ky ambient i ndërtuar, me të cilin njeriu është vazhdimisht në kontakt, gjatë gjithë jetës së tij, është një faktor shumë i rëndësishëm, që ndikon në formimin e koncepteve shoqërore, ideopolitike, ideoestetike e të shijeve të tij. Vepra arkitekturale ka, përveç anës së saj materiale, edhe anën tjetër, anën artistike e si e tillë ajo bën pjesë edhe në sferën e kulturës artistike.

«Neve na duhen vepra arkitektonike të mira, dmth që ato të jenë të përshtatshme, të forta, të lehta, të bukura dhe të lira» - u tha në Kongresin VI të PPSH.

Ndërtuesit dhe artistët tanë, duke studjuar stilin dhe format e bukura të traditës sonë, do të mësojnë shumë nga talenti dhe zotësia e madhe e mjeshtrave tanë në përvetësimin dhe përdorimin e materialeve dhe të teknikës së vendit në kohën e tyre, për të krijuar qytete dhe ndërtime të bukura, të cilat ne i kemi trashëguar dhe sot krenohemi me to.

Për shpejtimin e ndërtimit të socializmit Partia kërkon që ne të rrisim nivelin tonë teknik, shkencor dhe estetik.

Klasa jonë punëtore dhe krijuesit tanë të arkitekturës i janë futur gjerësisht punës, në fshatra e malësitë e largëta, kudo ku ndërtohet. Ata po mësojnë, po rrisin aftësitë e tyre dhe nivelin teknik në ndërtimet për të realizuar me forca e mjetet tona planin e ndërtimit sipas kushteve konkrete të vendit, duke përballuar të gjitha vështirësitë e rrethimit imperialisto-revizionist.

Tek ne llojet e ndërtesave dhe mënyrat e ndërtimit të tyre janë të shumëllojshme, nga ato më të thjeshtat dhe me teknikë e me materiale rrethore, deri tek

ndërtimet komplekse me teknikë nga më të përparuarat, duke i përdorur të gjithë përvojën tonë 31-vjeçare dhe mundësitë konkrete.

Në fabrikat, kombinatet e qytetet zhvillohen edhe ndërtime me lartësira të mëdha e teknikë të re, si montime kompleksesh banimi me parafabrikimin e të gjithë objektit me pjesë të gatshme të prodhuar në fabrikë në mënyrë industriale. Në fshatrat e reja, deri në malësitë e largëta, ndërtohen banesa e shkolla, spitale rurale, dyqane, furra e banjo etj., objekte të pajnhura dikur në fshatrat tona. Këto zbatohen me projekte-tipa, duke iu përshtatur vendit ku ato ngrihen, me materiale rrethore, me gurë e tulla, edhe me disa kate me terraca ose me çatë tregullash e patavrash, edhe me ditrate tipe, edhe dërrasa të prodhuara në vend (nga sharrat lokale në vendet e largëta si p.sh., në Theth, Vermosh ose në fshatrat e kooperativat në rrethe). Kudo po përhapen ndërtimet e reja dhe zhvillohet teknika e mbështetur në traditën popullore dhe përvojën tonë të socializmit.

Kështu, sipas mënyrës së ndërtimit, kemi edhe një larmi pamjesh e objektesh që mbajnë tiparet e atyre vendeve. Edhe format tradicionale të kompozimit (vendosja, orientimi, shikimi etj) elementët e veçantë si fasada guri të pasuatuara me furga llaç ose me qoshe pjesërisht të skalitura, me tulla të suvatura, çati me pjerrësi dhe strehët, detalet si shkalla guri në hyrje, teraca, çardaqe e ballkone me parrakë druri ose dërrase, lulembajtëset, kornizat etj., janë në zhvillim, i formave të traditës së vendit, sipas teknikës rrethore dhe i përgjigjen ambientit, shijes e karakterit kombëtar. Ato nuk janë krijime të thjeshta, as imitime shabllone, por kompozime me talent krijues teknik dhe estetik të mjeshtrave të vendit tonë pa ndikime të huaja. Të tilla ndërtime s'kanë të bëjnë me ato objekte të kritikuar siç janë p.sh., shtëpitë e verimit në Llogara, restorant-kafeja mbi burimet në fshatin Borsh ose agjencia e pasagjerëve në Tepelenë e

ndonjë tjetër, ku janë imituar disa forma e shembuj të huaj, të zbatuar me materiale deficietare e me mjete teknike jo ekonomike, kur përfaqëtojnë shtëpi me mure guri e çati me tregulla! Për këto, mendoj, se autorët, kërkimin e së resë e kanë kuptuar thjesht si kërkim formash figurative ose «hapësirë». Ato objekte nuk i përshatën, por veqohen nga ambienti dhe nga shija e popullit.

Afrimi, njohja e bashkëpunimi me mjeshtra popullorë, është një shkollë për të kuptuar se edhe objektet e vogla në fshat e qytet duhet të mbështeten në tabanin kombëtar se edhe për këto objekte të vogla duhet të mendohet për sintezën ndërtim e art.

Kjo vlen po ashtu për ndërtesat masive (banesat, shkollat etj), kudo e veçanërisht për ato që kanë filluar të prodhohen në mënyrë industriale në fabrika.

Një veçori tjetër e veprave të arkitekturës janë se ato konceptohen, projektohen dhe zbatohen nga mendja e puna krijuese e shumë njerëzve, gjë që e dallojnë arkitekturën tonë nga ajo borgjeze e revizioniste.


Pra, duhet të theksohet se krijimtaria e arkitektit është medemos punë e një sinteze me zhvillimin e teknikës së ndërtimit në vendin tonë dhe se funksioni utilitar i veprës ka përparësi se bën pjesë në sferën e kulturës materiale të shoqërisë. Gjithashtu, funksionin e saj artistik, arkitektura e realizon me mjete ndërtimore e po ashtu edhe në bashkëpunim, në sintezë me artet e tjera përkatëse (monumentale, dekorative, të aplikuar etj) në shkallë të ndryshme sipas rastit. Kjo i krijon mundësira më të gjera për pasurimin e saj artistik në përmbajtje dhe në formë.

Sintesa e arkitekturës në artet monumentale në vitet mbas Çlirimit ka patur një fushë të gjerë veprimi në objektet e rëndësishme të ndërtuara si dhe në përmendoret historike të lufrave të popullit tonë. Ajo është zhvilluar shumë, si në numër e madhësi, dhe ka patur përmirësime vazhdimisht të for-


(vijon në f. 14)



Ndërtesa banimi të reja në Tiranë, komplet të parafabrikuesha.



Spital rural në Theth.



Berat, 1976

(Foto: S. Kaba)

(vijon nga f. 7)

mën artistike si edhe në drejtim të bashkëpunimit midis arkitekteve e artistëve. Kuptimi i drejtë i arkitekturës, me të dy anët e saj, si ndërtim e art i të ndërtuarit nga të dyja palët, artistë dhe arkitektë, do të mënjanojë edhe disa nga të metat në punën e tyre.

Në fushën e sintezës të arkitekturës me degët e arteve të aplikuaras etj., zhvillimi deri tani është më i pakët se në ato monumentale, dhe në këtë sferë janë shfaqur në disa raste edhe gabime që kanë ardhur si rrjedhim i koncepteve të huaja si dhe nga mungesa e shfrytëzimit të traditave tona kombëre të pasura, qofshin këto në trajtimin e jashtëm të godinave ose në ato të ambienteve të brendshme (në lloje dhe vizatime të shtresave të dyshemeve, në trajtimin e faqeve të mureve e të tavaneve, në dekoracionet e tyre dhe në elementët e ndryshme, siç janë rrethime shkallësh, ballkonesh, strehat e kornizat, pllakat për veshje etj.). Kështu p.sh., janë prodhuar pllaka të glazuruara në formë dhe ngjyra që nuk i përshtaten shijes së popullit tonë (si p.sh., në fasadat e ATSH etj., në interieret, si në restorantin e hotelit në Gramsh). Ka patur prirje për ta vlerësuar arkitekturën si moderne vetëm duke përdorur materiale importi (si duralumin për xhamllëqe e tavane, qeramika të veçanta për veshje muresh e dyshemesh, linoleume, tapete, ndricues elektrikë të importuar etj.) e jo ato të mundësive tona dhe me materiale vendi e rrethore. Tipike janë ambientet restorant - kafe të hotelit «Drini» me elemente dekorative të ndikuar nga shijet e huaja, gjë që është kritikuar edhe më parë në këtë rubrikë të gazetës «Drita». Të tilla janë edhe disa tavane ose zbukurime në objekte të tjera që nuk janë të karakterit tonë kombëtar.

Në këtë kuptim, na duken shumë të drejta sugjerimet për de-

korin tonë tradicional, të shkruara në artikullin e datës 25.VII.1976 nga Heroi i Punës Socialiste Mellan Drushku.

S'ka dyshim, se përdorimi në ndonjë ambient me tavane të suvatuara ose prej druri, me dekore të frymëzuara nga dekorori ynë i pasur, në vend të tavaneve prej duralumini ose prej materialesh të tjera importi, bën që jo vetëm të realizohet më drejtë parulla e Partisë «shpejt, mirë e lirë», por këto ambiente do të mirrin kështu më tepër karakterin tonë kombëtar.

Trajtime të tilla në arkitekturë brenda dhe jashtë godinave mendojmë se do të jenë më afër ndjenjës dhe shijes së popullit, do të shërbejnë më mirë për edukimin estetik dhe kombëtar e socialist të tij, gjë që shoku Enver e ka theksuar që në ditët e para të Çlirimit; «arkitektët, -tha shoku Enver më 19 shkurt 1948, -duhet të kenë parasysh stilin popullor. Të përpiqen që të krijojnë një stil në përshtatje me karakteristikat e vendit tonë... çdo gjë që do të ngrihet t'i përshtatet regjimit tonë popullor».

Frenimet që i janë bërë aty - këtu marrjes dhe futjes së dekorit dhe elementëve arkitektonikë, të pajisjeve dhe sendeve të përdorimit të trashëgimit tonë të pasur e shumë të bukur, me pretekst që këto të «mos kopjohen», por të «përpunohen», mendoj se pengojnë studimin e përdorimin e gjerë të këtij trashëgimi.

Në fazën e tanishme të transformimeve të mëdha mendoj se duhen përpjekje më të shumta nga artistët e arkitektët ndërtesues si të atyre të shkollës ashtu edhe atyre të praktikës, në të gjitha fushat dhe të bashkëpunimit të gjerë e reciprok të mendimit e të punës.

Deri tani arkitektët dhe artistët e arteve të aplikuaras nuk e kanë krijuar akoma sa duhet afrimin me krijuesit popullorë në atë shkallë sa në disa degë të tjera të arteve si p.sh., lehtërsia, muzika, vallet etj., të

cilat, duke u mbështetur në krijimtarinë popullore dhe duke marrë prej saj karakterin kombëtar, veprat e tyre janë bërë jo vetëm më të afërta, por edhe cmohen e admirohen edhe nga popujt e tjerë. Të kujtojmë sukseset tona p.sh., në turneun e trupës së baletit tonë në Dizhon (Francë) admirimin dhe vlerësimin e lartë për kulturën tonë nëpër painedet në vendet e huaja kudo etj. Në arkitektët e artistët, institucionet e arkitekturës, Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve, Instituti i Lartë i Arteve, Katedra e Arkitekturës e Universitetit të Tiranës etj., duhet të bëjmë një punë më të madhe për një bashkëpunim me mjeshtrat dhe amatorët e artit popullorë. Gjithashtu, duhet t'i nxisim e inkurajojmë më tej punën praktike që bëjnë nxënësit e shkollave të mesme për prodhimin e materialeve ndërtimi dekorativë si p.sh. shkolla e mesme «Partizani», e cila prodhon pllaka veshje për ndërtesa, shkollën e mesme të artit me kërkimin e saj të arteve të aplikuaras, iniciativat e tjera të tyre për mësimin e mjeshtrëve si gurëgdhënës, kalldrëmxi, punime druri, qeramike, metall etj. Mendoj se përveç masave të tjera të marra për afrimin e arkitektëve dhe artistëve në mjeshtrat e ndërtimit dhe artistët popullorë të dekorit dhe artit të aplikuar duhet të krijohen edhe mënyra të tjera për problemet që trajtohen në diskutime e shtyp; mbi problemet e sintezës ndërtim e art për aktivizimin e gjerë të tyre në këmbim-mendim e përvojë për eksperimentime dhe punë të përbashkëta në shkallë sa më të gjerë.

Do të ishte mirë që të zgjerohet akoma më tepër se deri tani bashkëpunimi e aktiviteti krijues edhe në artet e aplikuaras e dekorative në të gjitha llojet (për pamjet e godinave e interjeret deri të arkitektura e blierimit e rregullimit të jashtëm të vendeve).

Zgjerimi gjithnjë e më i madh

i prodhimit industrial të pjesëve strukturale arkitektonike dhe të pajisjeve të godinave masive të banimit etj., hap një fushë të gjerë për sintezën e arkitekturës në artet dekorative e të aplikuaras për krijime artistike në shije kombëtare. Edhe në këtë drejtim ka patur ndonjë ngurim e paqartësi. Me të drejtë është kritikuar në këtë rubrikë të gazetës «Drita» ndonjë mendim i gabuar, botuar në shtyp para plenumit IV, ose ndonjë mendim i pashprehur në shtyp se tipizimi i masivitetit dhe industrializimi në arkitekturë paraqesin rrezikun e uniformitetit dhe të monotonisë. Jeta edhe tsek ne ka vërtetuar të kundërtën.

Tipizimi nuk sjell monotonin kur arkitekti nuk nënvleftëson tipet dhe nuk merret vetëm me vendosjen në mënyrë shabllone, por bën studime e përpunime krijuese të vendosjes dhe të paraqitjes së jashtme të tipave, duke i kombinuar dhe përshtatur terrenit, ambientit dhe karakterit tonë kombëtar socialist.

Industrializimi i vendit tani i vë në plan të parë këto lloje studimesh me kërkesat për të krijuar kështu një sintezë të plotë të arkitekturës dhe me artet e aplikuaras edhe për një bashkëpunim më të gjerë të arkitektëve e artistëve me prodhuesit e zbatuesit si dhe me institucionet studimore, arsimore përkatëse.

Kjo do të ndihmojë që traditat e pasura të arkitekturës fshatare dhe ato qytetare, së bashku me arkitekturën e kultivuar, të afrohen, të bashkëpunojnë e të pasurohen anasjelltas për një zhvillim më tej të krijimtarisë të arkitekturës sonë kombëtare socialiste.

Arkitektura jonë do të plotësojë kështu akoma më mirë detyrën e saj klasore me të dy funksionet e saj, si ndërtimin e zhvillimin e qendrave tona të banimit (fshat e qytet) ashtu dhe për edukimin estetik, kulturor e socialist të masave tona punonjëse.

ANDON LUFI

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Arkitektura

në ndërtimet

e fshatit

Kleant Dede

në minierën e Manzës

Kujto i ka takuar që të shkojë për herë të parë në ndonjë krahinë apo fshat të panjohur më parë nga ai. Mbas kalimit të peizazhit fushor apo malor, ku para syve të shpalosen format e bukura gjeometrike apo arkitektonike të ndërtimeve bujqësore, që dora e palodhur e bujkut tonë ka gdhëndur në sipërfaqen e tokës, të lind mendimi për të ndalur diku.

Dhe çdo gjë që ka të bëjë me bukurinë e këtij apo atij fshati është e lidhur ngushtë me objektet konkrete që të sheh syri, prandaj edhe për to të lindin mendime të shumta.

Krahinat fushore e kodrinore të Lushnjës, Beratit, Elbasanit, ku shtrihen fshatra të tëra, të tërheqin vëmendjen me bukurinë e tyre. Shumë ndërtime të reja janë bërë nëpër qendrat e këtyre fshatrave, duke filluar nga objektet socialkulturore, lokalet e çlodhjes e argëtimit, si dhe shtëpitë e banimit. Nëpër to, paradite e mbasdite, lëvizin e gumëzhijnë bujqit që mësojnë e kalojnë orë të gëzueshme. Këtu është dhe vendi ku njerëzit vijnë për problemet e ndryshme që u lindin në lidhje me fermën apo kooperativën.

Në të kaluarën fshatari ynë ishte i detyruar nga pushtuesit dhe klasat shfrytëzuese që shtëpinë ta ndërtonte sa më larg vendeve të kalimit, në majë të kodrave apo të futur mbrapa ndonjë koriëjeje, ku mendonte se i ki-

shte shpëtuar gjysmës së të kokes. Sot, në kushte krejt të ndryshme shoqërore dhe politike, me rritjen e nivelit të mirëqenies së popullit, nën udhëheqjen e Partisë, fshatari ynë ka ngritur shtëpi të reja e të rehatshme që nuk kanë të krahasuar me ato kasollet e së kaluarës.

Një karakteristikë dalluese për këto krahina është se, kur pyet për fshatin, të tregojnë një hapësirë të gjerë toke apo kodrash dhe në të spikasin, vende-vende, nga 4-5 shtëpi si oaze të futura mes gjelbërimit.

Jam i mendimit që këto shtëpi, që bujku ynë po i ndërton gjithnjë e më të bukura, të sistemohehen me një paraqitje të dukshme nëpër qendrat e çdo fshati për të cilat folëm më sipër. Dhe këto ndërtime, në pamjen e jashtme e të brendshme, mund të kenë si kritere dalluese veçoritë arkitektonike të krahinës përkatëse, duke i harmonizuar bukur me çdo shtëpi, në mënyrë që çdo qendër të kthehet në një qytezë të vogël, duke ruajtur gjithmonë karakteristikat dalluese të krahinës në traditat e ndërtimit të banesave.

Një gjë të tillë e vëmë re në fshatrat e Shqipërisë së Jugut, ku shtëpitë, bile edhe me një, dy apo tre kate, janë të grumbulluara pranë njëra-tjetrës, duke qenë të vendosura në një pikë mbizotëruese mbi të gjithë terrenin, që bie në sy edhe nga distanca shumë të largëta, si ditën, ashtu dhe natën, nga ndricimi i dritave. Një ndërtim i tillë i fshatrave ka di-

sa anë pozitive, duke filluar që nga fqinjësia e vëllazërimi me njëri-tjetrin, përhapja e kulturës së jetesës në një shkallë më të gjerë dhe më të shpejtë, krijimi i ambienteve të ndryshme kulturore artistike, të cilat fshatari mund t'i shfrytëzojë me mirë se i ka afër shtëpisë, shfrytëzimi e sistemimi i sipërfaqes së tokës, mundësia e një furnizimi ushqimor e mallrash të tjera është më e madhe dhe më e favorshme për banorët, e shumë të tjera kondita socialkulturore e social-ekonomike, të cilat e bëjnë jetën e fshatari më të larmishme.

Dimë dhe kemi dëgjuar shumë mbi krojet e fshatit dhe, për këto kroje, në të kaluarën, populli ynë ka treguar një kujdes të veçantë, duke i ndërtuar e zbuluar në forma të ndryshme, duke gdhëndur gurë e duke krijuar vende të përshtatshme për mbushjen e bucelave etj.

Tani fshati ynë e ka çezmën e tij, bile dhe me presion, por vihet re që në disa fshatra në rrethin e Durrësit për ujë shërben vetëm një copë tub mbi tokë, i cili luan sa andej-këndej.

A nuk do të ishte mirë që këto ceza të pajisen me ato elemente kombëtare që thamë pak më lart, natyrisht edhe duke i përpunuar sipas kohës që jetojmë dhe duke i pasuruar anash dhe rreth e qark me vende për t'i mbjellë qoftë edhe me lule, në mënyrë që edhe uji që derdhet të shfrytëzohet?

Vendosja e kinoklubit, zyrave, dyqaneve, librarisë, bibliotekës, muzeumeit, banjave, mensës e objekteve të tjera, mund të bëhet në mënyrë të tillë që të krijojnë një ansambël të harmonishëm në qendrën e fshatit, duke patur parasysh edhe madhësinë e detyrës dhe dritave dhe, pas tyre të ndërtoheshin banesat e fshatarëve, po jo duke lënë në dispozicion një truall shumë më të madh nga sa është në realitet projekti i shtëpisë dhe, ndërmjet këtyre, mund të vendosen cezat e fshatit. Në këtë mënyrë mendoj se do të kemi një grumbullim e përqendrim më të mirë të elementeve kombëtare të arkitekturës sonë. Në fshat ne mund t'i ruajmë dhe t'i zhvillojmë shumë mirë vlerat artistike të traditës tonë kombëtare në ndërtimet e banesave edhe në paraqitjen e jashtme të tyre.

Pra, paraqitja e bukur e një fshati do të na shërbejë gjithmonë si burim frymëzimi dhe si një arshivë e madhe e elementar kombëtar.

Diskutim

krijues


Në rrethin letrar të minierës së Manzës u bë diskutimi i vëllimit me tregime të zgjedhura të shkrimtarit Anastas Kondo. Ky është një ndër aktivitetet e dendura që po zhvillon ky rreth letrar punëtorësh, i cili, ndonëse nuk ka shumë kohë që është krijuar, e ka gjallëruar mjaft jetën kulturore-artistike të minierës. Anëtarët e tij, krahas krijimtarisë së tyre, e cila është bërë më e gjerë dhe me cilësi më të mirë, këto kohët e fundit, tregojnë interes të veçantë edhe ndaj krijimtarisë së shkrimtarëve të afirmuar, që e studiojnë me vëmendje dhe e diskutojnë midis tyre.

Interesimi që shfaqën ata ndaj vëllimit me tregime të zgjedhura të A. Kondos e kishte pikënisjen në atë që autori, duke pasur një përvojë të pasur e duke qenë se ka punuar vetë në sektorin e gjeologjisë, në mjaft nga tregimet e tij ka shkruar për punën dhe jetën e gjeologëve tanë, për minierat dhe për njerëzit e tyre. Diskutantët K. Dede, A. Bici, D. Gjergji etj. vunë në dukje, pikërisht, faktin që mjaft personazhe të tregimeve të autorit, të vizatuar me vërtetësi dhe dashuri, u kujtojnë atyre shokët e punës në minierë. Kjo vjen, nënvizuan ata, sepse shkrimtari di të vrojttojë tek njerëzit e punës dhe zbulon me mjeshtri botën e pasur shpirtërore të tyre. Filli që i lidh të gjithë tregimet, jo vetëm ata me temë nga puna, por edhe ata me temë nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, është fakti se në qendër të tyre është vënë njeriu i thjeshtë i popullit me karakteristikat më pozitive të tij si dashuria për Partinë dhe Atdheun, heroizmi, thjeshtësia, bota e gjerë shpirtërore etj. Nga kjo pikëpamje tregimet e A. Kondos janë jetësorë, të ngrohtë dhe të rrëmbejnë me natyrshmërinë e tyre.

Në diskutimin e këtij vëllimi letrarët punëtorë pranë mjaft shembuj tregimesh të realizuar mirë si «Kio», «Është diell i fortë e më djeg kaptinën», «Vdekja e shoferit» etj.

Këtë punë që kanë nisur letrarët punëtorë thanë se do ta vazhdojnë më tej, duke shkruar në shumë e mirë dhe duke organizuar diskutime të tjera për krijimtarinë e tyre, si p.sh., për vëllimin me poezi të autorit të këtij rrethi letrar Demir Gjergji, vëllim i cili tani doli nga shtyp.

Korresp. i «Dritës»



Ndërtime të reja në fshat. Shikaj, Kukës.

Mendimi ynë për karakterin kombëtar në ARKITEKTURË

Dukuri të ndërtimeve në fshatin tonë socialist

Këto ditë redaktori ynë u takua në Institutin e Studimeve e Projektimeve me arkitektë që merren me urbanistikën dhe arkitekturën e fshatit tonë socialist. Mendimet e tyre po i botojmë në këtë artikull.

Fizionominë kombëtare në arkitekturë nuk mund ta kuptojmë pa e parë dhe në aspektin e ndërtimeve të reja që janë bërë dhe po bëhen në fshatin tonë socialist, në përputhje me kushtet e reja shoqërore, ekonomike e kulturore. Këto sullen një ndryshim në pamjen e fshatit dhe në vetë jetën e fshatarëve.

Në të kaluarën, ndërtimi i fshatrave i ishte lënë spontaneitetit të plotë. Në të mbisundonte tipi i shtëpive primitive përdhese dhe shpeshherë pa dritare e oxhak. Askush nuk mendonte për rrugët, kanalizimet, ujët e pijshëm, ndërsa për dritën elektrike as që bëhej fjalë. Në vend të gjelbërimit, në çdo hap dhe rreth çdo shtëpie takojë gjerde e ferra. Por, siç thotë shoku Enver, pamja e dikurshme e fshatit të vjetër po zhduket gjithnjë e më lart në horizont dhe ajo po mbetet si një kujtim i hidhur i së kaluarës. Sot, në epokën e ndritur të Partisë, krahas me shtëpitë e reja po ndërtohen, me ritme të shpejta, shtëpi kulture, çerdhe e kopshte për fëmijë, ambulanca e qendra sanitare,

lavanderi e furra buke, rrugë e lulishte, të cilat po e bëjnë më të mirë, më të bukur e më të gëzueshme jetën e fshatit tonë të ri. Dhe të gjitha këto bëhen në bezë të planeve rregulluese me rrjet rrugor të përcaktuar, me kanalizime, me kufijt e përcaktuar të shtrirjes së tij etj.

Me vendosjen e pushtetit popullor, sidomos gjatë kolektivizimit të bujqësisë, u ndie nevoja për një kthesë të rëndësishme në drejtim të grumbullimit të shtëpive. Fshati i grumbulluar, sigurisht në bazë edhe të një plani rregullues të studjuar, është me interes të madh shoqëror, politik, ideologjik dhe ekonomik. Kjo sjell, në radhë të parë, ruajtjen e fondit të tokës bujqësore, një ndarje më të mirë të banimit, zonës ekonomike dhe asaj të stallave.

Një ndihmë e madhe në këtë drejtim kanë qenë dhe janë porositet e vazhdueshme të Partisë dhe qeverisë në drejtim të hartimit dhe zbatimit të planeve rregulluese. Tradita e ndërtimit të banesave në terrene të thyera, duke mos zënë tokën e bukës është një përvojë e mirë që na ka vlejtur dhe na vlen gjithmo-

në ne projektuesve, qoftë në drejtim të shfrytëzimit sa më racional të tokës, ashtu edhe në atë të krijimit të ansambleve të bukura urbanistiko-arkitektonike, Urbanistika dhe arkitektura e fshatit është zhvilluar në principe më të shëndosha dhe në baza më shkencore gjatë hartimit të planeve rregulluese të fshatrave të rinj, që janë ngritur në vendin tonë si rezultat i rritjes dhe i fuqizimit të industrisë dhe ekonomisë sonë popullore.

Janë të pajisur me vija të verdha 2619 fshatra të Republikës, ndërsa me plane rregulluese 701 dhe me relieve 884. Vazhdon puna për plotësimin edhe të fshatrave të tjerë me to. Shumë fshatra të rinj janë ndërtuar për të strehuar banorët e atyre fshatrave në të cilët janë ndërtuar hidrocentrale, gjithashtu mjaft të tjerë janë ndërtuar edhe në zonat që janë prekur nga tërmeti. Duke i projektuar këto plane rregulluese në terrene të lira, pa qenë nevoja që t'i përshatemi gjendjes së fshatit ekzistues, ato janë ndërtuar sipas parimeve urbanistike më të përparura. Në këto plane janë reflektuar kushtet reale të zhvillimit ekonomik të fshatit socialist, në të është pasqyruar përvoja e përparuar e traditës sonë në këtë fushë dhe mbi të gjitha ato plane janë projektuar duke u bazuar mbi botëkuptimin leninist «Për ndërtimin e komunizmit duhet të zhduket ndryshimi ndërmjet fshatit dhe qytetit».

Si shembull për këto që themi, marrim fshatrat e reja që janë ndërtuar dhe do të ndërtohen në rrethin e Kukësit, për të shpërngulur fshatrat buzë liqenit të hidrocentralit të Fierzës, Myç-Mamëz, Shikaj, Kolshi, Fajza etj. Fizionomia e banesës fshatare të këtij rrethi, e njohur tashmë me emrin «Kulla shqiptare», u diktua në ato kohë nga kushtet e vështira

ekonomike të jetesës dhe pasigurta shoqërore. Volumi i gurtë dhe i mbyllur i këtyre kështjellave të vogla, ndrydhte jetën e fshatit brenda mureve. Kurse sot, në fshatrat e reja të ndërtaura në këtë rreth, jeta e fshatit ka bërë një revolucion të paparë.


Edhe fshatrat e zonave fushore kanë patur një zhvillim të dukshëm në drejtim të grumbullimit të ndërtesave, duke mos e zënë dhe shpërdoruar tokën e bukës. Është në studim edhe plani rregullues i fshatit Kërnishtaj, si qendër e asaj kooperativë bujqësore të tipit të lartë në rrethin e Lushnjës. Kërnishtaj i dikurshëm, me kasollet përdhese me kallam, mbeti vetëm si kujtim. Fshati i sotëm ngrihet me ndërtesa banimi të bukura e higjienike, me një qendër fshati, me ndërtesën e kryesisë së kooperativës, shkollën, shtëpinë e lindjes, çerdhen, kopshtin etj. Sipas studimit, po bëhet një grumbullim dhe vendosje e sistemuar e banesave të reja, një ndarje e qartë e zonës së banuar, asaj ekonomike dhe stallave.

Fshati ynë mori tipare të reja jo vetëm nga sistemet urbanistike, por edhe nga pamja arkitektonike e ndërtesave të banimit dhe atyre shoqërore. U hartuan disa projekte tipe të banesave me 1 dhe 2 kate. Dallohen për ndërtime dykateshe fshatrat e Korçës, Gjirokastrës, Sarandës etj. Interes paraqesin dhe fshatrat bregdetare si Dhermiu, Vunoj etj.

Ato janë ndërtime të thjeshta, plot ajër dhe dritë, me kushte higjienike të mira, me volume e trajtime arkitektonike të bukura. Element i rëndësishëm në kompozimin urbanistik të fshatit është edhe qendra shoqërore, si vendi ku zhvillohet jeta e gjallë politike, kulturore, shoqërore etj. Ndërtesat me kapacitetin e tyre përballojnë më së miri kërkesat e banorëve për një jetë aktive, ku ndihet vrulli i punës, gëzimi i jetës me aktivitetet e ndryshme të saj. Parcelat e gjelbëruara i shtojnë bukurinë kësaj zone dhe e bëjnë atë më funksionale.

Sukses i madh është arritur në ndërtimet e zonave ekonomike dhe të prodhimit. Në shumë kooperativa apo ferma shtetërore janë ngritur komplekse stallash nga më modernet, në funksion me organizim të përsosur të të gjithë proceseve të punës.

Problem tjetër, që duhet të zgjidhet drejt urbanistika dhe arkitektura në fshat, është ndërtimi i apartamenteve. Ky element i ri hyn në kompozimin urbanistik të fshatit, kërkon një trajtim të veçantë. Sepse ai duhet t'i përshatet karakterit të fshatit, të lidhet në harmoni me ndërtimet e tjera ekzistuese, me qëllim që prania e tij të pasurojë siluetin e fshatit dhe jo të jetë i huaj për të. Mjeshtri i talentuar «popull» na ka dhënë ndërtesa të bukura fshatare të ndërtuara me materiale të thjeshta rrethanore: gur, dru apo qerpiç. Kulla e Veriut, shtëpia e myzeqarit, apo shtëpitë prej qerpiçi, të gërshetuara me përvojën e madhe 32-vjeçare të ndërtimeve të pasqirimit, janë një pasuri me vlerë nga ku kemi gjetur dhe gjejmë burim për krijimet tona arkitektonike dhe urbanistike në drejtim të ndërtimit të fshatit tonë socialist.



Maketi i fshatit të ri Myç-Mamëz, ndërtuar në rrethin e Kukësit.

Probleme të zhvillimit të arkitekturës

Prof. Besim Daja
Ruzhdi Qatipi

Partia dhe shoku Enver vazhdimisht kanë theksuar nevojën që edhe arkitektura e urbanistika jonë, si gjithë kultura dhe arti ynë socialist, duhet të zhvillohen dhe të përparojnë sipas parimeve marksiste-leniniste të mbështetjes në traditat më të mira të së kaluarës dhe në përvojën e fituar gjatë ndërtimit socialist të vendit. Që në shkurt të vitit 1948, në fjalën e mbajtur në komisionin e ngritur për urbanistikën e Tiranës, shoku Enver porositi: «...arkitektët duhet të kenë parasysh stilin popullor. Të përpiqen që të krijojnë një stil në përshatje me karakteristikat e vendit tonë». Mbështetur në mësimet e Partisë dhe të shokut Enver, punonjësit e ndërtimit, punëtorë e teknikë, arkitektë e inxhinierë, kanë bërë përpjekje dhe kanë arritur rezultate të mira, duke ia ndryshuar pamjen Atdehut tonë socialist me qytete e fshatra të reja. Është krijuar në këtë mënyrë një traditë e re dhe në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës.

Por stadi i sotshëm i zhvillimit të shoqërisë socialiste në vendin tonë, si dhe realizimi i detyrave të mëdha të planit të gjatë pesëvjeçar, shtrojnë përpara arkitekturës dhe urbanistikës detyra të shumta dhe të rëndësishme. Një nga këto probleme kryesore është edhe zhvillimi i forcimit i mëtejshëm i karakterit kombëtar në arkitekturë, mbështetur në traditat tona të së kaluarës e në rezultatet më të mira të deritanishme, në luftë kundër ndikimeve dhe shfaqjeve të huaja borgjezo-revizioniste. Prandaj rubrika e organizuar në gazetën «Drita», «Mendimi ynë për karakterin kombëtar në arkitekturë», u prit me interes shumë të madh nga arkitektë, inxhinierë, punëtorë e teknikë të ndërtimit, artistë e punonjës të tjerë.

Gjatë diskutimit që zgjati mbi pesë muaj u botuan mbi 30 shkrime të autorëve të ndryshëm, si dhe u tërhoq mendimi i masave për këto probleme nga rrethet e Korçës, Beratit, Gjirokastrës etj.

Në këtë rubrikë u dhanë mendime të vlefshme mbi rëndësinë dhe nevojën e shfrytëzimit të traditave kombëtare për zhvillimin e mëtejshëm të një arkitekture të re socialiste dhe u bënë propozime konkrete mbi mënyrat dhe rrugët e shfrytëzimit të kë-saj tradite në përputhje me kërkesat ideestetike dhe materiale të shoqërisë sonë socialiste. Gjithashtu u vu në dukje drejt karakteri klasor dhe edukativ i arkitekturës, u diskutua rreth problemeve të ndryshme për aspektin estetik dhe ekonomik të saj etj. Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha problemet u shtruan drejt dhe nën dritën e mësimet të Partisë dhe të shokut Enver, veçanërisht të vendimeve të Plenumit IV të KQ të Partisë dhe fjalës së shokut Enver Hoxha të 20 dhjetorit të

vitit 1974. U sqaruan një sërë çështjesh për të cilat para plenumit IV ka pasur edhe ndonjë keqkuptim, ose është bërë edhe ndonjë teorizim i demshëm që mohonte nevojën e mbështetjes në traditën kombëtare për zhvillimin e arkitekturës sonë të re, i jepte prioritet formës dhe paraqitjes së jashtme. Tani që janë botuar mbi 30 shkrime nga autorë të ndryshëm, punëtorë, specialistë, arkitektë, inxhinierë, sociologë, piktorë, skulptorë etj. mendojmë se mund të arrihet në disa konkluzione.

Problemi i forcimit të karakterit kombëtar në arkitekturë, bëhet akoma më i rëndësishëm sot, në kushtet e rrethanat e rrethimit e të bllokadës imperialisto-revizioniste, si dhe të ashpërsimit të luftës klasore kundër ideologjisë borgjezo-revizioniste. Përpjekjet që bëjnë teoricienët borgjezë e revizionistë në arkitekturë, si dhe në të gjitha artet e tjera, se gjoja ajo shkon drejt «ndërkombëtarizimit» të saj, «të zhdukjes së specifikave kombëtare», janë shprehje e shovinizmit të shteteve të mëdha, mjete të tyre të preferuara për të mposhtur popujt, janë agresion ideologjik për të vendosur hegjemoninë e tyre. Këta faktorë objektivë përcaktojnë edhe nevojën e zhvillimit të mëtejshëm të arkitekturës sonë të re mbështetur fuqimisht në tabanin kombëtar socialist e që nuk pajtohet me parullat borgjezo-revizioniste mbi «stilin unik të arkitekturës së shekullit të 20-të», ose «stilin ndër-kombëtar të epokës sonë».

«Në këto kushte, - si na porositi shoku Enver Hoxha në plenumin IV të KQ të Partisë, - për ne bëhet edhe më imperative lufta për të ruajtur fizionominë kombëtare të artit, pasurinë kulturore të popullit». Nisur nga këto pikësnyime të partishme, edhe në shkrimet e kësaj rubrike u theksua me forcë se detyra për të studjuar e vlerësuar traditat më të mira në arkitekturë, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i tyre në arkitekturën tonë të re shtrohet jo vetëm për të shfrytëzuar përvojën e madhe shekullore të popullit tonë, e krijuar në rrethana specifike, historike, politike, ekonomike, shoqërore, të klimës, të natyrës sonë malore dhe të mënyrës së jetesës. Në qoftë se populli ynë, thuhet me të drejtë në një nga shkrimet e rubrikës, u ka bërë ballë armiqve barbarë, ka ruajtur cilësitë dhe dinjitetin kombëtar, qënien e tij si komb, kjo ka ardhur jo vetëm se ai ka luftuar me armë në dorë, por edhe sepse ai ka krijuar një pasuri të madhe kulturore dhe artistike, të cilën ka ditur ta shfrytëzojë dhe ta verë në doli të çështjesh nacionale.

Zhvillimi i shkencës dhe i teknikës, përdorimi i materialeve dhe i konstruksioneve të reja, jo vetëm nuk mohojnë aspak karakterin kombëtar në arkitekturë,

por përkundrazi kur shfrytëzohen nga arkitekti me pjekuri politike dhe aftësi profesionale këthen në mjete të fuqishme për zhvillimin e perfeksionimit e mëtejshëm të arkitekturës sonë, për sigurimin e gjetjeve të reja mbështetur në këtë traditë, prej së cilës kemi shumë për të marrë. Populli ynë megjithëse në të kaluarën në kushte të vështira politike dhe ekonomike, ka ndërtuar vepra me vlera të mëdha artistike, nga banesat e thjeshta të fshatit deri në banesat e mëdha të qytetit, të cilat nga pikëpamja e kompozimit dhe e zgjidhjes funksionale, e përdorimit të materialeve rrethimore dhe e logjikës së konstruksionit, në punimin e gurit, në gdhendjen e drurit e në rrahjen e hekurit, tregojnë shpirtin e tij prej artisti.

Si duhen pasqyruar në mënyrë krijuese vlerat artistike të së kaluarës në ndërtimet tona të sotme, si duhet shfrytëzuar trashëgimia arkitektonike në kushtet e reja në mënyrën e jetës sonë socialiste? Këto janë dy nga çështjet kryesore që u rrahjen gjerësisht në shkrimet e gazetës sonë.

Duke kritikuar qëndrimet e gabuara metafizike dhe idealiste në problemet e artit e të kulturës, shoku Enver ka thënë: «Në jemi si kundër mohimit të thjeshtë, jo dialektik të traditës, ashtu edhe kundër hyznizimit dhe gjunjëzimit përpara saj. Mohimi të shpie në qëndrime metafizike, nihiliste. Në pozitat e mohimit të plotë të traditës addohen sot modernistët, të cilët janë armëmbajtësit kryesorë të borgjezisë në art dhe në letërsi. Hyznizimi i traditës gjithashtu është i demshëm, ai çon në konservatorizim dhe në shkëputjen nga realiteti».

Duke u nisur nga ky mësim i shokut Enver shumë pjesëmarrës në rubrikë me të drejtë theksojnë se, kur flasim për elementë tradicionalë në arkitekturën tonë të re, duhet të kemi parasysh që të mos e thjeshtëzojmë kombëtarën. Me të nuk duhet kuptuar transplantimi mekanik i një ndërtese të vjetër në të sotmen, sepse dhe kushtet e jetesës së popullit tonë, (politike, sociale, ekonomike etj), kanë ndryshuar, janë zhvilluar e kanë ecur shumë përpara. Ndërtimet tona masive sot, në të cilat ka hyrë betoni, xhami e mjete të tjera, duhet të jenë të forta e moderne, po njëkohësisht të dallohen që larg që janë shqiptarë dhe t'i përgjigjen më së miri kërkesave ideestetike dhe utilitare të masave tona punonjëse në fshat e qytet. Është gabim të mendohet se kombëtarja në arkitekturën tonë mund të arrihet me vendosjen shabllone të disa elementeve të arkitekturës popullore. Duhet të marrim ato elementë të traditës që i shkojnë për shtat jo vetëm kërkesave të jetës socialiste, por edhe kushteve të terrenit e të klimës, edhe vetë traditës së qyteteve e fshatrave të veçantë. Në këtë mënyrë, ashtu si theksohet me të drejtë nga pjesëmarrës në këtë diskutim, vazhdimi i tipareve të arkitekturës së traditës kombëtare, në atë të realizimit socialist, duke i shtuar edhe tipare të reja, është bërë dhe do të bëhet nëpërmjet një praktike të gjatë krijuese shoqërore, të udhëhequr nga teoria revolucionare e Partisë sonë, me përpjekjet e përbashkëta të të gjithë punonjësve të ndërtimit.

Arkitektura e jonë e re, ashtu si arkitektura popullore, duhet të karakterizohet nga thjeshtësia,

qartësia dhe saktësia e formave, nga proporcionet e harmonishme, nga ngjyrat e hapta e të gëzueshme, nga kontrasti i fortë dritë e hije, nga zgjidhjet planimetrike të thjeshta dhe ekonomike, të gjitha këto elementë dallues të arkitekturës sonë popullore.

Parafabrikimi dhe standartizimi në ndërtim dhe tipizimi në projektim, faktorë të rëndësishëm për masivizimin dhe shpejtimin e ndërtimit, për të cilët ka patur ndonjë ngurrim dhe paqartësi në fillim, po kuptohen gjithmonë e më mirë se nuk janë pengesë për zhvillimin e traditës në arkitekturë. Përdorimi i tyre me mjeshtri profesionale bëjnë të mundur jo vetëm kapërcimin e rrezikut të uniformitetit dhe të monotonisë, por mund të bëhen edhe pikëmbështetje për zhvillimin e mëtejshëm të traditës.

Një numur i madh banesash dhe objekte të ndryshme social kulturore të ndërtuara në shumë qytete të vendit tonë tregojnë më së miri se në projektimin e tyre janë marë parasysh këto kërkesa. Rezultate të rëndësishme janë arritur sidomos në zgjidhjen e seksioneve të banimit, për ndërtimin e banesave të rehatshme, të bukura dhe ekonomike në mënyrë të veçantë në variantet kuzhinë me aneks, zgjidhje origjinale që i përgjigjet mënyrës së jetesës së popullit tonë. Godinat shoqërore dhe kulturore gjithashtu dallohen për zgjidhjen e mira funksionale, thjeshtësinë e konstruksionit dhe paraqitjen e bukur.

Këto rezultate do të ishin akoma më të mira nëqoftëse do të ishim mbështetur më shumë në faktorët tradicionalë që duhen marrë parasysh dhe në elementët e traditës që mund të përdoren dhe që janë të shumtë. Ata duhen kërkuar në marrjen parasysh të faktorëve klimaterikë, në lidhjen e godinës me ambientin rrethues dhe me natyrën, në mbrojtjen e godinave nga era, në krijimin e mikroklimatit optimal, në shfrytëzimin e gjelbërimit, në përdorimin e materialeve rrethimore, në madhësinë e dritareve etj. Pa dyshim, një mur prej guri, një kornizë prej druri, një dekoracion ose një interior tradicional, një hark ose qemer janë gjithashtu elementë që ndihmojnë në formimin e kombëtares, kur përdoren me vend. Vendi ynë është një vend kryesisht malor dhe kjo karakteristike ka ndikuar në pjesën më të madhe të arkitekturës në traditë, qoftë në drejtim të shfrytëzimit të pjerrësisë së vendit, qoftë në drejtim të përdorimit të gurit si material rrethor. Në përgjithësi veshjet prej guri shkojnë shumë me ambientin rrethues. Në mënyrë të veçantë në vendin tonë, me natyrë malore e plot gjelbërim kjo është më se e përshatshme. Guri gjendet me bollëk pothuaj në çdo vend dhe me cilësi të mirë, me ngjyra të ndryshme nga njëra të bukurat, prandaj pa mënjnuar faktorët ekonomikë ai duhet të përdoret në ndërtim, por në atë mënyrë punimi që të ruajë fizionominë kombëtare.

Suksese të rëndësishme janë arritur edhe në ndërtimet e fshatit. Sot, në kushte krejt të ndryshme politike e shoqërore, me rritjen e nivelit të mirëqënies së popullit, fshatari ynë ka ngritur shtëpi të reja e të rehatshme që nuk kanë të krahasuar me ato kasollet e së kaluarës. Karakte-

Probleme të zhvillimit të arkitekturës

(vijon nga f. 7.)

ristikë dalluese e këtyre banesave është pamja e jashtme dhe e brendshme që ruan veçoritë arkitektonale të krahinës përkatëse.

Por, për t'u përgjigjur vullit të ndërtimit në fshat është e domosdoshme që për secilin prej tyre të kemi planet rregulluese, duke pasur parasysh kërkesat e ndërtimit socialist në fshat, sepse një pjesë e mirë e tyre janë pa projekte ose me projekte të pasdjuara mirë.

Lidhur me problemet e trashëgimisë nga tradita në arkitekturë, në rubrikë pati edhe ndonjë rast, kur për mungesë njohjeje e thellimi është hedhur edhe ndonjë mendim më të cilin nuk jemi dakord. Kështu p.sh. në njërin nga shkrimet e rubrikës, në mes të tjerave, jepet edhe mendimi se kompozicioni i shtëpisë karakteristike në ndonjë qytet është zgjidhur me dhomën e dimrit (dimërore pat) me vendin e zjarrit (oxhak) me mure të gjera dhe dritare të vogla, dhe me dhomën e verës (oda) që është në katin e sipërm me sipërfaqe xhami të mëdha etj.

Që faktorët klimaterikë duhen pasur parasysh gjatë projektimit është kërkesa e kuptueshme dhe e domosdoshme, por zgjidhja e këtij problemi në shembullin që jepet, mendojmë se nuk mund të jetë një zgjidhje për ndërtimet tona popullore masive. Partia dhe shoku Enver na mësojnë se ashtu si nuk duhet mohuar tradita në arkitekturë, po ashtu ndaj saj duhet mbajtur një qëndrim kritik klaror, në bazë të idesë se çdo krijim i çdo epoke qoftë është bërë me tendencë, frymëzohet nga idetë e kohës, mban vullën e luftës së klasave dhe të ideologjisë së kohës së vet. Edhe arkitektura gjatë epokave të ndryshme të zhvillimit shoqëror, duke shprehur ndjenjat artistike dhe talentin e popujve, duke shprehur kushtet politike, ekonomike dhe teknike në të cilat ka jetuar shoqëria ashtu si të gjitha artet e tjera, i është nënshtruar ideologjisë së klasave sunduese, ajo ka patur gjithmonë karakter klaror, i ka shërbyer klasës në fuqi, ideologjisë së saj. Prandaj edhe elementët tradicionalë në arkitekturë duhet t'i kërkojmë më shumë në ndërtimet popullore, sidomos në ato të fshatit, dhe jo të marrim si shembull vetëm ndonjë godinë të veçantë.

Në artikulujt e shumtë, jepen gjithashtu mendime konkrete edhe mbi përdorimin e dekoracioneve popullore. Elementët dekorativë si gdhendja në gur, kornizat e penxhereve e të çatave, përpunimi i metalit, raftet në mur, parapetet e shkallëve, ndarja e mureve, etj., përbëjnë elementët më rëndës të kësaj arkitekture nga të cilët ajo merr fizionominë karakteristike kombëtare. Këta elementët dekorativë duhet t'i zhvillojmë më tej, t'i stilizojmë në frymën e traditës me vërtetësi artistike, t'i industrializojmë që të bëhen masive dhe ekonomike. Fusha e

përdorimit të dekoracioneve popullore në arkitekturën tonë të re është shumë e gjerë. Por, ashtu si theksohet nga disa autorë të shkrimeve në rubrikë, këtu përveç traditës duhet të kemi parasysh të krijojmë edhe motive të tjera nga jeta dhe puna, që pasqyrojnë ditët tona, transformimet në të gjitha fushat e jetës. Prandaj, në punën tonë krijuese, përveç shfrytëzimit të traditës kombëtare po kaq rëndësi ka edhe krijimi i dekoracioneve me motive të ndërtimit socialist.

Edhe në fushën e urbanistikës, në ndërtimin e qyteteve e të fshatrave tona janë arritur rezultate të rëndësishme. Në vend të ndërtimeve spontane dhe kaotike u bënë gjithnjë e më shumë ndërtime të planifikuara, në bazë të kriterëve të orientimit ndaj diellit, ajrit e gjelbërimit, duke u krijuar kështu një traditë e re dhe duke u grumbulluar një përvojë e madhe. Lufta për një urbanistikë të re, karakterizohet edhe nga zbulimi dhe vënia në dukje e vlerave të objekteve historike, e në mënyrë të veçantë, të atyre që lidhen me historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, nga zbulimi dhe vënia në dukje e vlerave artistike të ambientit natyror, në shfrytëzimin racional të truallit, në ruajtjen e tokës bujqësore, në lidhjen me terrenin, në shfrytëzimin e pjerrësive. Megjithatë sukseset e arritura në fushën e urbanistikës sonë të re, në drejtim të shfrytëzimit të traditës në urbanistikë kërkohej dhe duhet bërë më shumë. Pjesëmarrësit në diskutim, mendojmë se ngrejnë shumë probleme me interes dhe bëjnë sugjerime, prej nga organet përkatëse dhe vetë urbanistët tanë mund të nxiten e të nxjerrin detyra konkrete. Kështu p.sh., më shumë duhet punuar për sistemin e planeve rregulluese të qyteteve e të fshatrave tona, sepse deri më sot pak është përdorur, bie fjala, në kompozimin urbanistik elementit karakteristik i «rrugicave» si veçori e shprehjes së intimitetit të popullit tonë, të para këto në një këndvështrim krejtësisht të ri. Njëkohësisht, më shumë duhet të vlerësohet në studimet tona urbanistike lidhja me natyrën dhe krijimi i arkitekturës së gjelbërt, në mënyrë të veçantë në qytetet e mëdha të vendit. Për këtë problem me të drejtë propozohet që në tërë sipërfaqet e gjelbëruara pranë banesave, në rrugë, parqe e lulishte të mbillen më shumë bimët dhe lulet tona tradicionale dhe me vlera si p.sh., rrepet, blinjt, magnoliet, pishat etj.

Përveç faktorit edukativ, një rëndësi e veçantë, në artikulujt e rubrikës i kushtohet faktorit ekonomik, sepse, në vendin tonë arkitektura është në shërbim të masave punonjëse, prandaj problemi për të projektuar dhe ndërtuar duke pasur gjithmonë parasysh faktorin ekonomik, ka një rëndësi të madhe, në mëny-

rë që me të njëjtat vlera monetare të realizohen sa më shumë ndërtime për popullin. Duke studjuar përvojën e vendit tonë në zgjidhjen funksionale të banesave, në përdorimin e materialeve rrethore, në zgjidhjen konstruktive, në shfrytëzimin racional të truallit, vërejmë se faktori ekonomik është patur gjithmonë parasysh. Populli ka kombinuar gjithmonë anën estetike dhe funksionale me atë ekonomike. Jo mbështetja në traditën kombëtare, por ndikimet e huaja janë pikërisht ato që e neglizhojnë faktorin ekonomik siç thuhet me të drejtë nga diskutantët në rubrikë. Janë pikërisht shijet e huaja, pikëpamjet estetizante, që e përcmojnë vlerën arkitektonike të një vepre, duke e ngarkuar atë me forma të tilla të rëndomtë, pa funksion, pa shije estetike dhe për pasojë me shpenzime të tepërta që e rëndojnë ekonominë. Forcimi i regjimit të kursimit është në harmoni me të bukurën për stilin popullor dhe në të njëjtën kohë barrikatë kundër teprimeve, luksit, përdorimit pa kursim të materialeve deficitare. Janë pikërisht nënvlefësimet e traditës që tek ndonjë arkitekt ka bërë të lindin koncepte të huaja dhe antiekonomike, të cilat duhet t'i flakim bashkë me manieren për t'u gjunjëzuar e për të kopjuar verbërisht nga përvoja e huaj.

Në punën e tyre krijuese, projektuesit dhe arkitektët tanë natyrisht do të shfrytëzojnë edhe arritjet dhe eksperiencën e kulturës botërore, por duke pasur parasysh gjithmonë orientimet e Partisë e cila na mëson se: «**Punonjësit e frontit ideologjik: shkronjarët, kompozitorët, arkitektët e të tjerë duhet të përfitojnë...** nga gjithëka është e mirë dhe përparimtare në jetën dhe kulturën e vendeve të tjera, por duhet të hiqet dorë nga shabllonizmi dhe mënyra mekanike në zbatimin e eksperiencës së huaj». Prandaj, një vlerë të madhe për praktikën e projektimit kanë edhe studimet e historisë së arkitekturës, sepse asnjë fenomen nuk mund të shpjegohet mirë deri në fund, asnjë vepër arkitektonike nuk mund të kuptohet drejt, në qoftë se merret e shkëputur nga rrethanat konkrete historike, të vendeve të ndryshme (qofshin politike, ideologjike ose ekonomike).

Një faktor tjetër me rëndësi të madhe që ndihmon për krijimin e kombëtares është sinteza e arkitekturës me pikturën e skulpturën monumentale dhe artet e aplikuar. Forca e madhe shprehëse e përgjithësuese e tyre luan një rol të madh për edukimin e njerëzve me ndjenjat e dashurisë për vendin, për popullin, për socializmin. Për krijimtarinë e përbashkët të arkitekteve me piktorët dhe skulptorët, mundësi të mëdha krijojnë materialet e reja dhe mjetet e reja teknike. Edhe në shkrimet e kësaj rubrike piktore e skulptore theksuan nevojën e forcimit të këtij bashkëpunimi, sepse pjesëmarrja e tyre në punën artistike për krijimin e veprave arkitektonike, me përjashtime të pakta, ka qenë e kufizuar dhe shpesh herë ka mbetur në fazën studimore. Vepra të rëndësishme si Pallati i madh i kulturës, Galeria e Arteve si dhe shumë vepra të tjera arkitektonike presin pjesëmarr-

jen aktive të artistëve tanë që t'i plotësojnë me vepra të denja artistike me përmbajtje të thellë ideologjike.

Nevoja e thellimit të vijës së masave në projektim, e lidhjes me të ngushtë të projektuesve me punëtorët e specialistët e zbatimit dhe të shfrytëzimit, e diskutimit të projekt-ideve gjatë projektimit si dhe e diskutimit të projekteve të zbatimit para ndërtimit u theksua me forcë të madhe nga shumë pjesëmarrës të rubrikës për problemin e kombëtares në arkitekturë. Del qartë se ky problem vite më parë është karakterizuar në disa raste nga formalizmi, si në shtrimin e përciptë për diskutim, ashtu edhe në mosdhenien punëtorëve të mundësive të plota për të bërë kritika e për të dhënë mendime për veprat e ndryshme që do të ndërtohen. Porse duhet përmendur këtu se kohët e fundit ka një mobilizim të gjithanshëm për diskutimin e projekteve dhe marrjen e mendimit të masave. Një gjë e tillë u duk më së miri edhe në shkrimet e rubrikës, ku dhanë mendime me interes edhe shokë punëtorë, specialistë e qytetarë. Kjo frymë e shëndoshë në sigurimin e mendimit të masës, ku përveç specialistëve të ndërtimit të ftohen edhe punëtorë, sociologë, estetë, ekonomistë, inxhinierë etj. tanimë duhet rritur e thelluar. Ballafaqimi me masën në kohën e duhur për problemin që i interesojnë arkitekturës sonë do të ndihmojë, çdo arkitekt e projektues jo vetëm për realizimin e veprave konkrete, por edhe për ngritjen e vazhdueshme të nivelit të tyre ideoprofesional.

Lidhur me këtë çështje edhe shumë nga pjesëmarrësit në rubrikë, ngriten me forcë problemin e studimit të vazhdueshmë të traditës në arkitekturën tonë popullore dhe të realizimit socialist. Janë shumë të dobishme sugjerimet e bëra për punën e përbashkët teoriko-shkencore që duhet të kryejnë në afatet e duhura organet shtetërore dhe institucionet përkatëse që merren me problemet e arkitekturës e të urbanistikës. Historia e arkitekturës shqiptare, probleme të arkitekturës sonë bashkëkohore, gjallërimi i konsultave dhe diskutimeve krijuese, shkëmbimi dhe përhapja e përvojës më të mirë përmes shtypit letroro-artistik dhe botimeve arkitektonike - janë disa nga detyrat që duhet të preokupojnë më seriozisht secilin nga ne. Mbi të gjitha, tani është koha që të kalohet në thellimin e në zbatimin konkret të të gjitha detyrave që kanë të bëjnë me forcimin e karakterit kombëtar në arkitekturë. Sigurisht ky është një problem që gjen zgjidhjen më të mirë në punë e sipër. Kuptohet, që vazhdimisht mund dhe do të dalin çështje që do të kenë nevojë për diskutim, aq më tepër, po të kemi parasysh që kjo rubrikë, brenda mundësive të saj, nuk kishte si të trajtonte të gjithë problemet me hollësi e deri në fund, prandaj është e domosdoshme përsëri të trajtohen probleme të tillë edhe në shtyp. Mbyllet rubrika, por jo shkëmbimi i mendimeve tona. Herë pas here gazeta «Drita» do të botojë artikuj të kësaj natyre

Prof. BESIM DAJA,
RUZHDI QATIFI

Probleme të zhvillimit të skulpturës monumentale

Fuat Dushku

Thoma Thomai,

skulptorë

Në zhvillimin e vullshëm të artit tonë të realizmit socialist, një vend të rëndësishëm zë edhe skulptura monumentale. Janë me dhjetëra tanimë veprat tona në të mira të vendosura në sheshet kryesore të qyteteve, fshatrave, gjer në skajet më të largëta të Atdheut, të cilat i kushtohen luftës heroike të popullit për liri dhe pavarësi, revolucionit që organizoi dhe udhëheq Partia me shokun Enver në krye, ndërtimit socialist në kushtet e rrethimit imperialisto-revizionist, heroizmit masiv të popullit tonë, figurave të shquara të bijve e bijave në të mirë të popullit që dhanë edhe jetën për ditët e lumtura që gëzojmë sot etj. Në këtë rrugë zhvillimi sukseset janë arritur edhe në vështrimin sasior të veprave (monument, përmendore, buste, relieve etj.) edhe në rritjen e cilësisë artistike.

Tradita e trashëguar në skulpturën monumentale, si dhe ajo e realizmit socialist e zhvilluar fuqimisht në vitet e pasqirimit, dëshmojnë se skulptura jonë ka qenë gjithnjë e lidhur me fatet e popullit e të Atdheut dhe ka pasqyruar luftën heroike të masave. Por ndërsa në vitet e paraçlirimit skulptura jonë monumentale realiste përparimtare ushqej kryesisht nga traditat më të mira të së kaluarës, në periudhën e pasqirimit si rezultat i transformimeve revolucionare, politike, ekonomike dhe shoqërore, objekti i pasqirimit të saj artistik u bë i gjithanshëm. Lufta e Partisë dhe e popullit tonë kundër okupatorëve dhe tradhtarëve të vendit, transformimet socialiste në bujqësi dhe industri, qëndresa e popullit tonë dhe shpartallimi i pandalshëm i bllokadës imperialisto-revizioniste, lufta kundër mbeturinave të huaja, emancipimi i gruas etj., i kanë frymëzuar e frymëzuar skulptorët tanë për vepra nga më të bukurat artistike të trajtuara me partishmëri të lartë, tematikë të larmishme e me vull të qartë kombëtare e popullore. Pikërisht kjo larmi tematike është një nga tiparet kryesore të skulpturës sonë monumentale të realizmit socialist, që i kanë siguruar asaj, njëkohësisht, edhe atë karakter të theksuar realist e kombëtar. Duhet thënë se edhe në veprat me tema nga historia, skulptorët tanë, në dritën e mësimëve të Partisë dhe të letrës së shokut Enver drejtuar autorëve të monumentit të pavarësisë, u kanë dhënë dhe po u japin atyre edhe më shumë tingëlloj aktual dhe idenë e perspektivës së zhvillimit tonë revolucionar. Kemi tanimë vepra të njohura si psh «Monumenti i pavarësisë» në Vlorë, «Shkëndërbeu» në Krujë e në Tiranë, «Partizani» në Tiranë, «Katër heroinat» në Mirditë, «Përmendoria e Mushqetadës» e të tjera kushtuar brigada-

ve sulmuese partizane; relievi i Kryeministrit etj. Bile ne kemi tanimë edhe punime të tilla në skulpturë si «Lart frymën revolucionare», e cila është bërë e njohur dhe na duket se e kërkojnë vetë sheshet tona për ta vendosur në njërin prej tyre si vepra monumentale për të bërë një efekt të përditshëm edukativ të kalimtarët dhe vizitorët.

Por, pavarësisht nga sukseset, mendojmë se edhe në drejtim të pasurimit të mëtejshëm të tematikës, skulptura jonë monumentale ka ende shumë për të bërë. E theksojmë këtë, sepse, siç dihet, ne kemi ende pak vepra në krahasim me vetë kërkesat e kohës sonë, që të pasqyrojnë luftën dhe punën e klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste, popullit tonë ushtar për ndërtimin dhe mbrojtjen e Atdheut socialist. Për këtë jemi të mendimit se duhet të rritet më tepër veprimtaria krijuese e skulptorëve tanë për vepra më të shumta me këtë tematikë. Vajta në bazë e disa shokëve krijues, njohja e tyre më e thellë me jetën dhe përpjekjet e klasës punëtore dhe fshatarësisë kooperativiste i ka frymëzuar krijuesit për vepra të tilla. Kështu p.sh. po punohet e studjohet për vepra monumentale kushtuar Reformës Agrare, luftës së Drashovicës, rezistencës popullore kundër pushtimit fashist, monumenti që po ripunohet i heronjve të Vigut etj. Por lidhur me këtë çështje shtojmë se duhen vepra arti edhe në shumë vende ku janë zhvilluar ngjarje me rëndësi jetike në historinë e popullit tonë si p.sh. në shtëpinë ku është formuar Partia, Rinia Komuniste, apo në sheshe e vende ku janë zhvilluar demonstrata antifashiste etj. Po kështu kantieret tona të mëdha të ndërtimit e qendrat industriale si metalurgjiku, Fierza, Ballshi etj. presin veprat e skulpturës monumentale për të përjetësuar heroizmin masiv të viteve të Partisë. Sigurisht, për këtë duhet bërë një punë e studjuar e me perspektivë. Ndërkaq edhe vetë skulptorët, në raste ekspozitash, mund dhe duhet të paraqiten me projektmonumente për këto tema. Kjo ka edhe një të mirë tjetër, sepse do të gjallërojë diskutimet krijuese për këto punime, të cilat do të rrisin pa tjetër vlerat e tyre ideoartistike për edukimin klasor-revolucionar të masave tona punonjëse, veçanërisht të brezave që vijnë.

Një faktor tjetër që ka ndikuar në formimin e karakterit realist e të fizionomisë kombëtare të skulpturës sonë monumentale, përveç problematikës aktuale, ka qenë dhe është edhe trajtimi dinamik i ngjarjeve dhe i figurave nëpërmjet plastikës tipike shqiptare. Në rastet më të mira ato



(figurat) kanë psikologji shqiptare, bartin ndjenja dhe mendimet e njerëzve tanë, janë trajtuar pra larg pozës dhe deklamacionit. Po kështu është shmangur në kohë edhe ndonjë shfaqje e gjigandomanisë në rastet e punimeve të veçanta në ndonjë ekspozitë, ku madhështia e vërtetë e përmbajtjes ideomocionale e figurës është zëvendësuar me «madhësh-tinë» e ftohtë e të thatë të përmasës së stërmadhuar si qëllim në vetvete. Natyrisht për forcimin e mëtejshëm të karakterit realist të skulpturës sonë monumentale dhe thellimit të karakterit të saj kombëtar, krahas përvetësimit të traditës sonë më të mirë asaj të kultivuar ashtu edhe të mjeshtrave popullorë, rol shumë të rëndësishëm, ashtu si na porositin Partia dhe shoku Enver, luan njohja me jetën, me heronjtë, me tipat realë. Qëndrimi vazhdimisht në mes tyre i siguron artistit material të bollshëm jetësor për botën e tyre shpirtërore e mendore, sjelljen, plas-

tikën etj., i cili i trajtuar me forcë artistike shpie në gjetjen e vlerave ideoartistike. Kjo sidomos ka rëndësi të veçantë edhe për bustet dhe monumentet kushtuar heronjve dhe heroinave, figurave të njerëzve tanë që punojnë e luftojnë për mbrojtjen e Atdheut socialist. Njohja e tyre siguron, përveç të tjerave, edhe shmangjen nga shtampa dhe skema, Njohja dhe studimi, gjithashtu, shpion edhe në trajtimin e simboleve të jetës sonë revolucionare (kazëm, pushkë, libër etj.), gjithnjë në mënyrë organike e funksionale, duke i kërkuar e pranuar vetë figura dhe përmbajtja ideomocionale e krejt punimit. Forcimi i këtyre tipareve të reja të skulpturës sonë monumentale ka rritur dhe po i rrit asaj vazhdimisht karakterin popullor, vlerat edukative e aftësitë komunikuese me masat. Ky është edhe një nga qëllimet kryesore. Mirëpo shpesh në

(vijon në f. 12)

Mbi kanunin e Skënderbeut

Kristo Frashëri

Edhe pse normat kanunore të Skënderbeut, më vonë u shfuqizuan pothuajse kudo, kujtimi i tyre ka arritur në ditët tona në formë legjendash dhe në variante të ndryshme. Deri tani ne njohim 6 norma kanunore të lidhura me emrin e Skënderbeut. Më tepër se kudo ato janë ruajtur në kujtesën popullore të malësorëve të Dibrës së Poshtme, ndoshta sepse këtu ato vepruan më gjatë se në viset e tjera të trevës së Kastriotëve.

Aristokracia ushtarake e maleve, e lidhur me luftën vetëm për hir të plaçkës, ashtu si aristokracia feudale e fushës, e lidhur pas interesave të saj partikulariste, nuk ishte mbështetje e sigurtë për luftën çlirimtare të shek. XV. Lufta epike kërkonte vendosmëri të thellë dhe sakrificat të mëdha. Ajo kishte nevojë për kapërdanë trima dhe besnikë, të aftë dhe të devotshëm deri në fund. Të tillë «luanë», si i quan M. Barleti, filluan të dalloshin nga radhët e luftëtarëve të jeshhtë. Për të zëvendësuar në fushë princërit dhe në malësi kefalijë të «luanë» e rinj, Skënderbeut i duhej, para së gjithash, të thyehte normën mesjetare mbi trashëgiminë e funksionit sipas së cilës në krye të shoqërisë dhe të ushtrisë mund të qëndronin vetëm pinjollët e detyrë të para të fushës apo të kapërdanëve tradicionalë të malësisë, të ashtuquajturit «njerëz të mirë». Marin Barleti na jep disa shembuj që tregojnë se me sa vendosmëri Skënderbeu vuri në krye të ushtrisë së rregullt, në vend të pinjollëve fisnikë, mjaft komandantë të aftë dhe besnikë të dalë nga radhët e fshatarëve.

Në lidhje me këtë, tradita popullore e paraqet Skënderbeun në rolin e plakut të kanunit, në databat me Lekë Dukagjinin sipas variantit të Dibrës, apo me Kokë Malcin sipas legjendës së Kurbinit. Debatimi midis tyre u zhvillua, sipas varianteve në Qidhën të Dibrës, në Shtjefën të Matit ose në Skurje të Krutjes. Për ta bindur partnerin se origjina prindërore nuk lot asnjë rol, Skënderbeu tregoi si shembull rastin e vet, se si ai një trupmadh dhe i pashëm kishte lindur nga një prind trupshkurter dhe i shëmtuar, siç ishte, sipas legjendës, Gjon Kastrioti. Sipas traditës dibrane Skënderbeu e formuloi normën e vet kanunore në këtë mënyrë: «si i mejri, si i keçi janë nja për nja, se prej të mejrit del ene i keçi e prej të keçit del ene i mejri». Në pajtim me këtë normë kreu i bashkësisë nuk duhej të ishte si më parë i trashëgueshëm, por duhej të zgjidhej periodikisht nga kuvendi i malësorëve, të cilët do të ngarkonin në këtë funksion shokun e tyre më të aftë nga pikëpamja e udhëheqjes ushtarake.

Kjo normë gjeti zbatimin e vet edhe në gjirin e bashkësisë familjare. Sipas saj kur kreu i shtëpisë (tatëzoti) vdiste ose tregtohej i paaftë, vendin e tij nuk duhej ta zinte meoemos, si më parë, i biri më i madh, por pjesëtari më i përshatshëm i familjes. Parimin e barazisë midis anëtarëve të shtëpisë e ndeshim edhe në dy norma të tjera, të cilat tradita popullore dibrane ia atribuon gjitha-

shtu Skënderbeut. Njëra kufizonte pushtetin absolut të tatëzotit në bazë të së cilës më parë ai kishte të drejtë të përjashtonte pjesëtarin e shtëpisë nga prona familjare. Në kundërshtim me këtë normë, thotë tradita, Skënderbeu la kanun «fëmija qysh se len e ka tenin (pjesën - K. F.) nja për nja me të madhin». Norma tjetër përmbyste të drejtën gjithashtu të lashtë që gëzonte burri për ta ndarë gruan pa i njohur asaj asnjë lloj prone brenda familjes ku ishte martuar. Në lidhje me këtë pikë, tradita pohon se me kanun të Skënderbeut «gruaja munet me u da pa hise vetëm për bracakllëk (vjedhje - K. F.) e për punë të panershme, për ndrihe grujaja merr xhimën e tokës së burrit dhe pjesën e gjasë ene ajo ka mundin e vet për plang të shpaj». Norma kanunore «si i mejri si i keçi janë nja për nja» gjeti zbatim edhe në institutin e gjakmarrjes. Këtu ajo përmbysi parimin e mëparshëm të lindur nga procesi i diferencimit shoqëror, sipas të cilit gjaku i një të «mejr» duhej të shpaguej me gjakun e dy të «keqinjve». Por instituti i gjakmarrjes e shqetësonte shoqërinë shqiptare të shek. XV dhe në një drejtim tjetër. Në fakt, krahas parimit «dy të keqinj për nja të mejri», që lindi gjatë shekujve mesjetare, praktika e gjakmarrjes i nënshtrohej akoma parimit anakronik të trashëguar nga e drejta kanunore fisnore se «gjaku shkon për gjak ose gjaku shkon për fis». Në pajtim me këtë parim pala e viktimës kishte të drejtë të gjakmerrej duke vrarë cindo farefis të vrasësit. Si rrjedhim kur ndodhte një vrasje të gjithë meshkujt madhorë farefis të vrasësit, duke qenë njëllot të ekspozuar përballë rrezikut të gjakmarrjes, ishin të detyruar të mbyllëshin në shtëpitë e tyre. Kjo rrethanë përveçse largonte krahët më të aftë nga fusha e prodhimit, shkaktoje në të njëjtën kohë përçarje midis malësorëve. Ajo nuk pajtohej pra me interesin që kishte vendi për t'u rimëkëmbur ekonomikisht dhe për t'u forcur politikisht. Meqenëse pajtimet e gjaqeve zakonisht qenë të përkohshme, Skënderbeu ndërhyri, për aq sa lejonin kushtet e shek. XV, për ta kufizuar prezen e gjakmarrjes. Edhe në këtë rast, ai i veshur në rolin e plakut të kanunit, operoi nëpërmjet së drejtës të pashkruar. Ai shpalli dy norma të reja kanunore, nga të cilat njëra pakësonte rastet e hakmarrjes, tjetra ngushtonte rrethin e viktimave. Në të dy rastet Skënderbeu i kundërvihet Lekë Dukagjinit. Sipas Kanunit të Lekës, thotë tradita popullore, «gjaku mbetet për faj», domethënë vrasja e një fajtori nuk konsiderohej si shpagim i fajit, por çel të serinë e gjakmarrjes së vazhdueshme dhe të trashëgueshme. Kundër kësaj norme, gjithnjë sipas traditës «Skënderbeu kur pa se po bëheshin shumë gjaqe la në kanun: «gjaku nuk ngel për faj». Në praktikë, sipas këtij kanuni, në rast se fajit shpaguej me vrasje, kjo vrasje nuk mund të bëhej objekt i gjakmarrjes. E-

dhe norma tjetër i kundërvihet parimit të trashëguar nga e drejta kanunore fisnore. Në takimin që u bë, sipas traditës, në Kuvendin e Dheut në Lurë, Leka mbrojti kanunin e lashtë se «gjaku shkon për fis», kurse Skënderbeu parashtrioi parimin se «gjaku shkon për gisht», që do të thotë se hakmarrja duhet të rëndonte vetëm mbi vrasësin dhe jo mbi farefisin e tij.

Tjetër problem që shqetësonte shoqërinë shqiptare gjatë periudhës së Skënderbeut ishte rërimi ekonomik i vendit nga eksportet e vazhdueshme të invazorëve osmanë. Pasi merrnin fund eksportet turke kujdesi i parë i popullsisë ishte rindërtimi i shtëpive dhe mbjellja e të lashtave e pemëve që digjeshin. Midis pemëve që kultivoheshin në Shqipëri më mesjetare peshën më të rëndësishme në ekonominë e vendit e zinte paddyshim ulliri. Pikërisht me këtë pasuri ekonomike të dorës së parë ka lidhje norma e gjashtë e Skënderbeut. Sipas traditës krutane, Skënderbeu dha urdhër që kur lindte një djallë prindët e tij duhet të mbyllnin njetëz rrenjë ullinj dhe të kujdeseshin për tu deri sa ai të martohej; përndryshe askush nuk duhej t'i jepte atij vajzën për nusë. Në variantin krutan kjo normë ruhet e formuluar afërsisht kështu: «pa njetëz rrenjë ullinj të ngulme për djalin nuk bahet martesë e tij». Pra, nuk kemi të bëjmë me një porosi të thjeshtë për me një normë kanunore të veshur me detyrim shoqëror.

Sikurse shihet, këto norma kanunore të Skënderbeut, shënuan një hap përpara për atë kohë në krahasim me parimet e lashta të së drejtës së pashkruar që sundonin akoma në shekullin XV. Me zbatimin e tyre, organizimi shoqëror i malësorëve, i shërbeu më mirë se me normat e mëparshme, luftës çlirimtare kundër perandorisë osmane. Karakteri i tyre progresiv për atë kohë dhe zbuli i pavdekshëm i Skënderbeut, janë dy arsye të forta që shpjegojnë përse emri i tij u vesh mbarë të drejtës kanunore që sundonte në Shqipërinë e Mesme. Megjithatë normat kanunore të Skënderbeut nuk qenë reforma radikale. Ato nuk e përmbysën rëndin patriarkal të malësive, nuk e zhdukën praktikën e egër të gjakmarrjes dhe nuk e çliruan gruan nga skllavëria ndaj burrit. Veç kësaj ato nuk patën jetë të gjatë. Me depërtime e marrëdhënieve feudale në viset malore pozita e krerëve të malësorëve u bë përsëri e trashëgueshme. Gruaja e humbi prapë të drejtën e saj mbi pronën familjare. Po ashtu rrezja e gjakmarrjes u zgjerua përsëri në kurriz të farefisit. E drejta kanunore e ngarkuar me norma reacionare rezistoi edhe pasi mori fund sundimi osman. Një mori normash të saj arritën deri edhe pas Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare për hir të traditës së tyre shekullore, të tolerancës që tregoi regjimi zogist dhe të përkrahjes që patën nga qarqet më reacionare të vendit. Por me vendosjen e pushtetit popullor asgjësimi rrenjëror i së drejtës kanunore, si praktikë dhe si refleks, u bë një domosdoshmëri historike për të pastruar rrugën e përparimit. Në këtë drejtim, revolucioni ynë socialist korri një fitore të madhe historike, nën udhëheqjen e Partisë së Punës dhe të shokut Enver.

(vijon nga f. 7)

këtë drejtim nuk mjafton vetëm puna e skulptorit.

Dihet se veprat e skulpturës monumentale ekspozohen në vende të dukshme dhe në baza të kritereve të caktuara arkitektonike dhe urbanistike. Kemi disa rase kur kjo vendosje flet për një punë të menduar e të suksesshme si në Tiranë (Monumenti i Skënderbeut) Vlorë (Monumenti i Pavarësisë), «Nënë Shqipëri» në Vorrazë e Dëshmorëve në Tiranë etj. Mirëpo nuk ndodh gjithnjë kështu. Kryesorja mendojmë se është që për këtë skulptura monumentale të jetë gjithnjë në sintezë me urbanistikën dhe arkitekturën. Kjo nuk zgjidhet thjesht me një bashkëpunim të jashtëm e të nxitur të arkitektit me skulptorin, por që me konceptimin e parë urbanistik të sheshit, rrugës apo objektit në harmoni me krejt shtrijën e qytetit dhe të shpërndarjes së veprave ekzistuese të skulpturës monumentale; funksionin ideestetik dhe edukativ të veprës që do të ekspozohet etj. Në fundi, për probleme të tilla kemi mendimin se duhen gjallëruar më shumë edhe diskutimet e krijujes, të cilat të shërbejnë për një mendim më unik në rastet e tilla.

Por duke hedhur disa mendime për rritjen e rolit edukativ të skulpturës sonë monumentale tani para plenumit të Lidhjes për probleme të zhvillimit të saj, theksojmë se rëndësi ka gjithashtu, edhe lulëzimi harmonik i gjinive të skulpturës monumentale. Kështu p.sh., ndërsa në skulpturën e monumenteve, përmendoreve, busteve etj., në kemi ecur relativisht përpara, në atë të rellëvit e sidomos të parqeve nuk është ai zhvillim që duhej. Në disa raste, bile, si në rrugën e skelës në Vlorë, apo dhe në ndonjë park në Tiranë, Korçë, e gjetkë vazhdojnë të qëndrojnë punime të dobta. Jemi të mendimit se në skulpturën e parkut veçanërisht, së pari, duhet të jemi të qartë në koncept. Ajo është dhe duhet të jetë jo vetëm zbukuruese, shlodhëse e qetësuese, por mbi të gjitha edukative. Pra vepra skulpturale e parkut gjithashtu duhet të mbartë ide dhe emocione të fuqishme të njeriut tonë të ri. Mirëpo ndryshe nga gjinitë e tjera skulptura monumentale e parkut jo vetëm teorikisht, por edhe në realizimin e saj konkret artistik duhet të ketë originalitetin dhe freskinë e vet, larg monotonisë dhe uniformitetit. Ajo kërkon rraporte emocionale dhe një trajtim më lirik intim e shoqëror njëkohësisht. Temën e madhe e kërkon dhe duhet ta trajtojë edhe në këtë gjini, por kryesorja është që të ruhet mënyra dhe gjuha e saj shprehëse artistike. Po kështu në skulpturën monumentale të parkut mund dhe duhet të trajtohet edhe bota emocionale e rinisë sonë, e dashurisë për shokun, për shoqen, ndjenja e miqësisë dhe e kolektivitetit, etj. Do të ishte mirë, që në këtë drejtim, ashtu si edhe në gjinitë e tjera të skulpturës monumentale krahas përkrahjeve individuale të ndërmerren edhe punë kolektive. Përvorja më e mirë e skulptorëve tanë dëshmon se një bashkëpunim krijues serioz janë realizuar vepra me vlera ideo-artistike.

FUAT DUSHKU,
THOMA THOMAI

Dukuri të reja të qendrës së Tiranës

Faik Alimehmeti,

Irimi Loka

arkitektë

Vlerat dhe funksioni i ndërtesave që kanë përbërë qendrat; madhësitë dhe format e shesheve të qyteteve tona, kanë ndryshuar në varësi të periudhave të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë. Por vetëm me vendosjen e pushtetit popullor, tek ne u krijua një urbanistikë e re, me përmbajtje krejtësisht të re socialiste dhe në shërbim të gjithë shoqërisë.

Gjatë viteve të ndërtimit të socializmit, sipas orientimeve të Partisë dhe mësimave të shokut Enver, krahas ndërtimit dhe rindërtimit të qyteteve dhe fshatrave, lagjeve e rrugëve të reja, u krijuan qendrat e qyteteve tona me fytyrë krejtësisht të re. Pamja e vjetër e tyre gjithnjë e më shumë po zhduket. Ndryshoi kështu tipologjia e ndërtimeve që përbëjnë qendrën e qytetit, vendin e ndërtesave të kultit e zonë ndërtimit e reja social-kulturore, vendin e reklamës e zonë një herë e përgjithmonë hapësirat për manifestimet politike, kulturore, masive. Gjithnjë e më mirë qendrat u plotësuan me gjelbërimi, rrugë e sheshe që plotësojnë nevojat materiale e shpirtërore të masave.

Mbi këto parime u hartua dhe

u miratua kohët e fundit projektideja urbanistike e qendrës së kryeqytetit të Atdheut tonë socialist. Projektideja e qendrës së Tiranës është një fazë e mëtejshme e gjithë studimeve të mëparshme dhe e vërejtjeve dhe e porosive të bëra nga Partia për këtë qëllim.

Këtu është patur parasysh plotësimi i kërkesave që përputhen me mendimet, shijen dhe gjithë etikën e popullit, të kërkesave për diell, ajër e blerim, të konceptimit ideor të qendrës duke vendosur në plan të parë ndërtimet me karakter edukues politik dhe çlodhës, kërkesat për siluettën e qytetit, që populli e ka shprehur ndërmjet harmonisë së ndërtimeve dhe, vende-vende, kjo e gërshetuar me theksime të gjelbëruara ose ndërtesa të veçanta.

Thellimi i mëtejshëm i këtij studimi, zgjidhja arkitektonike e ndërtesave në veçanti, zgjedhja e materialeve të ndërtimit etj. do të ndikojnë pozitivisht në kapërcimin e mëtejshëm të vështirësive dhe në plotësimin me sukses të atyre detyrave që vuri Kongresi i 7-të i Partisë.

Studimi i ri ndihmon për hap-

jen e mëtejshme të zhvillimit perspektiv të ndërtimeve në qendrën e kryeqytetit. Krahas ndërtimeve të reja që janë bërë deri tani, në studimin e ri, janë planizuar ndërtime të tjera që qendra e Tiranës, ashtu sikurse edhe vetë kryeqyteti, të jetë qendër e denjë politike, shoqërore, kulturore, administrative e Atdheut tonë socialist, për krijimin e një ansambli urbanistik bashkëkohor, monumental e dinjitoz për të kristalizuar më tej unitetin e përmbajtjes socialiste me frymën kombëtare.

Për thellimin e mëtejshëm të përmbajtjes socialiste, projektideja e re, përshkohet nga përpjekjet për rritjen e vlerave të godinave, për një zgjerim të mëtejshëm të sferës së jetës, punës dhe pushimit, për plotësimin gjithnjë e më rritje të nevojave materiale e shpirtërore të banorëve. Për këtë qëllim u ndryshua lloji i objekteve dhe i vendeve të tyre, duke iu përgjigjur në radhë të parë aktivitetit, duke parashikuar kështu në sheshin kryesor të qendrës ndërtime të objekteve, të cilat do të qëndrojnë si sintezë e rrugës që ka çarë popullit ynë, si sintezë e luftës së popullit tonë me shpatë e pendë, me pushkë e kazëm, për liri, pavarësi, çlirim dhe për ndërtimin e socializmit. Po kështu në vende të dukshme, në rrugët kryesore të qendrës janë parashikuar të vendosen ndërtesa të rëndësishme administrative, shkencore e kulturore. Ndërtimet në qendrën e re pa dyshim mbajnë në formë e në brendi vulën e kohës sonë, të socializmit, pasqyrojnë një traditë të re dhe në vazhdimësi të asaj të trashëguar, e cila nëpërmjet të tjerave shprehet edhe në atë që popullit ynë që në lashtësi, në ndërtimin e qyteteve, ka gjetur zgjidhje të mahnitshme dhe origjinale e që ruan aktualitetin dhe vlerën e saj, që është lidhja e ansambleve arkitektonike-ur-

banistike të qendrës me natyrën. Zgjidhja artistike me kualitet dhe origjinalitet i këtij problemi, ka qenë karakteristike e përgjithshme e gjithë periudhave të lulëzimit të arkitekturës dhe urbanistikës tonë popullore, e cila futet organikisht në qendrën e kryeqytetit tonë socialist. Janë bërë përpjekje që të arrihet me sa të jetë e mundur një sintezë ndërmjet arkitekturës dhe natyrës. Kjo sintezë është arritur në mënyrë vizuale në lidhjen panoramike me malin e Dajtit, në zhvendosjen e vijave të ndërtimit (trotuare të gjerë me breza gjelbërimi), në ruajtjen e gjelbërimit karakteristik ekzistues, në mënyrë të veçantë të atyre që kanë krijuar «historinë» e tyre; ashtu edhe në zmadhimin e sipërfaqeve të gjelbërta për krijimin e «arkitekturës së gjelbërt»; për të dhënë mundësinë e shlodhjes dhe qëndrimit.

Tradita në vazhdimësi është parë dhe në ruajtjen e monumenteve të kulturës kombëtare, të artit e të historisë (si xhamia, sahati, ansambli i dikastereve etj) monumentet e ndryshëm në mënyrë të veçantë të atyre që lidhen me historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare si dyqani «Flora», pllaka të ndryshme përkujtimore, të cilat kanë hyrë në ansamblin e qendrës së qytetit. Në trajtimin e tyre është patur parasysh çlirimi nga rrethimi i disa ndërtimeve ekzistuese, zgjerimi i sferës së shikimit vizual dhe futja pranë tyre e «arkitekturës së gjelbërt». Njëkohësisht me ruajtjen e vlerave të së kaluarës është patur parasysh t'i jepet zgjidhje problemit të rëndësishëm ideopolitik, krijimit të monumenteve dhe i propagandës monumentale të epokës sonë të socializmit, të punës krijuese dhe të heroizmit të njerëzve tanë. Për këtë qëllim në vazhdim të rru-

(vijon në f. 10)



Pamje nga qendra e Tiranës.

(Foto: S. Kaba)

Të

papërkulur

(vijon nga f. 9)

çfarë e detyronte atë të ngrihej e të fliste? Po Marash Gila, si i hodhi një herë sytë gjindjes, ngriti zërin e tha:

- Një mijë rrena e një mijë mashtrime. Kushdo që ka ardhë në këtë dhe e këdo që kemi pritë këshu si ju, nuk ka pasur tjetër qëllim, veç me na ngranë e me na fik më mirë e më lehtë. Një mijë rrena e njëmijë mashtrime!

Pa rrugë, pa shkollë, pa bukë, me armiqtë mbi shpinë, e kurrkujt si kena shtri dorën.

Jemi djegë e jemi plaçkitë! Në borë e në shi, pa bukë e pa mbulesë. Na është dashë të jetojmë, majë bjeshkësh e në shpella, bashkë me ujë e egërsira, por çarkun e pushkës e kemi mbajtur ngrehur kurdoherë, ditë e natë, e këtë pushkë që sheh se kemi lëshue nga dora. Se po e lëshuam dhe këtë atëherë dijeni se i kemi lëshuar të gjitha! E unë tani një vit t'iu flas, e ju një vit më dëgjoni, zoti kolonel, ta dini se kini për të ikur prej nesh pa i marrë vesh të gjitha ç'kemi heq e ç'heqim.

Aksenti i tij ishte kaq i fortë sa gjithë gjindja u drodh. Ai i ngjante një shprazje pushke apo një shuplake që godet në fytyrë të një vrasësi. Secili malësor u shtërngua të ulte kokën për të mbytur diçka si psherëtimë që mund të shfaqej papritur në bebëzat e syve.

Frazat e para kolonelit ia përkthyen krejtësisht, por pastaj çdo gjë ndryshoi. Vet përkthyesi u hutua, harroi detyrën e tij.

- Çfarë thotë - tha koloneli i zymtë në fytyrë, duke parandjerë diçka në mënyrën e vrazhdët se si Marash Gila i drejtohej atij.

Përkthyesi u përpoq të gjente lidhjen midis frazave të kaluara, por Marashi nisi të vazhdonte ligjeratën e tij... dhe ai e pa të udhës të fillonte përkthimin që këtu:

- Zemra e malësisë ka mbetë si një derë kalaje në të cilën askush prej të liqëve nuk ka mundur të hyjë brenda!... As ushtritë, as topat, as para ja nuk kanë mundur me e thye këtë derë e as me e poshture për kushedi sa shekuj... kaq kisha tha ai së fundi duke ulur zërin dhe si pa nga përkthyesi, i cili vazhdonte t'i pëshpërite akoma kolonelit në vesh. Fjalët e tij, - i tha... këto desha me ia thanë kolonelit pikë për pikë.

Përkthyesi tundti kokën. Fytyra e priftit u ngrys. Që poshtë syzeve të bardha i lëvri dy sy të kaltërt të ftohtë. Ai i kyryti të gjitha fytyrat e malësorëve me radhë, u përpoq të ndeshte shikimin e ndonjërit prej tyre, për të kërkuar prej tij diçka, por të gjithë kishin vështrimin krenar.

Pas fjalëve të Marash Gilës çdo gjë mund të quhej e përfunduar. Ishte vënë një pikë si me plumb pushke e ishte prerë biseda si me shpatë.

«E pata fajin vet, - mendoj dom Pali, duke parë me egërsi nga ai. - Vet ia shtrova kolonelit këtë sofër. Dhe ky leckaxhi i mallkuar na ngopi mirë të gjithëve». Nuk vonoi pak, mbas mbarimit të përkthyesit, e mori fjalën vet koloneli Anderson. - Fjalët tuaja genë vërtetë prekëse, - iu drejtua ai Marashit me një ton dashamirës. - Ju përkthuat me vërtetësi mjerimin tuaj. Shoqëria jonë ka një shumë të ardhurash që e vë në dispozicionin tuaj. Unë nga ana ime ju siguroj se do bëj diçka për ju, për ta ndërruar sado pak këtë gjendje.

- E për këtë ç'lypsset nga ne, o kolonel, - iu përgjigj aty për aty, Marash Gila.

- Çfarë je në gjendje të japësh ti, Marash Gila; veç respektit dhe falenderimit për ata që të ndihmojnë, - iu përgjigj dom Pali me nervozizëm. Çfarë ke ti?!

- A, a, kam shumë, dom Pal - tha Marashi dhe një damar i kërceu në ballë. - Ti ndoshta s'e di, po unë kam një pasuri të madhe që nuk e le me ma prek kush. Kam Shqipërinë. Veç atë nuk e jap e nuk do ta lemë me na e lyp kush. Atë e duam se është toka e gjyshëve tanë. Këtu do ta ndërtojmë të nesërmen e vet cullakët e mi. Jo kështu si kjo jona. Diçka më ndryshe se gjithmonë nuk ka se si të kalojë kështu. Se dhe laku mban e mban, e këputet...

- Mjaft Marash! - thirri prifti, duke mos e zotëruar veten. Leri dhe të tjerët të flasin.

- Të flasin, posi - tha Marashi. - Unë vet s'kisha me folë, por me që më kishte çuar fjalë se kishte qejf me ndigjue zërin. T'i ndoshta më quan budallë, dom Pal, se s'fola ashtu si mund të mendoje ti, por fjalët s'ka të drejtë askush të na i diktojë veç zemrës sonë.

- Të lumtë ajo gojë! - u dëgjua një zë malësori nën buzë.

- Ka të drejtë, Marashi, - e ngriti pak më tepër zërin dikush andej nga mezi i tyre. Zëra të tjerë e pasuan me një mërmërimë apovuese, duke parë me admirim nga Marash Gila.

Dom Pali, pas këtij dialogu disa herë i grishi malësorët të ngriheshin e të flasin, duke e konsideruar gjithë këtë vetëm si një fillim të keq.

Por asnjë prej malësorëve nuk u ngriti të fliste më. Kështu që fjala e Marash Gilës mbeti për kolonelin Anderson si e vetmja përgjigje që mund të merrte nga këta malësorë.

SULEJMAN MATO

(vijon nga f. 7)

gës «Qemal Stafa» është krijuar një shtetore që kalon pranë dyqanit «Flora», e cila kryesisht do të shërbejë për mbajtjen e propagandës monumentale. Për zgjidhjen e këtij problemi kaq të rëndësishëm të sintezës së urbanistikës në artin monumental, është e nevojshme një organizim dhe bashkëpunim më i mirë i punës së urbanistëve, arkitektëve, skulptorëve etj., sepse jo kudo dhe

përmbytje që buron nga vetë ideologjia marksiste leniniste e Partisë, për të vënë në jetë e më mirë porosinë e shokut Enver në Kongresin e 7-të të PPSH. Jeta ka vërtetuar se ndërtimet e realizuara me nivel të lartë artistik, cilësi të mirë ndërtimi e frymë popullore janë pëlqyer nga populli. Por karakteri popullor, asnjëherë nuk duhet parë i shkëputur nga përmbytja socialiste, sepse çdo objekt do të mbajë vullën e kohës, vullën e kombëtares, kur ai flet apo mbështetet

Dukuri të reja të qendrës së Tiranës

kurdoherë ka gjetur zgjidhje të përshtatshme ky problem.

Mjaft pozitiv është fakti që tani për studimin e projektimit e tre muzeumeve që zenë vend me rëndësi në qendrën e projektuar, është ngritur një grup i gjerë me arkitektë, historianë, sociologë, ekonomistë, skulptorë etj., të cilët do të bëjnë një punë më të saktë jo vetëm për t'i projektuar në mënyrë më funksionale këto tri objekte, por edhe për t'i dhënë një fizionomi më të qartë kombëtare.

Në projektidenë është ruajtur dhe zhvilluar më tej tradita që karakterizon historinë e ndërtimit të Tiranës. Kështu, në tërësi, ruhet rrjeti rrugor kryesor ekzistues, është ruajtur dhe zhvilluar tradita që kanë krijuar disa rrugë të qytetit. P.sh. është ruajtur karakteri tregtar i rrugës «Bajram Curri» dhe asaj «Barikada» duke zhvilluar më tej këtë traditë në ndërtimet e saj të sferës së shërbimeve.

Edhe në konceptin vëllimor, format dhe vëllimet e ndërtesave janë parashikuar të shtrira, më shumë në gjërësi dhe jo me kulla shumëkatëshe «individuale» të shkëputura, pra në përshtatje me konceptimin ideestetik të njeriut të shoqërisë sonë. Vëllimet dhe format e tyre janë parashikuar me ndjenjën e masës dhe në harmoni me njëra-tjetrën, pa kontraste të theksuara vëllimore, ashtu si populli ynë kaq bukur i ka shprehur në ndërtimet e tij në qytetet e Beratit, Gjirokastrës etj. Kësaj i është kushtuar rëndësi se ka pasur raste të ndërhyrjes vulgare si ndonjë banesë në Gjirokastrë, shtëpia e kulturës në Berat, disa banesa në Korçë, hotelet në disa qendra të qyteteve e ndonjë rast tjetër që nuk janë në harmoni me ndërtimet e tjera përreth.

Arkitektura e objekteve të veçanta, që formojnë qendrën e re, padyshim do të ndihmojnë për thellimin e mëtejshëm të traditave tona për ndjenjën e masës dhe të harmonisë dhe për forcimin e tipareve socialiste shqiptare si në formë ashtu dhe në

në një realitet historik të caktuar.

Për të forcuar karakterin kombëtar popullor nuk duhet të marrim aty-këtu ndonjë element të traditës, ajo nuk duhet të kuptohet vetëm si veshje e jashtme, jo vetëm si kërkim për të gjetur mjete të jashtme të shprehjes artistike, por duhet të burojë së pari nga funksioni e brendia, nga interieri dhe dekorimi i jashtëm.

Arkitekturën e vetë ndërtesave, detaji arkitektonik, dekorimi popullor, shkalla e ndërtesës, përdorimi i ngjyrave të çelura, i gurit, i drurit, i hekurit të rrahur, i allçisë dhe i qeramikës, i sintezës së arkitekturës me artet e aplikuara e monumentale, i sintezës së arkitekturës me natyrën, mbeten si detyra më të rëndësishme arkitektonike, që kanë zënë vend në arkitekturën tonë popullore e që duhet të gjejnë zgjidhje e zhvillim të mëtejshëm në projektidenë e qendrës së kryeqytetit. Po kështu, në arkitekturën e ndërtesave të qendrës, duhet të zënë vend progresi i shkencës dhe i teknikës, në fushën e ndërtimit dhe në fushën e shkençave të tjera.

Pa dyshim, në qendrën e re është mbajtur mirë parasysh edhe faktori ekonomik, për t'iu përgjigjur aktualitetit politik, rrethimit të egër imperialisto-revizionist. Kjo shprehet në madhësitë e studjuara të vëllimeve të ndërtesave të ndryshme, në caktimin e radhës së ndërtimeve, për të ndërtuar me sa më pak prishje dhe për të shfrytëzuar sa më racionalisht vendet e lira, për të ndërtuar për sot dhe për mot, për të ndërtuar jo vetëm për ne, por edhe për brezat e ardhshëm.

Ky studim shërben si mbështetje për zhvillimin e harmonizuar të qendrës së kryeqytetit tonë socialist, i mbështetur në veçoritë tona socialiste e kombëtare, njëkohësisht dhe si drejtim kryesor për studimin e qendrave të qyteteve të tjera të vendit tonë.

FAIK ALIMEHMETI
IRINI LEKA